



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 197

Tiranë – E martë, 21 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 107/2021, datë 4.11.2021	Për bashkëqeverisjen..... 18605
Ligj nr. 111/2021, datë 25.11.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 18622
Ligj nr. 112/2021, datë 25.11.2021	Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 18623
Ligj nr. 115/2021, datë 25.11.2021	Për buxhetin e vitit 2022..... 18624
Ligj nr. 116/2021, datë 25.11.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane, dhe Komisionit Evropian për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut–Shqipëri, 2014–2020, alokimet për vitin 2020..... 18673
Dekret i Presidentit nr. 13374, datë 13.12.2021	Për shpallje ligji..... 18738
Ligj nr. 120/2021, datë 2.12.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar..... 18738
Dekret i Presidentit nr. 13392, datë 17.12.2021	Për shpallje ligji..... 18746
Ligj nr. 121/2021, datë 9.12.2021	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë..... 18746

Dekret i Presidentit nr. 13389, datë 17.12.2021	Për shpallje ligji.....	18748
Ligj nr. 122/2021, datë 9.12.2021	Për disa shtesa në ligjin nr. 99/2021, “Për ratifikimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri nr. 1, i vitit 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të ‘produkteve origjinuese’ dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimin e marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”.....	18749
Dekret i Presidentit nr. 13390, datë 17.12.2021	Për shpallje ligji.....	18750
Ligj nr. 123/2021, datë 9.12.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë COVID-19.....	18750
Dekret i Presidentit nr. 13391, datë 17.12.2021	Për shpallje ligji.....	18785
Vendim i Kuvendit nr. 91/2021, datë 20.12.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 13 343, datë 26.11.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 107/2021, ‘Për bashkëqeverisjen’”.	18785
Vendim i Kuvendit nr. 92/2021, datë 20.12.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 13 369, datë 10.12.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’”.....	18785
Vendim i Kuvendit nr. 93/2021, datë 20.12.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 13 384, datë 15.12.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 111/2021, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.....	18785
Vendim i Kuvendit nr. 94/2021, datë 20.12.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 13 385, datë 15.12.2021, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 112/2021 ‘Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ‘Për taksat kombëtare’, të ndryshuar”.....	18786
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 15.12.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Krugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	18786
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 17.12.2021	Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2022.....	18803
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 17.12.2021	Për lirin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.....	18804
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 627, datë 15.12.2021	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	18804

**LIGJ**
Nr. 107/2021**PËR BASHKËQEVERISJEN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Objekti

Ky ligj ka për objekt:

1. Përcaktimin e rregullave për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.

2. Përcaktimin e mënyrës së organizimit, funksionimit dhe kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve dhe nxitja e ndërveprimit ndërmjet administratës shtetërore dhe individëve, personave fizikë dhe juridikë dhe grupeve të interesit, pavarësisht formës së tyre të organizimit, me qëllim rritjen e rolit të tyre në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose të programeve të përbashkëta që kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në bashkëqeverisje përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe nga entet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas kushteve dhe përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekteve të tjera të prekura apo të interesuara.

2. “Koordinator” është një punonjës i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, i cili e ushtron detyrën pranë një institucioni tjetër dhe është përgjegjës për monitorimin, ndjekjen dhe trajtimin e çështjeve të regjistruara në seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.

3. “Pikë kontakti pranë një institucioni” është nëpunësi civil ose çdo punonjës tjetër apo njësi përkatese përgjegjëse në institucion, e përcaktuar me detyrën e mbajtjes së kontaktit midis koordinorit të Agjencisë dhe institucionit, me urdhër të titullarit të institucionit përkates.

4. “Çështje” nënkupton të gjitha rastet që vijnë në seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, të cilat trajtohen sipas një numri unik që krijohet nga momenti i regjistrimit të çështjes në platformë.

5. “Ankesë” është kërkesa për llogaridhënie nga institucioni apo punonjësit shtetërorë për grupet e interesit, të cilët, pasi kanë ndjekur procedurat ose parashikimet ligjore përkatese, nuk kanë marrë nga institucioni publik informacionin apo shërbimin publik të kërkuar.

6. “Afate”, në kuptim të këtij ligji për shqyrtimin e ankesave ose çështjeve të paraqitura në seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” janë afatet për llogaridhënien e institucioneve shtetërore/punonjësve shtetërorë, të cilat janë të ndryshme dhe nuk cenojnë zbatueshmërinë e afateve të parashikuara nga ligjet sektoriale apo Kodi i Procedurave Administrative.



7. “Interpelancë” është takimi i zhvilluar midis qytetarëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave nëpërmjet platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.

KREU II PARIMET E BASHKËQEVERISJES

Neni 5 Parimi i pjesëmarrjes qytetare

Institucionet e administratës shtetërore, si dhe çdo zyrtar publik që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji e ushtrojnë veprimtarinë administrative duke nxitur ndërveprimin dhe pjesëmarrjen efektive qytetare, veçanërisht gjatë konceptimit, hartimit dhe miratimit të nismave që kanë si qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, deburokratizimin, si dhe rritjen e eficiencës së funksionimit të administratës shtetërore dhe të shërbimit publik.

Neni 6 Parimi i rritjes së aksesit në shërbimet publike

Institucionet e administratës shtetërore, në përputhje me kompetencat e tyre dhe në përmbushje të parimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duhet të garantojnë përfutimin e shërbimeve publike ndaj çdo shtetasi, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, nëpërmjet procedurave administrative të thjeshta dhe transparente, të cilat nëpërmjet zgjidhjeve inovative e teknologjike mundësojnë një akses më të madh të qytetarëve në shërbimet publike.

Neni 7 Parimi i inovacionit të vazhdueshëm

Institucionet e administratës shtetërore nxisin përdorimin e teknologjisë dhe metodologjisë inovative të komunikimit për ndërveprimin me grupet e interesit dhe çdo qytetar, me qëllim zhvillimin e ideve dhe bashkëkrijimin e zgjidhjeve për mirëqeverisjen e vendit, duke përdorur mundësitë që krijohen nga platformat elektronike

qeveritare, përfshirë edhe përdorimin e publikimit të dhënave sipas parimit të qeverisjes së hapur.

Neni 8 Parimi i bashkëpunimit ndërinstitucional

Institucionet e administratës shtetërore koordinohen nëpërmjet mekanizmave të posaçëm institucionalë për zhvillimin e praktikave të mira dhe përdorimin e tyre në të gjithë administratën shtetërore, për gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje, për garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe për rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore.

Neni 9 Parimi i kontrollit

Veprimtaria administrative, përveç kontrollit administrativ dhe kontrollit gjyqësor, i nënshtrohet edhe kontrollit sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 10 Parimi i trajtimit të barabartë

Institucionet e administratës shtetërore i garantojnë çdo qytetari ose grupi interesi mundësi të barabarta dhe të drejta për të propozuar, për t'u informuar dhe për t'u konsultuar, si dhe pjesëmarrje në të gjitha fazat e konceptimit, të hartimit dhe të miratimit të nismave që kanë si qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, deburokratizimin dhe rritjen e eficiencës së administratës shtetërore.

KREU III STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR BASHKËQEVERISJEN

Neni 11 Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen

Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen me qytetarët janë:

- a) Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje;
- b) institucionet e administratës shtetërore.



Neni 12

Kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, më poshtë “Agjencia”, ka këto kompetenca:

a) zhvillon mekanizmat dhe monitoron zbatimin e tyre për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore;

b) koordinon nëpërmjet mekanizmave të posaçëm institucionalë institucionet e administratës shtetërore për zhvillimin e praktikave të mira dhe përdorimin e tyre në të gjithë administratën shtetërore për gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore;

c) publikon dhe informon publikun në mënyrë të vazhdueshme për çdo veprimtari për rritjen e rolit të qytetarëve në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose të programeve të përbashkëta, që kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në bashkëqeverisje dhe mënyrën e pjesëmarrjes së qytetarëve në to;

ç) informon për rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen për ndërmarrjen e nismave me interes publik, në përmbushje të qëllimeve të këtij ligji;

d) kërkon dhe merr nga institucionet e administratës shtetërore çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësisë së saj;

dh) shqyrton kërkesat dhe organizon në bashkëpunim me institucionin përkatës të administratës shtetërore interpelancat e Kryeministrit, të zëvendëskryeministrit dhe të ministrave me grupet e interesit, sipas kërkesës së tyre, për çështje me interes publik ose komunitar, me përjashtim të takimeve publike që organizohen sipas ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik;

e) rekomandon ndryshimin e rregullave dhe të procedurave të brendshme të institucioneve ose të strukturës së tyre, si dhe i propozon institucionit përgjegjës ndërmarrjen e nismës për ndryshimin e akteve ligjore ose nënligjore në rastet kur çmon se ofrimi i shërbimeve publike nuk mund të realizohet

me efektivitet për shkak të pengesave që krijohen nga rregullat dhe procedurat e brendshme, nga struktura e institucionit të administratës shtetërore ose aktet ligjore ose nënligjore në fuqi;

ë) kontrollojnë veprimtarinë administrative që kryhet nga institucionet e administratës shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj;

f) ndërmjetëson zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet institucionit të administratës shtetërore, qytetarëve apo subjekteve private sipas përcaktimeve të këtij ligji;

g) inspekton zbatueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe monitoron ndjekjen e masave të dhëna në zbatim të nenit 56 të tij;

gj) administron bazën e të dhënave të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” dhe propozon ndryshime në varësi të nevojës për përmirësim të platformës;

h) administron bazën e të dhënave të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe propozon ndryshime në varësi të nevojës për përmirësim;

i) ushtron çdo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 13

Përgjegjësitë e institucioneve të administratës shtetërore

1. Institucionet e administratës shtetërore janë përgjegjëse për:

a) zbatimin e mekanizmave për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në politikëbërje dhe garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse;

b) garantimin e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së çdo zyrtari publik gjatë ushtrimit të funksioneve shtetërore administrative;

c) bashkëpunimin me Agjencinë sipas kompetencave, rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj;

ç) fillimin e procedurës disiplinore me rekomandimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe përfshirjen në komisionet disiplinore të koordinatorëve përgjegjës të Agjencisë;

d) fillimin e procedurës së hetimit administrativ, me kërkesë të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe përfshirjen në grupet e hetimit administrativ të koordinatorëve përgjegjës të Agjencisë;



dh) ushtrimin e çdo detyre tjetër të parashikuar në këtë ligj.

2. Punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore janë përgjegjës për të bashkëpunuar me Agjencinë për çdo kërkesë të ardhur prej saj ose për çdo detyrim që buron nga parashikimet e këtij ligji apo përmbushja e kompetencave të Agjencisë.

3. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen përbën shkak për marrjen e masave sipas nenit 56 të këtij ligji.

KREU IV KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Neni 14

Statusi, struktura dhe organizimi i Agjencisë

1. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është person juridik publik qendror në varësi të Kryeministrit dhe përgjigjet për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, për garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, si dhe për rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore.

2. Agjencia ka logon, stemën dhe shenjat dalluese të saj, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Agjencia ushtron autoritet mbikëqyrës, koordinues, kontrollues dhe teknik sipas parashikimeve të këtij ligji.

4. Agjencia organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror dhe e ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Marrëdhëniet e punës për drejtorin e përgjithshëm dhe punëmarrësit e tjerë të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

6. Rrjeti i koordinatorëve është pjesë e strukturës dhe e organikës së Agjencisë.

7. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Struktura, organika, rregullorja për metodat e brendshme të punës për sjelljen e personelit të Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë.

Neni 15

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë administrativ i Agjencisë dhe përgjigjet drejtpërdrejt para Kryeministrit për veprimtarinë e Agjencisë.

2. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga Kryeministri dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

ç) të ketë përvojë pune të paktën 7 (shtatë) vjet në administratën publike nga të cilat 2 vjet në nivel drejtues;

d) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna;

dh) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë ka këto përgjegjësi:

a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Agjencisë;

b) nxjerr akte administrative (urdhra dhe udhëzime) në përputhje me këtë ligj dhe me Kodin e Procedurave Administrative;

c) përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

KREU V BASHKËQEVERISJA ME QYTETARËT

Neni 16

Platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”

1. Platforma “Me ty për Shqipërinë që duam” është një bazë të dhënash shtetërore elektronike, e organizuar në bazë seksionesh dhe ka si qëllim të jetë një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi për të adresuar në kohë reale çështje të politikëbërjes, për të diskutuar reforma e masa të rëndësishme duke mundësuar përfshirjen e personave fizikë dhe juridikë për politikat qeverisëse në çdo sektor apo për ecurinë e punës së çdo ministrie dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore, me qëllim garantimin e bashkëqeverisjes me qytetarët.



2. Të dhënat e platformës administrohen nga Agjencia me qëllim kontrollin e veprimtarisë administrative të institucioneve të administratës shtetërore, sipas kreut VII të këtij ligji.

3. Procesi i autentifikimit dhe i identifikimit në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” realizohet nëpërmjet “*Single-Sign-On*” të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.

4. Këshilli i Ministrave miraton seksione të reja, si dhe rregulla të detajuara për seksionet e platformës, të dhënat parësore e dytësore, që regjistrohen në platformë për dhënësit e informacionit, për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë miraton me udhëzim rregullat teknike dhe organizative të përmirësimit të seksioneve të platformës.

Neni 17

Metodat e bashkëqeverisjes

1. Metodat e platformës, të paraqitura sipas seksioneve në platformë, ndahen në varësi të përmbajtjes së çështjeve që adresohen:

a) metoda e kontrollit, ku përfshihen të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë ose çështje të denoncimit të korrupsionit të paraqitura në seksionet: “Ankesa ime”, “Biznesi im”, “Denonco korrupsionin”;

b) metoda e ndërveprimit, ku përfshihen ide, nisma komunitare nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë të paraqitura në seksionet: “Nisma ime”, “Interpelanca ime”, “Kuvendimi im”, “Shkolla ime”;

c) metoda e gjithëpërfshirjes, ku qytetarë ose persona fizikë apo juridikë shprehin vlerësimin e tyre për politikën e qeverisë apo interesin e tyre për të dhënë kontribut në administratën shtetërore, të paraqitura në seksionet: “Fjala ime”, “Nota ime”, “Dua të kontribuoj”.

2. Seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, sipas metodave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, janë:

a) “Ankesa ime” – Nëpërmjet këtij seksioni paraqiten ankesat për vonesën në marrjen e shërbimit publik apo mospërfitimin e tij, si dhe raportohen sjelljet abuzive të strukturave të administratës shtetërore ose të zyrtarëve të caktuar;

b) “Biznesi im” – Nëpërmjet këtij seksioni çdo subjekt privat i pajisur me NIPT ankimon sjelljet

abuzive apo joetike, si dhe çdo parregullsi të administratës, të cilat cenojnë klimën e biznesit dhe denoncon vendimmarrje që bien në kundërshtim me aktet rregullatore;

c) “Denonco korrupsionin” - Nëpërmjet këtij seksioni denoncohen aktet korruptive apo kur konstatohet se në përmbajtje të çështjes ka elemente të një akti korruptiv të ndodhur ose në tentativë;

ç) “Nisma ime” - Nëpërmjet këtij seksioni paraqiten ide për një nismë komunitare apo një projekt konkret me interes publik;

d) “Fjala ime” - Nëpërmjet këtij seksioni shprehen opinione për reformat ose projektet, të cilat janë në proces, dhe çdo sugjerim, ide e re apo propozim sesi mund të përmirësohet qeverisja në tërësi apo rezultatet në një fushë të caktuar duke përfshirë klimën e biznesit, por pa u kufizuar në të, politikën e qeverisë për biznesin apo marrëdhënien me administratën, si dhe duke përcjellë sugjerime për përmirësimin e klimës së biznesit në vend;

dh) “Interpelanca ime” - Nëpërmjet këtij seksioni një komunitet, grup interesi, shkollë apo universitet kërkon një interpelancë me Kryeministrin, zëvendëskryeministrin ose çdo ministër për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre sipas përcaktimeve të nenit 29 të këtij ligji;

e) “Shkolla ime” - Nëpërmjet këtij seksioni një grupim personash paraqet një ide apo projekt për të përmirësuar institucionin arsimor ku bën pjesë apo mësimdhënien në të sipas përcaktimeve të nenit 29 të këtij ligji;

ë) “Nota ime” - Nëpërmjet këtij seksioni çdo qytetar dhe person fizik ose juridik vendos një vlerësim për institucionin, zyrën ose sportelin pas përfitimit të një shërbimi publik të ofruar prej tij sipas përcaktimeve të nenit 31 të këtij ligji. Nga kjo notë e vendosur nga qytetarët përllëgaritet nota mesatare mujore e pëlqyeshmërisë së institucionit për nivelin e ofrimit të shërbimit, e cila bëhet publike periodikisht në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam”;

f) “Dua të kontribuoj” - Nëpërmjet këtij seksioni çdo qytetar shpreh interesin e tij për të ndihmuar ose për t’u angazhuar në administratë me kohë të plotë, të pjesshme ose si ekspert në projekte.



g) “Kuvendimi ynë” - Nëpërmjet këtij seksioni çdo qytetar shpreh mendimin e tij për çështjet që parashtrihen për diskutim në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam”, me qëllim krijimin e një forumi publik virtual diskutimi ndërmjet qytetarëve dhe administratës shtetërore.

Neni 18

Hartimi i metodave dhe i seksioneve të reja, përmirësimi ose ndryshimi i tyre

1. Agjencia, me nismën e saj ose me kërkesën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave apo titullarëve të institucioneve të administratës shtetërore, në bashkëpunim me institucionet propozuese, propozon për miratim në Këshillin e Ministrave metodat ose seksionet e reja të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”.

2. Agjencia, me nismën e saj ose me kërkesën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave apo të titullarëve të institucioneve të administratës shtetërore, në bashkëpunim me institucionet propozuese, miraton përmirësimin e metodave apo të seksioneve të platformës.

3. Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të nevojës, hartimit, bashkëpunimit, miratimit dhe funksionimit të metodave apo të seksioneve të reja të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, si dhe normat e aksesimit të të dhënave të platformës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Punonjësit që kanë akses në të dhënat

Në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” kanë akses punonjësit e Drejtorisë së Bashkëqeverisjes në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si dhe pikat e kontaktit të institucionit shtetëror për ndjekjen e çështjeve në platformë.

Neni 20

Administrimi, ekstraktimi dhe përdorimi i të dhënave

1. Në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” gjenerohet automatikisht baza e të dhënave që administrohet nga Agjencia për çdo rast: të dhënat dhe historiku i rasteve të ardhura deri në zgjidhjen e tyre përfundimtare.

2. Nga baza e të dhënave të platformës ekstrahohen të dhëna për një çështje konkrete, të cilat përdoren për përmbushjen e qëllimit të këtij ligji, si dhe kanë cilësinë e një dokumenti zyrtar me vullë elektronike ose nënshkrim elektronik.

Neni 21

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” të dhënat e qytetarëve apo të personave fizikë ose juridikë që regjistrohen në platformë mbahen konfidenciale duke iu nënshtruar mbrojtjes, ruajtjes dhe detyrimit për mospërhapje.

2. Të dhënat dhe çështjet e trajtuara nga platforma mund të publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë vetëm pas pëlqimit të individit ose të subjektit privat.

3. Në rastet e denoncimeve të korrupsionit apo të indicieve për element korruptiv, çështja i përcillet për trajtim Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, duke vënë në dijeni edhe institucionin përkatës.

4. Në platformë nuk trajtohen ankesa ose denoncime anonime.

5. Agjencia ruan konfidencialitetin e të dhënave nëse kjo kërkohet nga individ apo subjekti që bën ankesën.

6. Në çdo çështje të dhënat trajtohen në respektim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Detyrimi për konfidencialitetin dhe mospërhapjen e të dhënave shtrihet për punonjësit e Agjencisë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

8. Shkelja e detyrimit për konfidencialitet, sipas këtij neni, përbën shkelje të rëndë disiplinore edhe në rastet kur nuk passjell përgjegjësi penale sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Ndërveprimi me platformën

1. Ndërveprimi i platformës me individët apo subjektet private dhe me institucionet e administratës shtetërore kryhet vetëm në mënyrë elektronike përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”. Përgjithësisht bëjnë rastet kur çështjet parashtrihen me shkrim përmes postës në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave



Administrative, për shkak të pamundësisë së adresimit në platformë, kur ankuesi nuk ka akses në mjetet e komunikimit elektronik.

2. Përgjigjet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” përmbajnë qëndrimin zyrtar të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe janë të vlefshme vetëm me nënshkrim elektronik.

3. Procedura dhe metodologjia e ndërveprimit mes sistemeve elektronike dhe protokolleve të institucioneve për kalimin automatik në platformë të çështjeve të parashikuara në këtë ligj përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Në rastin e monitorimit të trajtimit të shkresave të subjekteve private drejtuar institucioneve të administratës shtetërore, ndërveprimi me sistemet dhe protokollet e institucioneve, rregullat dhe metodologjia përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Publikimi i të dhënave të platformës

1. Metodat e platformës gjenerojnë të dhëna, raportet e të cilave publikohen periodikisht në faqen e platformës duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Rregullat dhe procedurat për përgatitjen e raporteve dhe mënyra e raportimit përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë.

KREU VI

RREGULLAT E SEKSIONEVE TË PLATFORMËS “ME TY PËR SHQIPËRINË QË DUAM”

Neni 24

“Ankesa ime”

Nëpërmjet platformës në seksionin “Ankesa ime” paraqiten ankesa ose kërkesa të lidhura me veprimtarinë e administratës shtetërore, që ndikojnë drejtpërdrejt ankuesin, të cilat, duke u bazuar në qëllimin dhe objektin e tyre, mund të jenë:

a) mosveprimi apo neglizhenca e organeve të administratës shtetërore për të nxjerrë akte ose për të kryer veprime administrative;

b) pretendime për parregullsi ose paligjshmëri në veprimtarinë administrative të organit të administratës shtetërore. Në çdo rast këto ankesa

ose kërkesa nuk shqyrtohen në themel nga Agjencia, por trajtohen përmes ridërgimit për shqyrtim tek organi administrativ kompetent ose i ndërmjetësimit sipas rregullave të këtij ligji.

c) për rishikimin në përmbajtjen e akteve me karakter normativ për të cilat pretendohet se ka trajtim të padrejtë, të pabarabartë apo të paarsyeshëm, mangësi ose çdo shkak tjetër objektiv.

Neni 25

“Biznesi im”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Biznesi im” paraqiten ankesa ose kërkesa të lidhura me veprimtarinë e administratës shtetërore, që ndikojnë drejtpërdrejt veprimtarinë tregtare të ankuesit dhe që janë të njëjta me ato të parashikuara në nenin 24 të këtij ligji.

2. Afati i trajtimit të ankesave është 10 ditë pune nga data e regjistrimit të ankesës. Për arsye objektive, për shkak të kompleksitetit të çështjes apo të nevojës për ndërveprim ndërinstitucional, kur çështja nuk mund të shqyrtohet brenda afatit prej 10 ditësh pune, institucioni i administratës shtetërore informon Agjencinë për kohën e nevojshme dhe kërkon shtyrjen e afatit me jo më shumë se 10 ditë të tjera pune, shtyrje që miratohet nga Agjencia jo më shumë se dy herë.

3. Agjencia mbikëqyr procedurat e shqyrtimit të shkresave të paraqitura zyrtarisht nga personi fizik apo juridik pranë institucionit, si dhe respektimin e afatit dhe cilësisë së përgjigjes në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon fushën.

Neni 26

“Denonco korrupsionin”

1. Në rast se përmes seksionit “Denonco korrupsionin” bëhet një denoncim nga një qytetar, person fizik apo juridik ose grup interesi, Agjencia pas vlerësimit paraprak e dërgon menjëherë këtë denoncim pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

2. Në rast dyshimi të arsyeshëm, verifikimi të indicieve apo gjetjes së provave për ngjarjen korruptive, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit ia referon çështjen prokurorisë kompetente në përputhje me legjislacionin procedural penal në fuqi.



3. Për rastet kur denoncimi ka ardhur sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, në përfundim të shqyrtimit Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit informon Agjencinë për ecurinë e denoncimit, duke përcaktuar edhe nivelin e informacionit që mund të publikohet, brenda 20 ditëve nga përfundimi i procedurave prej tij.

4. Agjencia njofton denoncuesit për ecurinë e denoncimit të tij, duke mbajtur parasysh nivelin e informacionit që mund të publikohet sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni.

Neni 27

“Nisma ime”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Nisma ime” qytetarët, personat fizikë apo juridikë ose grupet e interesit paraqesin propozimet e tyre sipas parashikimeve të nenit 17, pika 3, shkronja “ç”, të këtij ligji, të cilat pas vlerësimit të përputhshmërisë së tyre me programin qeverisës shqyrtohen nga Agjencia në bashkëpunim me ministrinë apo institucionin që mbulon fushën e propozimit.

2. Afati i trajtimit për propozimet e ardhura në seksionin “Nisma ime” është 20 ditë pune nga data e regjistrimit të tyre.

3. Brenda afatit të përmendur në pikën 2 të këtij neni propozuesi informohet nga platforma për realizueshmërinë e propozimeve të paraqitura.

Neni 28

“Fjala ime”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Fjala ime” qytetarët, personat fizikë ose juridikë ose grupet e interesit paraqesin opinione për një qeverisje më të mirë sipas parashikimeve të nenit 17, pika 3, shkronja “d”, të këtij ligji, të cilat pas vlerësimit paraprak të tyre shqyrtohen nga Agjencia në bashkëpunim me ministrinë apo institucionin që mbulon fushën e propozimit.

2. Afati i trajtimit për çështjet e ardhura në seksionin “Fjala ime” është 20 ditë pune nga data e regjistrimit të çështjes.

3. Pas paraqitjes së propozimit, Agjencia njofton brenda afatit për hapat e ndërmarrë nga institucioni ose institucionet që mbulojnë fushën.

Neni 29

“Interpelanca ime”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Interpelanca ime” një komunitet, grup interesi, shkollë apo universitet, i përbërë nga së paku 50 persona, paraqesin kërkesat e tyre për takim publik sipas parashikimeve të nenit 17, pika 3, shkronja “dh”, të këtij ligji për çështje që kanë të bëjnë me shërbimet publike, si dhe për të gjitha problematikat që lidhen me veprimtarinë e administratës ose me politikat e qeverisë dhe që prekin ata ose komunitetin e tyre. Këto kërkesa, pas vlerësimit paraprak, shqyrtohen nga Agjencia në bashkëpunim me institucionin përkatës, të cilët organizojnë së bashku me Agjencinë një kalendar të përcaktuar dhe të publikuar në platformë për zhvillimin e interpelancës.

2. Pas përfundimit të interpelancës, pjesëmarrësit njoftohen nëpërmjet platformës për realizueshmërinë e angazhimeve çdo 30 ditë kalendarike deri në trajtimin e plotë të çështjes apo të çështjeve të trajtuara në interpelancë.

Neni 30

“Shkolla ime”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Shkolla ime” komuniteti, i përbërë nga të paktën 5 nxënës, 5 prindër dhe 5 mësues, sipas parashikimeve të nenit 17, pika 3, shkronja “e”, të këtij ligji parashtron ide ose projekte për përmirësimin e institucionit arsimor parauniversitar që i shërben atij komuniteti, të cilat shqyrtohen nga Agjencia në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse që mbulon fushën e propozimit.

2. Afati i trajtimit të këtyre ideve apo projekteve është 20 ditë pune nga data e regjistrimit të tyre.

3. Pas shqyrtimit të ideve apo projekteve, nëse ato rezultojnë në përputhje me politikën sektoriale dhe programin qeverisës, propozuesit njoftohen periodikisht nga Agjencia nëpërmjet platformës për realizueshmërinë brenda 100 ditëve pune deri në realizimin e plotë.

Neni 31

“Nota ime”

1. Nga notat e qytetarëve gjenerohet periodikisht çdo muaj një notë mesatare, e cila



bëhet publike. Ky vlerësim mundëson informimin në kohë reale të publikut dhe të qeverisë për nivelin e pëlqyeshmërisë së një shërbimi të ofruar nga institucioni publik.

2. Përmes këtij vlerësimi del edhe një koeficient për vlerësimin zyrtar të çdo drejtuesi dhe strukturave të një institucioni shërbimesh në nivel qendror apo vendor.

3. Raportimi bëhet në mënyrë periodike mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore në rubrikën përkatëse në faqen e platformës www.shqiperiaqeduam.al.

Neni 32

“Dua të kontribuoj”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Dua të kontribuoj” qytetarët paraqesin gatishmërinë e tyre për të kontribuar ose për t’u angazhuar sipas parashikimeve të nenit 17, të këtij ligji, e cila pas vlerësimit paraprak shqyrtohet nga Agjencia në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e linjës, si dhe pikat e kontaktit të DAP-it.

2. Brenda 10 ditëve pune, personi informohet për interesin e institucionit për mënyrën e angazhimit të tij, si dhe për procedurat ligjore përkatëse në lidhje me këtë angazhim.

Neni 33

“Kuvendimi ynë”

1. Nëpërmjet platformës në seksionin “Kuvendimi ynë” qytetarët në kohë reale paraqesin opinione për tema të caktuara, të publikuara në mënyrë periodike nga Agjencia, për një qeverisje më të mirë, sipas parashikimeve të nenit 17, pika 3, shkronja “g”, të këtij ligji, të cilat analizohen nga Agjencia në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e linjës.

2. Agjencia ruan të drejtën të mos publikojë mendime ose komente, të cilat përmbajnë sharje apo shpifje, si dhe sulme personale.

3. Brenda 30 ditëve pune personi informohet për analizën e kryer nga institucionet në lidhje me këtë opinion.

KREU VII

KONTROLLI I VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE

Neni 34

Kontrolli i veprimtarisë administrative

1. Veprimtaria administrative e institucioneve të administratës shtetërore, përveç kontrollit administrativ, i cili kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative për mjetet ligjore administrative dhe të legjislacionit në fuqi, si dhe të kontrollit të gjykatës, i nënshtrohet edhe kontrollit nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

2. Kontrolli nga Agjencia ka si qëllim që në kuadër të sigurimit të llogaridhënies dhe të ofrimit të shërbimeve publike të garantojë kryerjen e veprimtarisë administrative nga institucionet e administratës shtetërore në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi.

3. Agjencia në bashkëpunim me institucionin e administratës shtetërore verifikon kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për kontrollin e veprimtarisë administrative të institucionit të administratës shtetërore. Kur është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative të thelluara për konstatimin e fakteve të nevojshme të çështjes, titullari i institucionit, me paraqitjen e kërkesës së drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, miraton krijimin e një grupi pune, pjesë e të cilit do të jenë personat e ngarkuar nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë sipas përcaktimit në kërkesë.

Neni 35

Ankesat për kontrollin e veprimtarisë dhe elementet formale të saj

1. Ankesat që i drejtohen Agjencisë për kontrollin e veprimtarisë administrative mund të jenë:

a) në format elektronik në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam”;

b) në raste që bëjnë përjashtim, në formë të shkruar, pranë Agjencisë, e cila merr masat për hedhjen e të dhënave përkatëse në platformë.

2. Grupet e interesit mund të kërkojnë kryerjen e kontrollit të veprimeve administrative të lidhura me çështjet që prekin individët apo komunitetin e



përfaqësuar pre tyre, duke marrë paraprakisht pëlqimin me shkrim të tyre, si dhe duke parashtruar në mënyrë konkrete e të besueshme pretendimet, arsyet dhe faktet mbi të cilat bazohet kërkesa.

3. Ankesa duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për të përcaktuar kërkuar dhe qëllimin e saj dhe veçanërisht duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit (NID ose NUIS) të ankuesit;
- b) të dhënat e kontaktit;
- c) shpjegimin për aktin ose veprimin administrativ të kërkuar nga ankuesi, si dhe për rrethanat e mosveprimit të organit përgjegjës;
- ç) prokurën ose autorizimin për ta përfaqësuar në rast se kërkesa bëhet nga avokati ose përfaqësuesi i ankuesit.

4. Nëse paraqitet me shkrim, nëpunësi i Agjencisë regjistron të dhënat e mëposhtme në formatin e platformës:

- a) numrin unik të identifikimit (NID ose NUIS) të ankuesit;
- b) datën e marrjes në dorëzim të ankesës;
- c) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten ankesës, nëse ka të tilla;
- ç) të dhënat e kontaktit.

5. Ankesa nuk pranohet nëse:

- a) është anonime;
- b) përbën haptazi abuzim me të drejtën e paraqitjes së ankesës para Agjencisë ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;
- c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;
- ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

6. Paraqitja e kërkesës për kontrollin e veprimtarisë administrative të një institucioni të administratës shtetërore është pa pagesë.

Neni 36

Regjistrimi i ankesës dhe njoftimi i palëve

1. Ankesa regjistrohet në Agjenci sipas një numri unik, të cilin çështja e merr në momentin e regjistrimit në platformë. Numri unik është pjesë e regjistrimit të posaçëm të çështjeve. Regjistri i ankesave për kontrollin e veprimtarisë

administrative përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin unik të ankesës;
- b) datën e regjistrimit;
- c) objektin e ankesës;
- ç) dokumentet që i bashkëngjiten ankesës;
- d) dokumentin e identifikimit, *e-mail*-in, numrin e kontaktit të ankuesit dhe adresën në rastin e paraqitjes së ankesës në format joelektronik.

2. Për ankesat e paraqitura nëpërmjet platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” ose të paraqitura me shkrim pranë Agjencisë dhe të hedhura prej saj në platformë nëpërmjet postës elektronike të platformës merret vërtetimi i paraqitjes së ankesës, i cili përmban numrin unik të ankesës, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla. Paraqitja e ankesës nëpërmjet sistemit postar vërtetohet nga dokumenti postar.

Neni 37

Pasaktësitë e ankesës

1. Në qoftë se ankesa nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e këtij ligji, Agjencia brenda 24 orëve i kërkon ankuesit nëpërmjet postës elektronike që të korrigjojë pasaktësitë brenda 2 ditëve pune nga dita e marrjes së kërkesës për korrigjim.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, dhe për aq sa është e mundur, Agjencia i korrigjon vetë pasaktësitë e ankesës, duke mos i dëmtuar interesat ligjore të palëve të interesuara.

3. Kur ankuesi plotëson pasaktësitë brenda afatit të përcaktuar, ajo quhet e regjistruar nga momenti i saktësimit të ankesës.

4. Kur ankuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar dhe këto pasaktësi nuk mund të plotësohen nga Agjencia sipas pikës 2 të këtij neni, ankesa quhet se nuk është regjistruar dhe për këtë vihet në dijeni ankuesi përmes postës elektronike ose shërbimit postar, sipas rastit.

Neni 38

Verifikimi paraprak përpara fillimit të shqyrtimit të ankesës

1. Pas regjistrimit të ankesës dhe përpara fillimit të shqyrtimit të saj, Agjencia kryen verifikimet:

- a) për legjitimitetin e palës që ka paraqitur ankesën;



b) nëse është paraqitur më vonë se tre vjet nga ndodhja e fakteve;

c) nëse ankesa mund të shqyrtohet së bashku me ankesat e palëve të tjera, kur bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore;

ç) nëse për të njëjtën çështje ka një vendim të formës së prerë ose çështja është në proces shqyrtimi nga prokuroria apo nga gjykata, siç mund të referohen në ankesë ose nga komunikimi me institucionin përkatës;

d) nëse përbën haptazi abuzim me të drejtën e paraqitjes së ankesës para Agjencisë ose është në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;

dh) nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankesë tjetër, ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;

e) mbi mundësinë e zgjidhjes së çështjes së paraqitur;

ë) nëse çështja bën pjesë ose jo në fushën e kompetencave të Agjencisë. Në rast se trajtimi i çështjes del jashtë kompetencave të Agjencisë, kjo e fundit orienton kërkuesin apo ankuesin për organin kompetent ku duhet të drejtohet.

2. Agjencia vendos mosfillimin e shqyrtimit të ankesës nëse pas verifikimeve paraprake vërtetohet ekzistenca e shkaqeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ose ndërpret shqyrtimin e ankesës në rast të rishikimit të procesit të vlerësimit paraprak.

3. Agjencia njofton ankuesin në lidhje me rezultatin e verifikimeve paraprake.

Neni 39

Mënyra e verifikimit të veprimtarisë administrative

1. Agjencia vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe përcakton mënyrën e verifikimit në veprimtarinë administrative lidhur me objektin e ankesës apo kërkesës së paraqitur.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte apo rrethana të nevojshme për verifikimin e veprimtarisë administrative, vendosen në dispozicion të Agjencisë nga institucioni i administratës shtetërore kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera shtetërore. Institucioni i administratës shtetërore mund t'i kërkojë ankuesit vetëm informacionin e nevojshëm për identifikimin e

dokumentacionit, përveç rasteve kur dokumentacioni disponohet vetëm nga ankuesi.

Neni 40

Shqyrtimi i ankesës

1. Koordinatori fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes në bazë të ankesës së ardhur apo të hedhur në platformë dhe, pasi kryen vlerësimin paraprak, e dërgon atë për informacion të mëtejshëm dhe procedim pranë organeve kompetente nëpërmjet platformës.

2. Pasi vihet në dijeni për ankesën, institucioni publik, jo më vonë se dy ditë pune nëse:

a) konstaton paqartësi në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, i kërkon koordinatorit të bëjë sqarimet e nevojshme;

b) natyra e çështjes e kërkon, përjashtimisht, me miratimin paraprak të Agjencisë, institucioni mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë parashtrime me shkrim brenda afatit 48 orë;

c) konstaton se nuk ka kompetencë, ia kthen ankesën Agjencisë nëpërmjet platformës, e cila menjëherë e dërgon ankesën në institucionin publik kompetent.

3. Gjatë shqyrtimit të ankesës, nëse Agjencia konstaton se përtej shpjegimeve të paraqitura nga organi kompetent, trajtimi i çështjes kërkon këshillimin ligjor të ankuesit për rastin, ajo mund ta referojë/ta delegojë atë te Drejtoria e Ndhmës Ligjore Falas, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila e shqyrton kërkesën në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti.

4. Kur e sheh të përshtatshme, Agjencia zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar, si dhe mund të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe organit kundër të cilit është paraqitur ankesa, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin në fuqi që rregullon fushën.

Neni 41

Procedura dhe afatet e shqyrtimit të ankesës

1. Nëse gjatë shqyrtimit të ankesës institucioni i administratës shtetërore konstaton se zgjidhja e saj kërkon nxjerrjen e një akti administrativ, kryerjen e



veprimeve administrative apo ofrimin e shërbimeve, kjo duhet të realizohet brenda afatit prej 10 ditësh pune nga momenti i regjistrimit të ankesës në platformë. Institucioni i administratës shtetërore njofton Agjencinë dhe palët e tjera të interesuara, nëse ka të tilla, në lidhje me verifikimin e kryer apo vendimin e marrë. Agjencia regjistron përfundimin e shqyrtimit të ankesës dhe përcakton nëse përveç masave me karakter individual mund të ketë nevojë edhe për masa me karakter të përgjithshëm duke rekomanduar zgjidhjen përkatëse.

2. Nëse nxjerrja e aktit, kryerja e veprimit administrativ ose ofrimi i shërbimit, përmendur në pikën 1 të këtij neni, nuk mund të realizohet brenda afatit prej 10 ditësh pune, institucioni i administratës shtetërore informon Agjencinë për kohën e nevojshme dhe kërkon shtyrjen e afatit me jo më shumë se 10 ditë të tjera pune, shtyrje që miratohet nga Agjencia jo më shumë se dy herë. Në mungesë të një afati për kryerjen e veprimit administrativ apo ofrimin e shërbimit në legjislacionin e posaçëm, zbatohet afati 60-ditor i kryerjes/i ofrimit, i parashikuar në nenin 91, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Për efekt të zbatimit të këtij neni, afatet e organit administrativ për nxjerrjen e aktit/ kryerjen e veprimit/ofrimin e shërbimit fillojnë nga momenti kur organi merr njoftimin nga Agjencia për fillimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës. Përmbushja e këtij detyrimi nuk e përjashton institucionin dhe/ose punonjësën nga përgjegjësitë për vonesën e paligjshme para njoftimit dhe as nga masat e parashikuara në kreun X të këtij ligji.

4. Pavarësisht afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, kur Agjencia konstaton se institucioni i administratës shtetërore ka neglizhuar detyrat e tij, pasi nuk ka nisur procedurën, nuk ka miratuar urdhrin e ngritjes së grupit të punës ose ka tejzgjatur etapat procedurale, me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë caktohet një afat më i shkurtër nëse nga tërësia e rrethanave dhe e fakteve apo nga natyra e procedurës, aktit ose veprimit të kërkuar vlerëson se ato mund të kryhen brenda një afati të tillë.

5. Agjencia ndjek dhe mbikëqyr ecurinë e zbatimit të detyrimeve të institucionit të administratës shtetërore sipas këtij neni, duke zbatuar edhe masat detyruese të parashikuara në kreun X të këtij ligji.

6. Agjencia apo institucioni i administratës shtetërore nuk e ngarkon ankuesin me ndonjë tarifë për shqyrtimin e ankesës.

Neni 42

Veprimet pas përfundimit të shqyrtimit të ankesës

1. Pas përfundimit të verifikimit të veprimtarisë administrative Agjencia:

a) njofton ankuesin për rezultatin e verifikimit dhe masat e marra dhe/ose jep sqarimet e nevojshme, si dhe propozon masa të përgjithshme, nëse është rasti, si më poshtë:

i. rekomandim ndaj institucionit të administratës shtetërore apo organit të tij epror për nxjerrjen ose ndryshimin e një akti administrativ, në rast se çmon që nga mosveprimi ose veprimi në kundërshtim me ligjin janë cenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve;

ii. kërkesë drejtuar institucionit të administratës shtetërore ose organit epror të tij për zhvillimin e hetimeve administrative shtesë dhe njoftim për rezultatet e hetimit;

iii. kërkesë për ndryshimin e rregullave dhe të procedurave të brendshme të institucioneve ose strukturës së tyre, si dhe propozim drejtuar institucionit shtetëror përgjegjës për ndërmarrjen e nismës për ndryshimin e akteve ligjore ose nënligjore në rastet kur vlerëson se ofrimi i shërbimeve publike nuk mund të realizohet me efektivitet për shkak të pengesave që krijohen nga rregullat dhe procedurat e brendshme, nga struktura e institucionit të administratës shtetërore ose nga aktet ligjore ose nënligjore në fuqi;

iv. zbatim të parashikimeve të nenit 56 të këtij ligji.

b) refuzon ankesën nëse në përfundim të verifikimit rezulton se ajo është e pabazuar dhe njofton ankuesin për rezultatet e tij dhe masat e marra nëse është rasti.

2. Nëse gjatë ushtrimit të funksionit të saj sipas këtij ligji, Agjencia konstaton mosmarrëveshje kompetencash apo mosbashkërendim mes ministrive, drejtori i Përgjithshëm i saj informon menjëherë Kryeministrin duke i propozuar ndërhyrje për zgjidhjen e çështjes.



KREU VIII
NDËRMJETËSIMI PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJEVE ME PAJTIM
PËRMES AGJENCISË PËR DIALOG DHE
BASHKËQEVERISJE

Neni 43
Autorizimi

1. Nëpërmjet këtij ligji Agjencia autorizohet të kryejë funksionin e ndërmjetësit ndërmjet palëve të interesuara, personave fizikë ose juridikë privatë dhe institucionit të administratës shtetërore përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të tyre nëse pas shqyrtimit të tyre, sipas parashikimeve të kreut VII të këtij ligji, ankuesi nuk është i kënaqur me zgjidhjen e ofruar, nëse ka.

2. Funksionin e ndërmjetësit sipas autorizimit të këtij neni, Agjencia e ushtron vetëm nëpërmjet punonjësve të saj që plotësojnë njëkohësisht këto kushte:

- a) të kenë kryer programe të studimeve juridike të ciklit të dytë ose ekuivalente me to, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë;
- b) të kenë eksperiencë profesionale jo më pak se tre vjet;
- c) të mos jenë dënuar për kryerjen me dashje të veprave penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Punonjësit përgjegjës për ndjekjen e procedurës së ndërmjetësimi caktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë pas verifikimit të kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.

Neni 44
Procedura për ndërmjetësim

1. Procedura për ndërmjetësim fillon pas datës së paraqitjes së ftesës për ndërmjetësim nga të paktën njëra nga palët në mosmarrëveshje me organin administrativ. Agjencia mund të propozojë fillimin e procedurës së ndërmjetësimi nëse palët shohin interesin e paraqitur me shkrim.

2. Procedura e ndërmjetësimi duhet të mos e kalojë afatin 10-ditor nga shprehja e interesit të ankuesit për të përdorur këtë mjet ligjor, afat i cili

mund të përsëritet për arsye objektive edhe 10 ditë të tjera pune.

3. Ftesa për ndërmjetësim, e paraqitur nga një palë në mosmarrëveshje, nuk pengon automatikisht këtë palë që të iniciojë fillimin e një procesi gjyqësor apo arbitrazhi në lidhje me këtë mosmarrëveshje për shkak të kalimit të afateve të paraqitjes së padisë.

4. Brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, institucioni shtetëror duhet të shprehet në mënyrë të arsyetuar për faktin nëse do të marrë pjesë ose jo në procedurën e ndërmjetësimi, duke argumentuar qëndrimin e tij me bazën ligjore përkatëse.

Neni 45
Zhvillimi i ndërmjetësimi

1. Përpara fillimit të procedurës së ndërmjetësimi, Agjencia është e detyruar që të informojë palët për qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe të palëve në proces, si dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësimi.

2. Palët, organi administrativ dhe Agjencia nënshkruajnë marrëveshjen për realizimin e procesit të ndërmjetësimi, ku përcaktohen:

- a) gjeneralitetet e palëve të kësaj marrëveshjeje dhe të përfaqësuesve të tyre;
- b) përshkrimi i objektit të mosmarrëveshjes;
- c) pranimi i parimeve të ndërmjetësimi sipas këtij ligji dhe të ndërmjetësit të caktuar;
- ç) vendi i ndërmjetësimi.

3. Në çdo çështje, në zbatimin e procedurave të ndërmjetësimi, Agjencia duhet të kujdeset për të siguruar një procedurë ndërmjetësimi falas, trajtim të njëjtë, të drejtë dhe të paanshëm të palëve, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.

4. Kur nuk vendoset paraprakisht ndryshe nga palët, në çdo fazë të zbatimit të procedurave të ndërmjetësimi, me kërkesë ose me miratim nga palët, Agjencia mund të propozojë një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes. Ky propozim nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga palët, përveçse kur ato bien dakord.



Neni 46

Komunikimi me palët

1. Përveçse kur vendoset ndryshe nga palët, Agjencia mund të takojë ose të komunikojë me palët së bashku ose veçmas me secilën prej tyre.

2. Agjencia, pasi njihet me rrethanat dhe të dhënat e ofruara nga njëra palë në mosmarrëveshje, mund t'i parashtojë palës tjetër çështjet thelbësore që rezultojnë nga këto rrethana, përveç rastit kur pala i ka bërë të ditur Agjencisë të dhëna të cilat i ka përcaktuar shprehimisht si konfidenciale. Në këtë rast, paraqitja e të dhënave konfidenciale te pala tjetër bëhet vetëm me pëlqimin e palës së parë.

Neni 47

Konfidencialiteti

1. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbetet konfidenciale.

2. Pavarësisht nga rregulli i ruajtjes së konfidencialitetit, bëhen publike të dhënat dhe përmbajtja e marrëveshjes së arritur në çështjet kur:

a) është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelore të shtetit dhe/ose interesit publik;

b) është e nevojshme për parandalimin ose ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;

c) është e nevojshme për parandalimin ose ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;

ç) nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/ose marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Neni 48

Mospërdorimi i të dhënave

Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, një palë që merr pjesë në procedurën e ndërmjetësimit ose një person i tretë, përfshirë edhe Agjencinë, nuk mund të kërkojë ose të përdorë në një proces gjyqësor, arbitrazhi ose në ndonjë procedurë tjetër të ngjashme, prova ose dëshmi, pavarësisht nga forma e tyre, si më poshtë:

a) ftesën e një pale për të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimit ose veprimin me të cilin njëra nga palët ka shprehur vullnetin për të marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit;

b) mendimet e shprehura ose sugjerimet e bëra nga njëra palë gjatë ndërmjetësimit ose nga Agjencia për zgjidhjen e mundshme të mosmarrëveshjes;

c) deklaratat ose pohimet e bëra nga njëra palë gjatë zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit;

ç) propozimet e bëra nga Agjencia;

d) faktin që njëra nga palët në procedurën e ndërmjetësimit ka shprehur vullnetin për të pranuar propozimin e bërë nga Agjencia ose zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

dh) një dokument të përgatitur vetëm për qëllim të procedurës së ndërmjetësimit.

Neni 49

Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit

Procedura e ndërmjetësimit përfundon:

a) ditën e nënshkrimit të marrëveshjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

b) ditën e nënshkrimit të deklaratës me shkrim të Agjencisë pas këshillimit me palët që ndërmjetësohen, kur përpjekjet për ndërmjetësim të mëtejshëm nuk janë të justifikuara;

c) ditën e nënshkrimit të deklaratës me shkrim të palëve ndërmjetëse, me anë të së cilës i drejtohen Agjencisë, ku i njoftojnë se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar;

ç) ditën e nënshkrimit të deklaratës me shkrim të njëres palë, drejtuar palës tjetër, Agjencisë, ku njoftohet se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar;

d) me vdekjen e ndonjëres nga palët në proces;

dh) me likuidimin e personit juridik palë në proces.

Neni 50

Aktmarrëveshja

1. Kur palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me Agjencinë nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse me shkrim, në kuptim dhe në zbatim të kushteve, të çështjeve dhe të procedurave të parashikuara në këtë ligj. Kjo marrëveshje është e



detyrueshme dhe e ekzekutueshme për institucionin publik dhe ankuesin.

2. Në aktmarrëveshje përcaktohen:

- a) palët;
- b) përkrimi i mosmarrëveshjes;
- c) detyrimet dhe kushtet që palët i vënë njëra-tjetrës, mënyra dhe afati i përmbushjes së tyre;

ç) nënshkrimi i palëve dhe i përfaqësuesit të Agjencisë. Afati për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje vendoset nga palët në mirëkuptim me njëra-tjetrën. Aktmarrëveshja duhet të përmbajë detyrime të qarta dhe saktësisht të përcaktuara.

3. Aktmarrëveshja hartohet në tri kopje, një për secilën palë dhe një kopje që depozitohet tek Agjencia, e cila është e detyruar të administrojë çdo aktmarrëveshje dhe dokumentacion lidhur me to.

Neni 51

Zbatimi i marrëveshjes së ndërmjetësimit

Nëse aktmarrëveshja respekton kushtet e përcaktuara në këtë ligj, përbën titull ekzekutiv.

KREU IX

BASHKËQEVERISJA ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 52

Marrëveshjet me njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje kuadër me Agjencinë për qëllime të këtij ligji, për trajtimin e çështjeve nën fushën e përgjegjësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga organi përfaqësues i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nënshkruhet nga organi ekzekutiv.

Neni 53

Kushtet e marrëveshjes

Marrëveshja që lidhet midis njësive të vetëqeverisjes vendore, nga njëra anë, dhe Agjencisë duhet të përmbajë:

- a) metodat e bashkëqeverisjes që përdoren nga njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe rregullat e

zbatueshme për përfshirjen e metodave të reja ose ndryshimin e tyre;

b) rregullat për verifikimin e veprimtarisë administrative;

c) kohëzgjatjen dhe mënyrën e zgjidhjes së marrëveshjes.

KREU X

INSPEKTIMI DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 54

Inspektimi

1. Inspektimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji për bashkëqeverisjen nga institucionet e administratës shtetërore kryhet nga koordinаторët e Agjencisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi për inspektimin.

2. Gjatë inspektimeve koordinаторët duhet të verifikojnë, por pa u kufizuar:

a) zbatimin e mekanizmave për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore, sipas parashikimeve të këtij ligji;

b) përgjegjshmërinë dhe ndërveprimin e institucioneve të administratës shtetërore me çdo qytetar, person fizik ose juridik, si dhe grupet e interesit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

c) veprimtarinë administrative të institucioneve të administratës shtetërore, veçanërisht duke pasur në konsideratë afatin e ofrimit të shërbimit;

ç) organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në fushën e veprimtarisë së tyre;

d) zbatimin e detyrimeve ligjore, si dhe të udhëzimeve të ndryshme të dhëna nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Neni 55

Konstatimi i shkeljeve

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji konstatohet nga koordinatori i Agjencisë dhe për këtë mbahet procesverbali përkatës sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për inspektimin.



2. Mënyra e konstatimit dhe e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative realizohet në bazë të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative. Format i procesverbalit të konstatimit të shkeljes miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë.

Neni 56

Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative: shkeljet e mëposhtme:

a) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 13 të këtij ligji;

b) moszbatimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i detyrimit për ndërveprimin e sistemeve të institucioneve me platformën, sipas nenit 22 të këtij ligji;

c) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 25, pika 2, të këtij ligji;

ç) mosrespektimi nga titullari i parashikimeve të nenit 27, pika 2, të këtij ligji;

d) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 28, pika 2, të këtij ligji;

dh) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 29 të këtij ligji;

e) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 30, pika 2, të këtij ligji;

ë) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 32, pika 2, të këtij ligji;

f) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 33, pika 3, të këtij ligji;

g) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 39, pika 2, të këtij ligji;

gj) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i afatit të parashikuar në nenin 40, pika 2, të këtij ligji;

h) mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe/ose titullari i parashikimeve të nenit 41, pikat 1, 2, 3 dhe 4, të këtij ligji;

i. mosrespektimi nga nëpunësi përgjegjës dhe / ose titullari i parashikimeve të nenit 61 të këtij ligji.

2. Në përfundim të inspektimit, në rastet kur konstatohen shkelje sipas pikës 1 të këtij neni, Agjencia ndërmerr një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) i rekomandon institucionit përgjegjës të administratës shtetërore fillimin e procedimit disiplinor ndaj çdo nëpunësi që ka shkelur dispozitat e këtij ligji, si dhe marrjen e një mase disiplinore të përshtatshme për shkeljen e konstatuar, përfshirë largimin nga detyra. Në përfundim të procedimit disiplinor, institucioni përgjegjës i administratës shtetërore është i detyruar të njoftojë Agjencinë për rezultatet e procedimit disiplinor;

b) i propozon ministrit përgjegjës ose Kryeministrit lirim nga detyra të titullarit të institucionit të administratës shtetërore;

c) urdhëron institucionin e administratës shtetërore që brenda afatit prej 30 ditësh pune nga data e marrjes së urdhrit, të marrë masa të karakterit organizativ për të rritur eficiencën e veprimtarisë administrative të institucionit, veçanërisht në lidhje me trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, personave fizikë ose juridikë dhe grupet e interesit. Në rast se institucioni arsyeton me kërkesë me shkrim se afati 30-ditor është i pamjaftueshëm, agjencia vendos një afat të ri, por jo më shumë se 30 ditë të tjera pune. Moszbatimi i afatit të ri përbën shkelje dhe dënohet sipas pikës 3 të këtij neni. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

3. Me përjashtim të shkeljeve që lidhen me mosrespektimin e neneve 41, pika 3, dhe 61 të këtij ligji, për shkeljet e tjera të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përveç masave disiplinore që përcaktohen në pikën 2 të këtij neni, zbatohen edhe dënimet si më poshtë:

a) me gjobë nga 10 000 lekë deri në 60 000 lekë ndaj institucionit të administratës shtetërore;

b) me gjobë nga 10 000 lekë deri në 60 000 lekë ndaj nëpunësit publik të institucionit të administratës shtetërore;

c) me gjobë nga 30 000 lekë deri në 80 000 lekë ndaj titullarit të institucionit të administratës shtetërore.

4. Vendimi për vendosjen e masave dhe sanksioneve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, jepet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.



5. Kur vendos masën apo sanksionin, Agjencia siguron që ajo të jetë:

- a) e efektshme dhe parandaluese;
- b) në përpjesëtim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, Agjencia përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh:
 - i. natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes;
 - ii. rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave;
 - iii. nëse shkelja është e përsëritur.

Neni 57

Ankimi

1. Ankimi administrativ kundër gjobës së vendosur për shkeljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe të legjislacionit në fuqi për inspektimin të Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

2. Rregullat për ngritjen e komisionit të ankimit, përbërjen e tij, kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve dhe procedurën e shqyrtimit miratohen me urdhër të Kryeministrit.

Neni 58

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i gjobave në zbatim të këtij ligji bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 59

Hedhja në platformë e ankesave të ardhura përmes protokollit të institucioneve

1. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore që të gjitha tipologjitë e çështjeve, të cilat në kuptim të këtij ligji janë objekt i platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, të hedhin në platformën elektronike ankesat që administrohen fizikisht në rrugë zyrtare, çështjet për të cilat në pamundësi të adresimit në platformë qytetari apo subjekti ka bërë një ankesë me shkrim.

2. Institucionet e administratës shtetërore, objekt zbatimi i këtij ligji, ngarkohen të mos pranojnë më letra fizike nga qytetarët për çështje që lidhen me problematika, objekt trajtimi nga platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”. Përrjashtim bëjnë vetëm rastet e cituara në pikën 1 të këtij neni.

3. Të gjitha komunikimet midis qytetarëve apo subjekteve private me platformën dhe të platformës me institucionin përgjegjës kryhen përmes sistemit elektronik të platformës nga ku gjurmohet vijimësia e çështjeve deri në përfundimin e tyre.

4. Procedurat dhe metodologjia e hedhjes së ankesave fizike në platformë deri në tërheqjen e plotë të shkresave përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë.

Neni 60

Ankesat në të gjitha nivelet e administratës

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji të gjitha zyrat për marrëdhënie me publikun në administratën shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave pushojnë së ekzistuari dhe çështjet e ankesave të parashikuara në këtë ligj do të trajtohen vetëm nga platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”. Punonjësit e këtyre zyrave, në rast pamundësie të ricaktimit të tyre në pozicione pune të tjera brenda të njëjtave institucione, trajtohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil për mbylljen ose ristrukturimin e institucionit, apo me dispozitat e Kodit të Punës, në varësi të kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet e tyre të punës sipas aktit të krijimit të institucionit.

2. Prej datës 1.1.2023 institucionet shtetërore pranojnë ankesa në lidhje me veprimtarinë e tyre vetëm nëpërmjet platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, me përjashtim të rasteve të veçanta të parashikuara në nenin 22, pika 1, të këtij ligji.

Neni 61

Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)

1. Ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet shërbimofruese, aplikimet e të cilave realizohen nëpërmjet platformës “e-Albania”, do të realizohet vetëm elektronikisht duke siguruar lëshimin e



dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.

2. Agjencia është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të afateve dhe të përdorimit të SQDNE-së në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në marrjen e shërbimit dhe të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik nga qytetarët dhe subjektet sipas afateve ligjore.

3. Procedurat dhe metodologjia e monitorimit dhe e kontrollit të veprimtarisë administrative sipas pikës 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 62
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, pikat 2 dhe 7; 16, pika 4; 18, 22, pikat 3 e 4; 56, pika 4 dhe 61, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Agjencia që brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 26, pika 4; 55, pika 2 dhe 59, pika 4, të këtij ligji.

3. Deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në këtë ligj, aktet nënligjore ekzistuese në fushën e bashkëqeverisjes mbeten në fuqi për aq sa nuk bien ndesh me të.

Neni 63
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.11.2021.

LIGJ
Nr. 111/2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 49, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave, është 10 për qind. Lista e kategorive të inputeve bujqësore, sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 51, shkronja “nj” shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 56, pika 38, bëhen ndryshimet si më poshtë:

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006, “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, numri CELEX 32006L0112, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 11.12.2006, faqe 1–118.



1. Në shkronjën “a”, fjalët “50 milionë lekë;” zëvendësohen me fjalët “500 milionë lekë;”.

2. Shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 148 fjalët “6 për qind” zëvendësohen me fjalët “0 për qind.”.

Neni 5

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për autorizimet e përjashtimit nga TVSH-ja, të lëshuara nga administrata doganore, para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për këtë kategori autorizimesh nuk lejohet shtyrja e afatit të përmbushjes së tyre.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.11.2021.

LIGJ
Nr. 112/2021

PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 9975,
DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT
KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 11 shtohen pikat 12 deri 16 me këtë përmbajtje:

“12. Taksë për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur, të përfshirë në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së.

13. Taksë për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara, të përfshirë në kodet 0404 90 21, 0404 90 23 dhe 0404 90 29 të NKM-së.

14. Taksë për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit, të përfshirë në kreun 0404 10 të NKM-së.

15. Taksë për importimin dhe prodhimin e krem qumështit, të përfshirë në kreun 0402 të NKM-së.

16. Taksë për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare.”.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 11 shtohen pikat 12 deri 16 me këtë përmbajtje:

“12. Taksa për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur është në vlerën 100 lekë/kg.

13. Taksa për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara është në vlerën 16 lekë/litër.

14. Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

15. Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

16. Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, është në vlerën 40 lekë/litri.”.

Neni 3

Në nenin 5, pas shkronjës “g” shtohen shkronjat “h” deri në “l” me këtë përmbajtje:

“h) për taksën e importimit dhe prodhimit të qumështit pluhur, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

i) për taksën e importimit dhe prodhimit për pijet e homogjenizuara, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;



j) për taksën e importimit dhe prodhimit për hirrën e qumështit, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

k) për taksën e importimit dhe prodhimit për krem qumështi, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

l) për taksën për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, organet doganore.”.

Neni 4

Në nenin 9, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Përfshihen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë të evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin përfundimtar. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit sipas kësaj pike përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.11.2021.

LIGJ

Nr. 115/2021

PËR BUXHETIN E VITIT 2022

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I BUXHETI

Neni 1

Buxheti për vitin 2022 është:

Të ardhurat	536 811 milionë lekë;
Shpenzimet	637 694 milionë lekë;
Deficiti	100 883 milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2022 është:

Të ardhurat	397 179 milionë lekë;
Shpenzimet	498 062 milionë lekë;
Deficiti	100 883 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2022 është:

Të ardhurat	60 290 milionë lekë,
nga të cilat:	
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 723 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	9 305 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	32 262 milionë lekë;
Shpenzimet	60 290 milionë lekë.



Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2022 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat gjithsej	147 203 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet	94 119 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	47 194 milionë lekë;
- transfertat për indeksimin e pensioneve	2 390 milionë lekë;
- bonusi i pensionistëve	3 500 milionë lekë;
Shpenzimet	147 203 milionë lekë

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2022 teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar.

Të ardhurat gjithsej	7 732 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet	1 896 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 656 milionë lekë;
- transfertat për indeksimin e pensioneve	180 milionë lekë;
Shpenzimet	7 732 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 570 milionë lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 900 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 është:

Të ardhurat gjithsej	52 836 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	14 985 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	37 851 milionë lekë;
Shpenzimet	52 836 milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë detyrimet e prapambetura dhe rimbursimin e medikamenteve për kurimin e COVID-19. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2022 është:

Të ardhurat gjithsej	4 500 milionë lekë,
nga të cilat:	
- të ardhura të tjera	1 000 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	3 500 milionë lekë;
Shpenzimet	4 500 milionë lekë.

Neni 7

Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 20 000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja.

Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji.



Neni 8

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II
BURIMET PËR MBËSHTETJEN E
SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË
SHTETIT

Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	13 994 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	360 535 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	22 650 milionë lekë.

Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 50 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 632 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative si më poshtë:

- huamarrje afatgjatë të destinuara për projekte me vlerë rreth 25 002 milionë lekë;
- huamarrje në formën “mbështetje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 17 409 milionë lekë;
- ripagesa të principalit me vlerë rreth - 42 529 milionë lekë;
- nën-hua për pushtetin vendor me vlerë rreth 750 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth 50 251 milionë lekë.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III
SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 11

Shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

- shpenzime të buxhetit qendror	490 362 milionë lekë;
- fondi rezervë i buxhetit	2 900 milionë lekë;
- kontingjencë për risqet e borxhit	4 800 milionë lekë;

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale është sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 përcaktohen kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2023 dhe 2024. Transferata e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2022.

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitet 2022 dhe 2023, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.



Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit, të përcaktuara në shpenzimet korrente të programit buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi prej 2 400 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi i shpronësimeve prej 1147.5 milionë lekësh transferohet në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.

Fondi prej 200 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përdoret për parafinancimin, bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj. Procedurat e shpërndarjes së këtij fondi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 3, si dhe në tabelat 1 dhe 3, që përmenden respektivisht në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.

Neni 12

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 84 214 veta. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2 në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese ose krijimit të institucioneve të reja.

Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve/funksioneve të reja.

Këshilli i Ministrave përcakton numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Rregullat për kontraktimin dhe pagesën e punonjësve të

përkohshëm përcaktohen në aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Për vitin 2022 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përlogaritur sipas gradave të miratuara.

Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 300 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Metodologjia e llogaritjes së pagës mujore bruto për institucionet e sistemit të drejtësisë miratohet me vendim të Kuvendit.

Neni 14

Fondi rezervë prej 2 900 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave si më poshtë:

a) 2 400 milionë lekë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;

b) 500 milionë lekë për projektin për fëmijët dhe rininë.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 800 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.



Neni 15

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore sipas formulës së paraqitur në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga ministria përgjegjëse për financat në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për programin buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja të transferuara në bashkitë shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4 që i bashkëlidhen këtij ligji.

Personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta.

Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

Fondi për emergjencat civile, në masën 1000 milionë lekë, akordohet në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky fond shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Fondi prej 810 milionë lekësh në zërin shpenzime kapitale në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes përdoret sipas kriterëve në aneksin 6 bashkëlidhur këtij ligji.

Fondi për mbetjet urbane në masën 500 milionë lekë akordohet si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbetjet urbane në kolonën “Menaxhimi i mbetjeve” dhe përdoret/shpërndahet në përputhje

me kriteret e vendosura në aneksin 7 bashkëlidhur këtij ligji.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për financim/bashkëfinancim për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe asaj sportive pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sportin. Ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin nxjerr udhëzim për kriteret, procedurat, afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 16

Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive:

- a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) granti i mësimdhënies;
- c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në nenet 111 dhe 113 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë mund të shpërndahet edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore në ato raste kur me vendim të Këshillit të Ministrave ato përcaktohen autoritete kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit për studim-projektimin apo zbatimin e projektit për një ose disa institucione të arsimit të lartë. Në këto raste, çelja e fondit nga ministria përgjegjëse për financat bëhet pas paraqitjes së kërkesës nga njësia e vetëqeverisjes vendore përmes ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 17

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës 1 që përmendet në nenin 11 të këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve



brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Të drejtat e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 9636, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore përcaktojnë treguesit e faktit në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 18

Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2021, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, është 41.9% e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.

Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2022, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 56 503 milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 50 632 milionë lekë;

- për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese deri në 5 871 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 482 492 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 408 452 milionë lekë;

- stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 73 390 milionë lekë;

- stoku i borxhit të qeverisjes vendore 650 milionë lekë.

Neni 20

Në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucionet financiare ndërkombëtare, vlerat indikative respektive të përcaktuara në nenet 10 dhe 19 të këtij ligji, mund të rriten automatikisht. Ndërkohë, niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2022 mbetet i pandryshuar sipas përcaktimit në nenin 1 të këtij ligji.

Këshilli i Ministrave mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore.

Neni 21

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.11.2021.

ANEKS 1
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR,
FORMULA E NDARJES SË FONDEVE,
KRITERET DHE KOEFICIENTËT
E VITIT 2022

1. Transferta e pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar (TP) rregullohet nga ligji nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV). Si rregull i përgjithshëm, transferata e pakushtëzuar ka për qëllim t’u sigurojë njësitë të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për



shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Duke qenë se NJVQV-të janë të ndryshme për sa u përket nevojave dhe kapacitetit fiskal, në një sistem efikas dhe të drejtë të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar duhet të merren parasysh diferencat tek të dyja dimensionet.

Për vitin 2022, transfertat në buxhetin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore janë:

- **Transferta e pakushtëzuar** e cila përbëhet nga:

a) **Pjesa e përgjithshme** prej 18.7 miliardë lekësh që rezulton nga zbatimi i pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili përcakton se madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 është jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto dhe jo më pak se ajo e vitit 2021; dhe

b) **Pjesa sektoriale** prej 8,75 miliardë lekësh nga shtesa që rezulton si pasojë e zbatimit të pikës 3, të nenit 95, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, për përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transfertat specifike të funksioneve të decentralizuara nga ky ligj, dhe zbatimi i pikës 4, të nenit 23 të ligjit 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, që rregullon konvertimin e transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transfertë të pakushtëzuar sektoriale.

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2022, që rezulton nga përcaktimi ligjor i madhësisë minimale prej 1% të PBB-së ose prej 18.7 miliardë lekësh, do të shtohen edhe fondet prej rreth 8,75 miliardë lekësh, për financimin e funksioneve të reja të cilat për periudhën 2016–2018, janë financuar nëpërmjet transfertave specifike. Nga 1 janari i vitit 2019, transfertat specifike u kthyen në transfertë të pakushtëzuar sektoriale, e cila përdoret në autonomi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total, për vitin 2022,

transferta e pakushtëzuar do të jetë 27.45 miliardë lekë.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në nenin 24 të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive, duke u bazuar te popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe te numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

2. Shuma totale e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022

Në zbatim të pikave 2 dhe 4 të nenit 23 të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe pikës 3 të nenit 95 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, **madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 është 27,45 miliardë**, dhe përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe pjesa sektoriale që mbulon funksionet e decentralizuara në vitin 2016.

Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet sipas parashikimit të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe fondeve të ndara sipas çdo bashkie për funksionet e transferuara (decentralizuara) në vitin 2016.



	TOTALI I TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR (PJESA I + PJESA II)	27,450,000,000
I	Pjesa e përgjithshme – Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore	18,700,000,000
1	Produkti i Brendshëm Bruto i parashikuar për vitin 2021	1,867,351,862,797
2	Transferta e pakushtëzuar për vitin 2022, në % ndaj PBB-së të parashikuar	1%
3	Transferta e pakushtëzuar për vitin 2022, në lek	18,700,000,000
4	Transferta e pakushtëzuar për tu shpërndarë sipas formulës në vitin 2022, pas zbritjes së fondeve si më poshtë:	17,151,942,973
5	<i>Fondi rezervë</i>	<i>100,000,000</i>
6	<i>Fondet për konviktet dhe qendrat e shërbimeve sociale</i>	<i>594,854,359</i>
7	<i>Fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarqet të bashkitë</i>	<i>526,202,668</i>
8	<i>Mbështetje për reformën në financat e arsimit parashkollor</i>	<i>327,000,000</i>
II	Pjesa sektoriale – Funkcionet e Decentralizuara me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”	8,750,000,000
1	<i>Fondet për personelin mësimor në kopshte në arsimin parashkollor</i>	<i>4,205,238,000</i>
2	<i>Fondet për personelin mbështetës në kopshte dhe arsimin parashkollor</i>	<i>1,135,242,000</i>
3	<i>Fondet për personelin mbështetës në arsimin parauniversitar</i>	<i>520,822,000</i>
4	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e mbrojtjes nga zjarri</i>	<i>1,378,149,000</i>
5	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e administrimit të pyjeve</i>	<i>409,597,000</i>
6	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e ujëvës dhe kullimit</i>	<i>966,310,000</i>
7	<i>Fondet për qendrat e shërbimeve sociale</i>	<i>64,262,000</i>
8	<i>Fondet për rrugët rurale</i>	<i>38,380,000</i>
9	<i>Fondet për klubet shumë sportësbe “Partizani dhe Studenti”</i>	<i>32,000,000</i>
II	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për t’u shpërndarë me formulë në vitin 2022 (I.4+I.8+II.1)	21,684,180,973

Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (IP) për vitin 2022 është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të parashikuar për vitin 2022, ose 18,700,000,000 lekë, 3% ose 488.9 milionë lekë më shumë se në vitin 2021. Gjithsej transferta e pakushtëzuar së bashku me specifiken që shpërndahet nëpërmjet formulës është 21,684,180,973 lekë, pas zbritjes së fondeve për konviktet, shërbimet sociale, për rrugët rurale. Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe për disa kritere të tjera, përfshiheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive. Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën, këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë. Duke filluar nga viti 2016, këto fonde paraqiten vetëm të bashkitë përfutuese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse paraqitur në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022. Në totalin e transfertës së pakushtëzuar përfshihen edhe fondet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, që nga 2016 kanë kaluar nga këshillat e qarqeve të bashkitë. Gjithashtu, fondet për këtë funksion nuk ndahen sipas formulës së transfertës së pakushtëzuar dhe paraqiten të veçanta për bashkitë përfutuese në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

Në vitin 2022, në zbatim të nenit 28 dhe 37 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 23, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, vazhdon reforma e sistemit të financimit të arsimit parashkollor, duke e harmonizuar sistemin me praktikën më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve. Kjo reformë pritet të sjellë një përmirësim të rëndësishëm në cilësinë e arsimit parashkollor në vendin tonë duke sjellë rritjen e numrit të edukatoreve. Kostoja e reformës është 327 milionë lekë dhe do të vazhdojë të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2022.

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kritereve specifike të përcaktuara në aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.



Buxheti i vitit 2022, konfirmon vazhdimin e reformës në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, dhe në buxhetin e vitit 2022, fondet për arsimin parashkollor ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3–6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve, sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në 2018. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Kjo reformë siguron një ndarje më të mirë të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t'u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të kriterit të skemës së mëparshme. Reforma është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe praktikën e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Ndryshimi i sistemit të ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor në vendin tonë përbën një domosdoshmëri, pasi sistemi aktual nuk reflekton në mënyrë të saktë ndryshimet sociale, demografike dhe infrastrukturore, që kanë ndodhur përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit. Kjo domosdoshmëri njihet edhe nga legjislacioni aktual për arsimin parauniversitar në Shqipëri, i cili sugjeron një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve.

Kjo reformë siguron:

- Uljen e madhësisë mesatare të grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti mesatar 18 fëmijë për një edukatore (para reformës) në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 25 fëmijë për një edukatore (para reformës) në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për

përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3–6 vjeç që ndjekin kopshtet publike. Shtimi i numrit të edukatoreve nënkupton edhe shtimin e kapaciteteve të shërbimit, duke ulur kështu nevojën për dërgimin e fëmijëve në kopshte private.

- Ruajtjen e fondeve aktuale për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht “të lartë” edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.

- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive për sa i përket raportit fëmijë për edukatore.

- Shtim fondi për stafin mbështetës të arsimit parashkollor.

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve ndërmjet bashkive, zbut diferencat ndërmjet bashkive për sa i përket raportit “fëmijë për edukatore” dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.

Në buxhetin e vitit 2022, do të ndahen me formulën e rishikuar të transfertës së pakushtëzuar 21,684,180,973 lekë, e cila përfshin edhe 4,205,238,000 lekë për personelin mësimor në arsimin parashkollor. Fondet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, paraqiten në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

3. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të qeverisjes vendore

Për vitin 2022, për financimin e funksioneve të veta bashkitë marrin 97.5% të totalit të transfertës së pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) së parashikuar për t'u ndarë me formulë, ose 21,684,180,973 lekë. Funksionet e reja të transferuara te bashkitë në vitin 2016, financohen nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara sektoriale me kolona të veçanta në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022. Fondet për arsimin parashkollor në këtë buxhet janë shpërndarë, sipas një formule e cila mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve me moshë 3–6 vjeç.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të qeverisjes	Në përqindje	Vlera në lekë
Transferta e pakushtëzuar për bashkitë	97.4%	21,124,180,973
Transferta e pakushtëzuar për qarqet	2.6%	560,000,000

Për vitin 2022, qarqet marrin **2.5%** të transfertës së pakushtëzuar ose **560 milionë lekë**. Në vijim të transferimit të funksionit të rrugëve rurale nga qarqet tek bashkitë, fondet e shpenzuara nga qarqet për këtë funksion u transferohen bashkive sipas tabelës nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

4. Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë	30%
Banorë rezidentë efektivë = $[\text{CENSUS} + (\text{Regjistri i gjendjes civile} - \text{Census}) * 30\%]$	3,325,359

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censurit të vitit 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censurit dhe të Gjendjes Civile (të vitit 2021) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Censurit të vitit 2011 ka 30,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezultojnë të ketë 45,000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë $30,000 + [(45,000 - 30,000) * 30\%] = 34,500$ banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezultojnë rreth 3.3 milionë banorë, nga 2.8 milionë që raportohet nga Censusi dhe 4.5 milionë që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censurit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë

Për vitin 2022, transferta e pakushtëzuar, e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 21,124,180,973 lekë dhe do të ndahet sipas kriterëve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 61.53% e transfertës për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censurit, duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censurit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 3,992 lekësh, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë	21,124,180,973
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	62.84%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	13,273,554,378
Transferta e pakushtëzuar për frymë	3,992

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu, koeficienti “dendësi e ulët e popullsisë” çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulë 11.78 % e totalit të fondit për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.



Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							11.78%
Madhësia e transfertës së pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							2,488,791,446
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							117 banorë/km ²
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë							2,183 lekë/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët e rregullimit	Numri i NJVV-ve përfituese	Dendësia e popullsisë korresponduese	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrigjuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup	
Kufiri 1	22%	2.270	10	25.2	114,559	260,049	567,581,431
Kufiri 2	43%	1.669	13	50.4	278,733	465,205	1,015,354,974
Kufiri 3	75%	0.900	10	87.9	347,181	312,463	681,981,072
Kufiri 4	110%	0.350	6	128.9	286,497	100,274	218,857,512
Kufiri 5	>110%	0.001	22	>130.1	2,298,390	2,298	5,016,457
Totali			61		3,325,359	1,140,289	2,488,791,446

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 5 grupime të njësisë të vetëqeverisjes vendore, sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi, të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë të gjitha bashkitë, në të cilat banojnë 3,325,359 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km², atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.270. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.669. Pra, duke iu afruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **2,183 lekësh** për banorë (që rezultojnë nga pjesëtimi i shumës prej **2,448,791,446 lekësh** me popullsinë totale që rezultojnë nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Kriteri i tretë mbi të cilin ndahet transfertat e pakushtëzuar për bashkitë është numri i fëmijëve në arsimin parashkollor i kombinuar me numrin e personelit mësimor në arsimin parashkollor, dhe numri i nxënësve në shkollat publike nëntëvjeçare dhe të mesme. Nga viti 2019, dhe në vazhdim formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përditësohet për të akomoduar përfshirjen dhe ndarjen e fondeve për pagat e personelit mësimor në sistemin arsimor parashkollor. Në këtë kuadër, komponenti i arsimit i formulës së transfertës së pakushtëzuar do të ndajë gjithsej 25.38% e totalit të transfertës për t'u ndarë me formulë, ose 5,247,835,149 lekë. Nga kjo shumë, 4,419,238,000 lekë janë të dedikuara për pagat e personelit mësimor në arsimin parashkollor. Fondet ndahen 60% mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Në krahasim me vitin 2018 (si vit i fundit i skemës së vjetër), fondet për pagat e personelit mësimor të arsimit parashkollor janë 810 milionë lekë ose 18.8% më të larta.

Ndërkohë, pjesa prej 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ose 829,597,149 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 1,917 lekësh për çdo nxënës në territorin e tyre.

Komponenti III: Ndarja sipas numrit të fëmijëve dhe të nxënësve (në %)	25.38%
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve, në lek	5,361,835,149
Vlera për personelin mësimor në arsimin parashkollor, në lek	4,532,238,000
Sipas numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme	829,597,149



6. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qendrore dhe asaj vendore, të cilat mbliidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, të cilat mbliidhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit, duke evituar kështu çdo lloj disincentivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2020, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësive të vetëqeverisjes vendore është 2,696,642,002 lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 811 lekë për banor, sipas konceptit “banor rezident efektiv”.

Komponenti IV: Sistemi i ekualizimit të të ardhurave						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (TAP + taksa e automjeteve + taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						2,696,642,002
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						811
Nëse NJVV-të kanë TAPF nën	80%	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	100%	të diferencës	Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	306,321,168
duke u marrë NJVV-ve me të ardhura për frymë mbi	120%	të mesatares kombëtare (TAKPF)	60%	të difirencës	Fondet që efektivisht shkurtohen	300,378,891
Koeficienti i rishpërndarjes						0.98

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 80% të mesatares kombëtare (TAKPF) prej 811 lekësh/frymë, do të kompensohen me 100% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do të duhej t'u shtoheshin njësive me të ardhura më të ulëta për t'i sjellë ato në nivelin prej 649 lekësh/frymë (ku $811 \times 80\% = 649$ lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulëta” në nivelin prej 80% të mesatares kombëtare, njësive me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 973 lekë/frymë) do t'u merret 60% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për frymë prej 1200 lekësh/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do t'i zbriten 136 lekë/frymë [$1200 - (120\% \times 811) \times 60\% = 136$ lekë/banor. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme, të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ulëta. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes, i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2022, fondet e nevojshme për ekualizim janë 306,321,168 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga “taksimi” prej 60% të të ardhurave mbi 937 lekë/frymë i njësive me të ardhura më të larta janë 300,378,891 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 0.98.

7. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet

Qarqeve do t'u ndahen 560 milionë lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 112 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 9.3 milionë lekësh për secilin nga 12 qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	560,000,000
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	20%
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	112,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	9,333,333



Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 280 milionë lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)		50%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë		280,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (banorë rezidentë efektivë)		84

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 168 milionë lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							30%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							168,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							117 banorë/km ²
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							213 lekë/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët	Numri i Qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup	
Kufiri 1	90%	0,3	4	105.5	909,635	58,017,864	34%
Kufiri 2	65%	0,5	3	76.2	660,389	70,200,924	42%
Kufiri 3	35%	1,0	2	41.0	187,113	39,781,212	24%
Totali			9		1,757,138	168,000,000	

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tri grupet. Qarqet janë ndarë në tri grupe të ndryshme, sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 117 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 213 lekësh për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 19,856,925 lekësh (i llogaritur në këtë mënyrë: 93,225*1*213).

ANEKS 2

KRITERET E SHPËRNDARJES SË FONDIT REZERVË

Nivelet e pushtetit vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	- Kompensim për ndonjë gabim në përlogaritjen e kriterëve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022. - Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë që nga viti 2016. - Për shpenzime të shërbimeve të shkaktuara nga COVID-19. - Për nevojat të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 50 përqind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Pjesa e papërdorur e fondit rezervë në vitin buxhetor 2022, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2023.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2022.



ANEKSI 3

PROGRAMI BUXHETOR PËR
INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE
RAJONALE NË FONDIN SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve, si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimi e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njërive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

4. Nga fondi për infrastrukturën vendore dhe rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.

ANEKS 4

PËR FUNKSIONET E TRANSFERUARA NË
NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**1. Konviktet e arsimit parauniversitar**

Në transfertën e vitit 2022, disa bashkive u janë akorduar fondet për konvikte të arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qendrat e shërbimeve sociale

Në transfertën e vitit 2022 të bashkive: Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, “Opera Della Madonnina Della Grappa”, Shkodër, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2022 të bashkive, është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t’u dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të



tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore u janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për shërbimin pyjor. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe kullimi

Në transfertën e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe, “Partizani” dhe “Studenti”

Në transfertën e vitit 2022, Bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.

ANEKS 5

PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME

Për kontraktimin e punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2022, ndiqen këto rregulla:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme miratohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet propozimit të ministrit përgjegjës për Financat.

2. Institucioni duhet të ketë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të personelit të kontraktuar.

3. Veprimtaria që kryejnë punonjësit me kontratë është kryesisht veprimtari e njësive strukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit dhe në asnjë rast veprimtari e njësive strukturore politikëbërëse, inspektuese apo audituese.

4. Kontraktimi i punonjësve bëhet në përputhje me kriteret e parashikuara për atë pozicion pune, për një periudhë kohore deri në 6 muaj gjatë një viti buxhetor me kohë pune ditore të plotë, ose deri në 6 orë në ditë përgjatë vitit buxhetor. Përfashtim nga ky përcaktim, bën kontraktimi i punonjësve që kryejnë një veprimtari që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.

5. Paga e punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet në referencë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet.

Për pozicionin “Specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin e kategorisë IV-a dhe në institucionet në varësi të tyre, nivelin e kategorisë IV-b. Në rast se



pozicioni “specialist” ka shtesa specifike mbi pagën e kategorisë përkatëse, ato nuk përfitohen nga punonjësi me kontratë të përkohshme.

6. Pagesa bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave për punonjësit organik dhe përfshihet në shpenzimet e personelit të institucionit. Përjashtim nga ky rregull, bëjnë anketuesit/kontrollorët e terrenit të kontraktuar në realizimin e Censurit dhe anketimeve afatshkurta (më pak se dy javë), pagesa e të cilëve e bazuar në ditët e punës, do të përfshihet në shpenzimet operative të institucionit.

7. Në raste specifike që lidhen me mësimdhënien, veprimtarinë bujqësore, veprimtarinë statistikore, rregullat dhe procedurat e marrjes në punë të punonjësve me kontratë përcaktohen nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të miratuar mes institucionit qendror përgjegjës dhe ministrisë përgjegjëse për Financat.

ANEKSI 6 FONDI PËR MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE NATYRORE

1. Fondi për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore.

2. Për vitin 2022, Fondi për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** përbëhet nga fondi i akorduar në buxhetin e vitit 2022 në programin “Emergjencia Civile”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

3. Shpërndarja e Fondit për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**, sipas projekteve kryhet nga Komiteti për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**, i cili kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Zëvendëskryeministri	kryetar;
2. Ministri i Mbrojtjes	zëvendëskryetar;
3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4. Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
5. Ministri i Brendshëm	anëtar;
6. Zëvendësmministri i Mbrojtjes	anëtar;
7. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
8. Ministria e Infrastrukturë dhe Energjisë	anëtar;
9. Drejtori i AKMC	anëtar;
10. Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
11. Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
12. Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** miraton:

a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e fondit;

5. Fondi i **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të **Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore**, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Thirrjet për aplikim në Fondin e **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.

7. Fondi i **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

8. Sekretariati teknik për Fondin e **Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore** ngrihet pranë Ministrinë së Mbrojtjes. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një njësi pranë AKMC-së.

9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**.

10. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Komitetit të Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore.

ANEKSI 7 PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

1. Fondet shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane akordohen si transfertë e pakushtëzuar sektoriale sipas tabelës nr. 3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2022”. Këto fonde janë një mekanizëm financiar shtesë që mbështet bashkitë për mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane.



2. Detajimi i këtyre fondeve në tabelën nr. 3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2022”, sipas bashkive është bërë duke marrë parasysh: a) sasinë e mbetjeve vjetore dhe b) kostot shtesë për transportin e tyre në pikat fundore të grumbullimit dhe përpunimit.

3. Detajimi i fondeve është bërë për bashkitë:

a) Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz, Lezhë dhe Kurbin për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Shkodër.

b) Krujë, Durrës, Vorë, Kamzë, Shijak, dhe Kavajë për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Tiranë.

c) Librazhd, Elbasan, Rrogozhinë, Peqin, Cërrik, Belsh, Përrenjas dhe Gramsh, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Elbasan.

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit u dërgon bashkive kuadrin ligjor, nënligjor, standardet dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me menaxhimin e mbetjeve urbane. Njësitë e vetëqeverisjes vendore shtojnë fonde nga të

ardhurat e tyre për transportimin e mbetjeve urbane në zonat e menaxhimit të mbetjeve.

5. Gjatë vitit 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqatat/përfaqësuesit e bashkive përgatit një metodologji për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe vendos tregues performance për bashkitë në funksion të rritjes së cilësisë së mirëmenaxhimit të mbetjeve urbane.

6. Kjo mbështetje buxhetore e cila synon mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane duhet të bëhet pjesë e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe në vijim e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Kjo mbështetje duhet të bëhet pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të bashkive.

7. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë monitoron periodikisht përdorimin e fondit shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane sipas bashkive përfituese.

BUXHETI 2022
SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Tab. 1

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financim i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	Presidenca	242,920	16,000	0	16,000	258,920
01120	Veprimtaria e Presidentit	242,920	16,000	0	16,000	258,920
2	Kuvendi	1,148,566	283,000	0	283,000	1,431,566
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	432,640	283,000	0	283,000	715,640
01120	Veprimtaria ligjvënëse	715,926	0	0	0	715,926
3	Kryeministria	378,000	50,000	0	50,000	428,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	378,000	50,000	0	50,000	428,000
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	6,807,274	2,765,844	3,163,251	5,929,095	12,736,369
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	317,600	15,000	0	15,000	332,600
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,590,674	302,509	388,014	690,523	2,281,197
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	667,600	1,013,491	0	1,013,491	1,681,091
04250	Zhvillimi rural duke mbësht. prodh. bujq., blek., agroind. dhe market.	3,619,600	1,051,844	2,413,755	3,465,599	7,085,199
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	458,000	176,000	0	176,000	634,000
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	20,000	0	0	0	20,000
04230	Mbështetje për peshkimin	133,800	207,000	361,482	568,482	702,282
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	5,153,656	25,374,314	16,943,755	42,318,069	47,471,725
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	510,224	13,000	0	13,000	523,224
04520	Transporti rrugor	2,819,136	16,171,887	5,030,132	21,202,019	24,021,155
04540	Transporti detar	109,400	80,000	10,000	90,000	199,400
04550	Transporti hekurudhor	414,000	400,000	1,958,349	2,358,349	2,772,349
04560	Transporti ajror	21,112	71,200	0	71,200	92,312
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	4,000	20,000	24,000	24,000
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	454,400	7,118,185	6,669,274	13,787,459	14,241,859
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	200,000	1,067,042	476,000	1,543,042	1,743,042
04320	Mbështetje për energjinë	55,495	200,000	2,780,000	2,980,000	3,035,495
04430	Mbështetje për burimet natyrore	224,385	91,000	0	91,000	315,385
04440	Mbështetje për industrinë	277,160	64,000	0	64,000	341,160
06180	Planifikimi urban	68,343	94,000	0	94,000	162,343
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	62,389,730	2,145,329	938,000	3,083,329	65,473,059
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	551,040	233,000	350,000	583,000	1,134,040
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	374,120	0	0	0	374,120
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	600,000	400,000	0	400,000	1,000,000



Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i Shp. kapitale	
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,550,000	342,640	0	342,640	2,892,640
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,532,100	153,220	120,690	273,910	3,806,010
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	78,400	2,000	0	2,000	80,400
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	772,400	78,000	150,000	228,000	1,000,400
04160	Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	306,520	22,000	0	22,000	328,520
10220	Sigurimi shoqëror	47,656,350	0	0	0	47,656,350
10550	Tregu i punës	2,349,600	81,000	0	81,000	2,430,600
04170	Inspektimi në punë	169,200	10,000	0	10,000	179,200
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	2,127,600	423,469	317,310	740,779	2,868,379
06190	Strehimi	1,322,400	400,000	0	400,000	1,722,400
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	41,207,347	3,931,000	320,000	4,251,000	45,458,347
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	736,320	85,000	0	85,000	821,320
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	23,649,517	1,208,000	0	1,208,000	24,857,517
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,701,600	1,112,000	0	1,112,000	7,813,600
09450	Arsimi universitar	9,600,000	1,006,000	200,000	1,206,000	10,806,000
09770	Fonde për shkencën	396,240	250,000	100,000	350,000	746,240
08140	Zhvillimi i sportit dhe rinisë	123,670	270,000	20,000	290,000	413,670
12	Ministria e Kulturës	1,889,760	2,262,500	160,000	2,422,500	4,312,260
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	172,400	0	0	0	172,400
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	630,840	20,000	65,000	85,000	715,840
08230	Arti dhe kultura	1,086,520	2,242,500	95,000	2,337,500	3,424,020
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	74,322,938	1,342,944	1,410,000	2,752,944	77,075,882
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	377,200	3,000	0	3,000	380,200
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	8,500,073	147,052	158,000	305,052	8,805,125
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	31,030,916	1,159,212	1,152,000	2,311,212	33,342,128
07450	Shërbimet e shëndetit publik	6,346,466	13,680	0	13,680	6,360,146
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	334,162	0	0	0	334,162
10430	Përkujdesja sociale	26,698,130	20,000	100,000	120,000	26,818,130
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	1,035,991	0	0	0	1,035,991
14	Ministria e Drejtësisë	10,593,432	576,700	110,000	686,700	11,280,132
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	454,940	125,600	110,000	235,600	690,540
03310	Ndihma juridike	82,000	2,000	0	2,000	84,000
01120	Publikimet zyrtare	57,500	2,000	0	2,000	59,500
01130	Mjekësia ligjore	88,000	5,000	0	5,000	93,000
03440	Sistemi i burgjeve	5,839,000	430,900	0	430,900	6,269,900
03350	Shërbimi i përmbarimit gjyqësor	152,560	3,000	0	3,000	155,560
01160	Shërbimet për gëshjet e biresimeve	15,600	200	0	200	15,800
01180	Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave	3,749,000	6,000	0	6,000	3,755,000
03490	Shërbimi i proves	154,832	2,000	0	2,000	156,832
15	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	2,948,363	91,000	80,780	171,780	3,120,143
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	268,756	55,000	0	55,000	323,756
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,391,927	15,000	0	15,000	2,406,927
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	204,440	0	0	0	204,440
01150	Mbështetja institucionale për procesin e integritetit	83,240	21,000	80,780	101,780	185,020
16	Ministria e Brendshme	19,841,110	1,000,000	350,290	1,350,290	21,191,400
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,232,980	106,250	0	106,250	1,339,230
03140	Policia e Shtetit	15,819,570	742,750	335,290	1,078,040	16,897,610
03150	Garda e Republikës	1,782,800	29,000	0	29,000	1,811,800
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	510,000	62,000	15,000	77,000	587,000
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	495,760	60,000	0	60,000	555,760
17	Ministria e Mbrojtjes	22,393,305	8,339,500	1,900,000	10,239,500	32,632,805
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,332,503	320,000	0	320,000	1,652,503
02120	Forcat e luftimit	6,006,535	4,136,500	1,200,000	5,336,500	11,343,035
09430	Arsimi ushtarak	738,380	500,000	0	500,000	1,238,380
02150	Mbështetja e luftimit	6,828,811	1,113,000	0	1,113,000	7,941,811
07340	Mbështetje për shëndetësinë	935,076	200,000	0	200,000	1,135,076
10270	Mbështetje sociale për ushtarakët	5,200,000	0	0	0	5,200,000
10910	Emergjencat civile	1,352,000	2,070,000	700,000	2,770,000	4,122,000
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,823,200	50,000	0	50,000	1,873,200
03520	Veprimtaria informative shtetërore	1,823,200	50,000	0	50,000	1,873,200
19	Drejtorja e Radio-Televizionit	567,600	0	0	0	567,600
08310	Shërbimet për shpërtaret jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	197,600	0	0	0	197,600
08330	Prodhimet filmike ose veprimtari artistike mbarekombëtare	67,600	0	0	0	67,600
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe Kinematografisë	62,400	0	0	0	62,400
20	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	190,400	65,000	0	65,000	255,400
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	190,400	65,000	0	65,000	255,400
22	Akademia e Shkencës	151,800	1,000	0	1,000	152,800



Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i Shp. kapitale	
01520	Veprimtaria akademike	151,800	1,000	0	1,000	152,800
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	464,960	20,000	24,000	44,000	508,960
01120	Veprimtaria audituese e KLSH-së	464,960	20,000	24,000	44,000	508,960
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,368,720	580,740	490,000	1,070,740	2,439,460
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	194,040	3,000	0	3,000	197,040
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	441,320	120,000	390,000	510,000	951,320
04260	Administrimi i pyjeve	339,200	78,500	0	78,500	417,700
04760	Zhvillimi i turizmit	394,160	379,240	100,000	479,240	873,400
28	Prokuroria e Përgjithshme	2,294,270	130,000	0	130,000	2,424,270
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	2,294,270	130,000	0	130,000	2,424,270
29	Këshilli i Lartë i Gjyqësor	3,347,808	412,000	0	412,000	3,759,808
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	281,208	15,000	0	15,000	296,208
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	8,840	0	0	0	8,840
03310	Buxheti gjyqësor	3,057,760	397,000	0	397,000	3,454,760
30	Gjykata Kushtetuese	152,760	19,000	0	19,000	171,760
03320	Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	152,760	19,000	0	19,000	171,760
31	Ajencia Telegrafike Shqiptare	58,200	1,000	0	1,000	59,200
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-së	58,200	1,000	0	1,000	59,200
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	150,800	8,000	0	8,000	158,800
01110	Veprimtaria e KLP-së	150,800	8,000	0	8,000	158,800
40	Partitë politike	356,208	0	0	0	356,208
01110	Mbështetje për partitë politike	345,600	0	0	0	345,600
01120	Mbështetje për shoqatat	8,320	0	0	0	8,320
01130	Mbështetje për organizatat e veteranëve me status	2,288	0	0	0	2,288
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	1,008,800	30,000	0	30,000	1,038,800
03390	Veprimtaria e SPAK-ut	1,008,800	30,000	0	30,000	1,038,800
50	Instituti Statistikës	1,268,400	300,000	400,000	700,000	1,968,400
01320	Veprimtaria statistikore	1,268,400	300,000	400,000	700,000	1,968,400
55	Shkolla e Magjistraturës	297,600	8,000	0	8,000	305,600
09820	Veprimtaria arsimore	297,600	8,000	0	8,000	305,600
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	10,500,000	7,851,924	18,351,924	18,351,924
06210	Programe zhvillimi	0	6,500,000	7,851,924	14,351,924	14,351,924
06220	Infrastruktura vendore dhe rajonale	0	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	500,000	0	500,000	500,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	157,440	1,000	0	1,000	158,440
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	157,440	1,000	0	1,000	158,440
63	Institucionet e sistemit të drejtësisë	712,656	70,000	0	70,000	782,656
03320	Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	202,800	64,000	0	64,000	266,800
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magistratit	236,968	2,000	0	2,000	238,968
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	199,360	2,000	0	2,000	201,360
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	73,528	2,000	0	2,000	75,528
66	Avokati i Popullit	125,200	4,000	0	4,000	129,200
03320	Shërbimi i avokatit	125,200	4,000	0	4,000	129,200
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	61,152	1,000	0	1,000	62,152
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	61,152	1,000	0	1,000	62,152
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	193,440	81,500	0	81,500	274,940
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	193,440	81,500	0	81,500	274,940
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	162,944	33,000	0	33,000	195,944
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	162,944	33,000	0	33,000	195,944
77	Autoriteti i Konkurrencës	71,600	1,000	0	1,000	72,600
04120	Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës	71,600	1,000	0	1,000	72,600
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	13,208	1,000	0	1,000	14,208
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	13,208	1,000	0	1,000	14,208
87	Institucione të tjera qeveritare	6,466,298	2,221,629	293,000	2,514,629	8,980,927
01320	Shërbime qeveritare	250,000	30,000	0	30,000	280,000
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	62,192	1,000	0	1,000	63,192
05640	Administrimi i ujërave	96,800	10,000	93,000	103,000	199,800
03310	Shërbimi i Avokatit të Shtetërore	219,136	2,000	0	2,000	221,136
01150	Shërbime të tjera	745,112	140,253	0	140,253	885,365
01140	e-Qeverisja	4,477,128	1,881,376	0	1,881,376	6,358,504
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	369,800	106,000	150,000	256,000	625,800
08610	Mbështetje për rininë dhe fëmijët	111,370	50,000	50,000	100,000	211,370
08480	Mbështetje për kultet fetare	134,760	1,000	0	1,000	135,760
88	Mbështetje për Shoqërinë Civile	122,781	1,000	0	1,000	123,781
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	122,781	1,000	0	1,000	123,781
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	71,840	6,500	0	6,500	78,340
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	71,840	6,500	0	6,500	78,340



Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i Shp. kapitale	
90	Komisioni i Prokurimit Publik	70,960	25,000	0	25,000	95,960
Në mbështetje të neneve, 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Komisionit Evropian për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut–Shqipëri, 2014–2020, alokimet për vitin 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.11.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13374, datë 13.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si **“Komisioni”** ose **“pala”**, e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si **“Bashkimi”**,

nga njëra anë dhe

Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, në vijim të referuar bashkërisht si **“Përfituesit e IPA II”** ose individualisht si **“përfituesja e IPA II”** ose **“pala”**,

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si **“Palët”**,

ndërsa,

çdo referim i përfshirë në këtë marrëveshje dhe anekset e tij në **“ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”** duhet të lexohet **“Republika e Maqedonisë së Veriut”**

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1

Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin e livrimit për vitin 2020 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në shtojcën I:

“Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë për vitet 2018–2020”²,

Numri global i angazhimit (CRIS): 2020/041-372

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)³.

2. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e livrimit për vitin 2020 të këtij Program Veprimi është 1 800 000 euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është caktuar në 1 530 000 euro.

² C(2018)8152 i datës 29.11.2018.

³ Rregullorja nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, që krijon një Instrument për Ndhimën e Paraanëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.3.2014, f. 11.



Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e IPA II.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1(1) të shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Siç përcaktohet në nenin 1(2) të shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3

Adresat dhe komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar dhe do t'i referohet shprehimisht Programit të Veprimit, siç identifikohet në nenin 1(1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin

Znj. Genoveva Ruiz Calavera

Drejtoria D, Ballkani Perëndimor

Komisioni Evropian

Drejtoria e Përgjithshme e Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit

Rue de la Loi 15, B – 1049

Brussels, Belgium (Bruksel, Belgjikë)

E-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA II

Për Republikën e Maqedonisë së Veriut:

Sekretariati për Çështjet Evropiane

Quai Dimitar Vlahov, nr. 4

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Tel: +389 (0)2 3200 105, Faks: +389(0)2 3114 569

E-mail: cabinet@sep.gov.mk

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial

Bulevardi “Gjergj Fishta”, nr. 6

Tiranë, Republika e Shqipërisë

E-mail: info@mfa.gov.al

Neni 4

Pikat e kontaktit të Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF)

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II, që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të OLAF-it, do të jenë:

- Z. Fatmir Ademi, shefi i Departamentit për Inspektimin Financiar të Sektorit Publik dhe Koordinimin për Luftimin e Mashtrimit kundër Fondeve të BE-së

Quai Dimitar Vlahov, nr. 4, kati 4, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

E-mail: fatmir.ademi@finance.gov.mk

dhe

- Z. Blerina Naska, drejtore e Njesisë së Inspektimit Financiar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Republika e Shqipërisë

E-mail: Blerina.Naska@financa.gov.al

Neni 5

Marrëveshjet kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e “Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë” nën Instrumentin e Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 24 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e “Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit në Shqipëri” nën Instrumentin e Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), që ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015 (referuar në vijim si “Marrëveshja/et kuadër”).

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e marrëveshjeve kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, e dispozitave të kësaj marrëveshjeje financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, kjo e fundit do të ketë përparësi.



Neni 6 Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
 - a) këto kushte të veçanta;
 - b) Shtojca I: “Programi i Veprimit të BNK-së, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë, për vitet 2018–2020”;
 - c) Shtojca IA: “IPA II BNK 2014–2020, Programi ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë”;
 - d) Shtojca II: “Kushtet e përgjithshme”;
 - e) Shtojca III: Raporti Vjetor i BNK tip për zbatimin e ndihmës IPA II, në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;
 - f) Shtojca IIIA: Raporti Vjetor tip për zbatimin e ndihmës IPA II, në përputhje me nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër.
2. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të shtojcave dhe nga ana tjetër, të dispozitave të këtyre kushteve të veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të shtojcës I dhe shtojcës IA dhe dispozitave të shtojcës II, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcës I, nga njëra anë dhe dispozitave të shtojcës IA nga ana tjetër, të parat do të kenë përparësi.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi në datën kur Komisioni merr një njoftim nga përfituesi i fundit IPA II (Republika e Shqipërisë), duke konfirmuar përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA II, të nevojshme për këtë hyrje në fuqi. Komisioni informon përfituesit e IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Kjo Marrëveshje e Financimit nuk do të hyjë në fuqi nëse një njoftim i tillë nuk është marrë nga Komisioni deri më 31 dhjetor 2021.

Kjo marrëveshje është hartuar në tri kopje në gjuhën angleze, një i dorëzohet Komisionit dhe një secilit prej përfituesve të IPA II.

Për përfituesit e IPA II: Për Republikën e Maqedonisë së Veriut

Koordinatori Kombëtar i IPA-së

Shkup
Datë: 9.12.2020

Për Republikën e Shqipërisë

Koordinatori Kombëtar i IPA-së

Tiranë
Datë

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtorja D, Ballkani Perëndimor
Drejtorja e Përgjithshme e Fqinjësisë dhe
Negociatave të Zgjerimit, Drejtorja D, Ballkani
Perëndimor, Komisioni Evropian

Bruksel

Datë: 22 qershor 2020



SHTOJCA 1
PROGRAMI I VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR NDËRMJET ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR VITET 2018–2020

1. Identifikimi

Përfutuesit	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë Republika e Shqipërisë
CRIS/ABAC, referencat e angazhimit	EURO 1,700,000 22.020401 2018/041-370
Kontributi i Bashkimit	EURO 1,700,000 22.020401 2019/041-371
Buxheti	EURO 1,530,000 22.020401 2020/041-372
Mënyra e menaxhimit	Menaxhim i drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian
Strukturat përgjegjëse	Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Ministria e Vetëqeverisjes Vendore Në Republikën e Shqipërisë: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Data përfundimtare për mbylljen e marrëveshjes/ve të financimit me vendet përfutuese (trepalëshe) të IPA II	Për angazhimin buxhetor të vitit 2018: Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2019 Për angazhimin buxhetor të vitit 2019: Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2020 Për angazhimin buxhetor të vitit 2020: Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2021
Data përfundimtare për mbylljen e kontratave të prokurimit dhe granteve	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit), me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114 (2) të Rregullores Financiare
Data përfundimtare për zbatimin operacional	6 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit).
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes Financiare (data nga e cila ky program duhet të tërhiqet nga detyrimi dhe të mbyllet), pas pranimit të llogarive	12 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit).
Njësia e Programimit	DG NEAR Njësia D3, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova
Njësia zbatuese/Delegacioni i BE-së	Delegacioni i Bashkimit Evropian për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

2. Përshkrim i Programit të Veprimit

2.1 Përmbledhje e programit të bashkëpunimit ndërkufitar 2014–2020 dhe programi i veprimit të BNK-së 2018–2020

Programi i BNK-së 2014–2020 i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë – Republika e Shqipërisë (vendimi zbatues i Komisionit C(2014) 9674, i datës 11 dhjetor 2014). Programi i miratuar 2014–2020 përbën strategjinë e bashkëpunimit ndërkufitar për rajonin kufitar, duke përcaktuar, ndër të tjera, listën e zonave gjeografike të pranueshme, kontekstin e zonës, prioritetet e programit dhe ndarjen e buxhetit për periudhën 7-vjeçare.

Programet BNK 2014–2020, shërbejnë, gjithashtu, si referencë për miratimin e programeve

të veprimit të BNK-së. Programi i veprimit 2018–2020 i BNK-së synon sigurimin e ndihmës për bashkëpunim ndërkufitar në fushat tematike të parashikuara në programin 2014–2020 (siç tregohet në seksionin 2.2).

Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi një Komunikim⁴, i cili synon të gjenerojë një vull të reformave të rinovuar në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojnë angazhim të zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme në BE për të mbështetur më mirë përgatitjet e tyre në rrugën evropiane. Komunikimi

⁴ Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi një Komunikim me temë “Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe angazhim i zgjeruar i BE-së me Ballkanin Perëndimor”.



përcakton orientimet e reja strategjike, veçanërisht në lidhje me zbatimin e 6 nismave kryesore. Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kryesor për nxitjen e rivendosjes së marrëdhënieve miqësore dhe trajtimi i trashëgimisë së kaluar në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me nismën e 6-të (mbështetja përmes paktimit dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë) dhe për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në përputhje me nismën e 3-të (mbështetje e zhvillimit socioekonomik).

Lista e zonave gjeografike të pranueshme

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë zona e pranueshme janë:

- Rajoni i Pelagonias: bashkitë e Bitolas, Demir Hisarit, Dolnenit, Krivogastanit, Krusevos, Mogilas, Novacit, Prilepit dhe Resenit;
- Rajoni i Pologut: bashkitë e Bogovinjes, Brvenicas, Gostivarit, Jegunovces, Mavrovës dhe Rostusas, Tearces, Tetovës, Vrapcistes dhe Zelinës;
- Rajoni Jugperëndimor: bashkitë e Centar Zupas, Debarit, Debarcas, Kicevos, Makedonski Brod, Ohrit, Plasnicas, Strugës dhe Vevcanit.

Në Republikën e Shqipërisë zonat e pranueshme janë:

- Rajoni i Dibrës: rrethet e Bulqizës, Burrelit dhe Dibrës;
- Rajoni e Elbasanit: rrethet e Cërrikut, Elbasanit, Gramshit, Librazhdit dhe Peqinit;
- Rajoni i Korçës: rrethet e Devollit, Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit.

Bashkëpunimi ndërkufitar (BNK), konteksti i zonave përfutuese

Në bazë të analizës së situatës së bërë për përgatitjen e Programit dolën në pah disa sfida dhe mundësi kryesore për t'u adresuar dhe mbështetur përmes bashkëpunimit ndërkufitar. Në veçanti, Programi parashikon adresimin e prioriteteve vijuese tematike, si:

1. Inkurajimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;
2. Rritjen e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutja, parandalimi dhe menaxhimi i riskut.

Prioriteti numër 1 bazohet në mundësitë e identifikuar strategjike, në lidhje me rëndësinë në

rritje të turizmit si një mundësi ekonomike, ndërkohë që nxitet shkëmbimi kulturor dhe, promovimi i trashëgimisë natyrore do të ruajë dialogun mes njerëzve dhe dialogun e shoqërisë civile me institucionet.

Prioriteti numër 2 nxitet nga nevoja dhe mundësitë dhe kërkon të zgjidhë nivelin e ulët të punësimit në zonën e Programit.

Prioriteti numër 3 synon t'u përgjigjet nevojave specifike të një prej sektorëve të politikave më të neglizhuara; të mjedisit dhe ndryshimit klimatik. Në kontekstin e BNK-së, kjo do të zgjidhë çështjen e nxitjes së ekonomisë së pastër dhe të gjelbër, përdorimin më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore, elasticitetin e klimës në infrastrukturën e një shkalle të vogël mbështetëse (kundër përmbytjeve dhe zjarreve) dhe erozionit të tokës në zonën kufitare malore.

Përmbledhje e përvojës së kaluar dhe asaj në vazhdim të BNK-së, përfshirë mësimet e nxjerra

Rekomandimet kryesore nga vlerësimet e ndërmjetme dhe auditimet e programeve të BNK-së 2007–2013 janë marrë parasysh në zhvillimin e këtij programi. Kështu që, programet e BNK-së 2014–2020 janë më të fokusuar për sa i përket numrit të prioriteteve dhe zonave gjeografike të përfshira, gjë që do të ndihmojë në arritjen e rezultateve më të mira dhe rritjen e ndikimit. Përveç kësaj, zbatimi i programeve të BNK-së është thjeshtuar kryesisht nëpërmjet pasjes së një autoriteti të vetëm kontraktues dhe një zarfi të vetëm financiar për program.

Mësimet kryesore të nxjerra u identifikuan, gjithashtu, nga vlerësimi përfundimtar i Programit CBC të Asistencës Paraanëtarësimit (IPA) CBC 2007–2013, që u realizua ndërmjet viteve 2016 dhe 2017. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet u diskutuan me palët e interesuara të CBC në Ballkanin Perëndimor, gjithashtu dhe masat për ndjekje që u identifikuan për një afat të shkurtër dhe të mesëm, si për programet në vazhdim CBC 2014–2020, ashtu edhe për programet e ardhshme 2021–2027 CBC. Rekomandimet kryesore në lidhje me të gjitha programet CBC në nivelin e Ballkanit Perëndimor përfshijnë:



- Qëllimi kryesor i promovimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë duhet të reflektohet qartë në projektet e BNK-së.

- Thirrjet për propozim duhet të përqendrohen më shumë në disa çështje prioritare që kanë përmbajtje të lartë ndërkufitare.

- Logjika e ndërhyrjes së programeve dhe sistemet e raportimit dhe monitorimit duhet të përmirësohen pasi ato nuk janë të strukturuar për të vendosur një bazë të qartë për matjen e rezultateve në nivelin rajonal.

- Ekziston nevoja për të vazhduar me aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për Strukturat Operuese dhe Sekretaritë Përbashkëta Teknike/Antenat.

- Ekziston nevoja për përmirësimin e sinergjive me politikat dhe donatorët e tjerë, kapitalizimin dhe shkëmbimin e përvojave me mjediset e tjera të BNK-së (p.sh., programet INTERREG dhe ENI CBC).

2.2 Përshkrimi dhe zbatimi i veprimeve

Veprimi 1	Operacionet e Bashkëpunimit Ndërkufitar	4,930,000 euro
-----------	---	----------------

Ndihma e parashikuar për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë konsiderohet se ndjek kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në bazë të nenit 215 TFEU⁵.

1. Përshkrimi i veprimit, objektivat, rezultatet e pritshme

Përshkrimi i veprimit: Operacionet e Bashkëpunimit Ndërkufitar në rajonin kufitar në fushën e mjedisit; përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut; turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore; konkurrencës; zhvillimit të biznesit dhe NVM-ve, tregtisë dhe investimeve.

Objektivat: Zhvillimi socioekonomik dhe forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë në zonën ndërkufitare përmes implementimit të operacioneve të bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim:

a) mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut, ndër të tjera, përmes: veprimeve të përbashkëta për

mbrojtjen e mjedisit; nxitjes së përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, eficiencës së burimeve, burimeve të energjisë së rinovueshme dhe ndryshimin drejt një ekonomie të sigurt dhe të qëndrueshme me shkallë ndotjeje sa më të ulët; promovimit të investimeve për shmangien e rreziqeve specifike, duke siguruar elasticitet në raste katastrofash dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive, si dhe gatishmërinë në rastet emergjente;

b) inkurajimin e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

c) rritjen e konkurrencës; rritjen e mjedisit të biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; rritjen e tregtisë dhe investimeve, ndër të tjera, përmes, promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes, në veçanti, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; zhvillimin e tregjeve ndërkufitare dhe ndërkombëtarizimin;

Rezultatet e pritshme:

a) nxitja e ndërgjegjësimit dhe e njohurive mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të mjedisit;

b) nxit bashkëpunimin, kuptimin dhe respektimin e ndërsjellë të vlerave dhe të trashëgimisë kulturore;

c) rritjen e mundësive të biznesit dhe ofruesve të shërbimeve dhe operatorët lokalë në fushën e turizmit;

d) rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapacitetit të NVM-ve dhe e sipërmarrjeve fillestare për të hyrë në tregje të reja dhe rritja e gamës së vlerave.

Objektivat dhe rezultatet e pritshme do të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Programi i Veprimit i BNK 2018–2020 do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe të rezultateve të pritshme, të përcaktuar në programin e BNK-së 2014–2020. Për hollësi të mëtejshme shihni seksionin 3.2 të programit BNK 2014–2020 (shtojca 2 e vendimit zbatues të Komisionit C (2014) 9674, i datës 11 dhjetor 2014).

2. Supozime dhe kushte

Si një kusht i nevojshëm për menaxhimin efektiv të programit, vendet pjesëmarrëse do të krijojnë një Komitet të Përbashkët Monitorimi dhe

⁵ https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en



të sigurojnë zyrat dhe personelin e përshtatshëm për Sekretariatën e Përbashkët Teknik (që do të krijohet me një vendim financimi të veçantë) dhe Antenës, në rast se kjo e fundit do të ngrihet.

Dështimi për të përmbushur kërkesat e përcaktuara më sipër mund të çojë në tërheqjen e fondeve të këtij programi dhe/ose rialokimin e fondeve në të ardhmen.

Deri më tani, përfituesit janë pajtuar me këtë gjendje, duke siguruar mbarëvajtjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Strugë (përfitues Ministria e Vetëqeverisjes Lokale) dhe Zyrës së Antenës në Elbasan. Këto struktura janë financuar plotësisht nga Masa Mbështetëse për Ndhimën Teknike për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA II, në kuadër të Instrumentit për Ndhimë Paraanëtarësimi (IPA II) për vitin 2014⁶.

Komisioni Evropian ka programuar mbështetje e mëtejshme financiare për vazhdimin e ofrimit të mbështetjes për Sekretariatën e Përbashkët Teknik dhe Zyrën e Antenës nga viti 2019 e tutje. Prandaj me përfituesit do të vendosin rregullime të reja që duhet të sigurojnë që kushtet e këtij paragrafi të respektohen më tej.

3. Elementet thelbësore të veprimit

Thirrje për propozime – Grante: 4,930,000 euro

a) Kriteret thelbësore të pranimit:

Aktivitetet e pranueshme janë përcaktuar në nenin 3.2 i Programit të BNK-së 2014–2020 dhe në shtojcës 2 të vendimit të Komisionit C (2014) 9674, të datës 11 dhjetor 2014. Lista e mëposhtme është një përmbledhje që tregon veprimet/operacionet kryesore të pranueshme:

- projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve të përbashkëta turistike dhe shërbimeve, si dhe investimet e vogla në infrastrukturën publike të turizmit;

- trajnimet për nxitjen e aftësive në industrinë e mikpritjes/turizmit;

- restaurimi/rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, si dhe mjedisit rrethues;

- mbështetja për aktivitete të përbashkëta kulturore;

- ndihma për NVM-të dhe sipërmarrjet fillestare në gjetjen e partnerëve të biznesit dhe të ndërkombëtarizimit të tyre;

- investimet në tregun e vogël ndërkufitar dhe lehtësirat në tregti;

- nxitja dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit;

- nxitja e investimeve në infrastrukturën e vogël për përballimin në rast fatkeqësish dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përfituesit duhet të jenë persona juridikë dhe të vendosur në një vend përfitues të IPA II, pjesëmarrës në programin e BNK-së.

Përfitues potencialë mund të jenë autoritetet vendore, njësitë ligjore të menaxhuara nga qeveritë vendore, shoqata të komunave, agjencitë e zhvillimit, organizatat e mbështetjes së bizneseve vendore, faktorët ekonomikë si, NVM-të, organizatat kulturore dhe të turizmit, OJQ-të, organet publike dhe private në mbështetje të fuqisë punëtore, institucionet e trajnimit profesional dhe teknik, organet dhe organizatat për mbrojtjen e natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e zjarrit/emergjencës, shkollat, kolegjet, universitetet dhe institucionet kërkimore, duke përfshirë institucionet e trajnimit teknik dhe profesional, dhomat e tregtisë, shoqatat e banorëve të vendeve të BNK-së, organizatat e fermerëve, ndërmarrjet publike.

b) Kriteri kryesor i përzgjedhjes është kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit.

c) Kriteret kryesore për dhënien e mbështetjes financiare janë: rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe efektiviteti i kostos së veprimit.

d) Shkalla maksimale e bashkëfinancimit nga BE-ja për grante në bazë të thirrjeve është 85% e kostos së veprimit.

e) Shuma treguese e thirrjes/ve: 4,930,000 euro.

Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të publikojnë më shumë se një thirrje për propozime. Çdo thirrje për propozime duhet të ketë të njëjtët objektiva, rezultate, kriteret thelbësore mbi pranueshmërinë, kriteret përzgjedhjeje dhe dhënieje, siç përshkruhet më sipër. Secila kontratë granti do të financohet nga një urdhër buxhetor.

⁶ C(2014) 37629.



Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të fillojnë një thirrje për propozime të cilat do të bashkojnë alokimet e vitit 2018 me alokimet e mëvonshme të buxhetit.

f) Datë treguese për publikimin e thirrjes/ve për propozime: Q2 2020 për urdhrin buxhetor të viteve 2018–2020.

3. Buxheti

2018				2019				2020				Vendimi i financimit, total
	Kontributi i Bashkimit*	Bashkëfinancimi i përfituesitve të grantit**	Totali i shpenzimeve		Kontributi i Bashkimit	Bashkëfinancimi i përfituesitve të grantit	Totali i shpenzimeve		Kontributi i Bashkimit	Bashkëfinancimi i përfituesitve të grantit	Totali i shpenzimeve	
Operacionet e BNK-së	1.700.000	300.000	2.000.000	Operacionet e BNK-së	1.700.000	300.000	2.000.000	Operacionet e BNK-së	1.530.000	270.000	1.800.000	4.930.000
në %	85	15	100	në %	85	15	100	në %	85	15	100	
TOTALI 2018	1.700.000	300.000	2.000.000	TOTALI 2019	1.700.000	300.000	2.000.000	TOTALI 2020	1.530.000	270.000	1.800.000	5.800.000

* Kontributi i Bashkimit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkëfinancimit të Bashkimit për çdo prioritet nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të lejueshme.

** Bashkëfinancimi i prioritetëve do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të kostos totale të lejueshme të projektit.

4. Zbatimi

4.1 Mënyra e zbatimit dhe rregullat e përgjithshme për procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit

Menaxhimi i drejtpërdrejtë:

Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni/nga delegacionet e Bashkimit, në përputhje me nenin 62(1)(a) të Rregullores Financiare.

5. Marrëveshjet e monitorimit të performancës

Si pjesë e kornizës së tij të matjes së performancës, Komisioni do të monitorojë dhe do të vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuar në Rregulloren e IPA II, në bazë të treguesve të paracaktuar, të qartë, të matshëm e transparentë. Progresraportet e përmendura në nenin 4 të Rregullores së IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të ndihmës IPA II.

Komisioni do të mbledhë nga të gjitha burimet e të dhënave mbi performancën (procesin, treguesit e produkteve dhe të rezultateve), të dhëna që do të mbledhen dhe të analizohen në aspektin e matjes së progresit kundrejt objektivave dhe synimeve të

përcaktuara për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe në Dokumentin Strategjik Indikativ.

Koordinatorët Kombëtarë të IPA-së (KKIPA-t) do të mbledhin informacion mbi performancën e veprimeve dhe programeve (procesin, treguesit e produkteve dhe rezultateve) dhe do të koordinojnë grumbullimin dhe prodhimin e treguesve që vijnë nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme: a) sistemi Monitorim i Orientuar në Rezultate (MOR); b) monitorimi i vetë përfituesve të IPA II; c) vetëmonitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; d) monitorimi i përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Negociatave të Fqinjësisë dhe Zgjerimit (NEAR) dhe Përfituesit të IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi, në zbatimin e ndihmës financiare do të monitorohet rregullisht nga një komision Monitorimi i IPA II, i mbështetur nga Komisioni i Përbashkët i Monitorimit, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel programi.



**INSTRUMENTI I NDIHMËS SË
PARAANËTARËSIMIT 2014–2020
PROGRAMI IPA CBC**

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E
MAQEDONISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Miratuar më 11.12.2014

Tabela e përmbajtjes

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË
PARAANËTARËSIMIT 2014–2020

AKRONIME

PËRMBLEDHJE

SEKSIONI 1

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

1.1 Përmbledhje e Programit

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e
partnerëve

SEKSIONI 2

ZONA E PROGRAMIT

2.1 Analiza e situatës – Përmbledhje

2.2 Gjetjet kryesore

SEKSIONI 3

STRATEGJIA E PROGRAMIT

3.1 Arsytimi – arsyetimi për strategjinë e
zgjedhur të ndërhyrjes

3.2 Përshkrimi i prioritetëve tematike të
Programit

3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura

SEKSIONI 4

PLANI FINANCIAR

SEKSIONI 5

DISPOZITAT ZBATUESE

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1

Analiza e Situatës dhe Analiza SWOT


Analiza e Situatës së Zonës së Programit

Analiza SWOT

Akronime

CBC	Bashkëpunimi ndërkufitar
CfP	Thirrje për propozime
CSO	Organizatë në mbështetje të Komunitetit
DG	Drejtoria e Përgjithshme
ERE	Autoriteti Kombëtar Rregulator i Energjisë Elektrike (Republika e Shqipërisë)
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
GBER	Rregullorja e përgjithshme e bllokimit dhe përjashtimeve (BE)
GDP	Prodhimi i brendshëm bruto
GfA	Udhëzimet për aplikantët
GVA	Vlera e shtuar bruto
HR	Burimet njerëzore
ICT	Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit
INSTAT	Instituti Statistikor i Republikës së Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Paraanëtarësimit
JTF	Task-Forca e Përbashkët
JTS	Sekretariati i Përbashkët Teknik
KPI	Treguesit kryesorë të performancës
LFS	Anketim mbi fuqinë punëtore
LP	Partneri udhëheqës (Parimi i Partnerit Udhëheqës)
LSMS	Studimi për matjen e standardeve të jetesës (Banka Botërore)
MIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

MoU	Memorandum mirëkuptimi
NACE	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NGO	Organizatë joqeveritare
NIPAC	Koordinatori Kombëtar i IPA-së
NSDI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Republika e Shqipërisë)
NUTS	Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat
OS	Struktura operative
PRAG	Udhëzime praktike të procedurave të kontraktimit për veprimet e jashtme të KE-së
RDI	Kërkimi shkencor, zhvillimi dhe inovacioni
SBA	Akti për biznesin e vogël (EU)
SME	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme, duke përfshirë firmat e vogla
OMC	Metoda e hapur e koordinimit për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen sociale (BE)
SWOT	Analiza e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve
TP	Prioritet tematik



Përmbledhje

Titulli i Programit	Programi BNK: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë
Zona e Programit	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: Pellagoni, Pollog, Jug-perëndimi Republika e Shqipërisë: Dibër, Elbasan, Korçë
Objektivi përgjithshëm i Programit	Të stimulojë një zhvillim më të ekuilibruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në aspektin social-ekonomik, në zonën kufitare
Prioritetet tematike të Programit	1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4) 2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7) 3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe e lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2) 4. Asistenca teknike
Objektivat specifike të Programit	TP 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore OS 1: Potenciali i turizmit është zhvilluar nga promovimi i trashëgimisë dhe i vlerave kulturore TP 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve OS 2: Kapaciteti produktiv i NVM-ve dhe aksesit i tyre në tregje janë forcuar TP 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe e lehtësimit ndaj ndryshimeve



	klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut OS 3: Ndërgjegjësimi për një ekonomi të gjelbër, mjedis të pastër dhe ndryshimet klimatike është rritur Asistenca teknike Zbatimi efektiv, efikas, transparent dhe në kohë i programit dhe rritja e ndërgjegjësisë
Alokimi financiar 2014–2020	11 900 000.00 euro
Metoda e zbatimit	Menaxhim i drejtpërdrejtë
Autoriteti kontraktues	Delegacioni i Bashkimit Evropian në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë
Autoritetet përkatëse nga pjesëmarrësit, përfitues të IPA II	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) Ministria e Integrimit Evropian (Republika e Shqipërisë)
JTS/Antena	JTS në Strugë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë Antena në Elbasan, Republika e Shqipërisë

SEKSIONI 1 PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi (MZ) dhe Shqipërisë (AL) do të zbatohet në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësisë (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integrimit në Bashkimin Evropian dhe promovimin e zhvillimit social ekonomik. Dispozitat ligjore për zbatimin e tij janë të përcaktuara në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

- Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësisë (IPA II);

- Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Bashkimit Evropian për financimin e veprimit të jashtëm;

- Rregullorja zbatuese e Komisionit të BE-së nr. 447/2014, e datës 2 maj 2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e rregullores IPA II.

1.1 Përmbledhje e Programit

Ky Program Bashkëpunimi Ndërkufitar mbulon periudhën 2014–2020 dhe lidhet me Perspektivën e Re Financiare të Komunitetit Evropian. Ai është hartuar mbi bazën e një analize të hollësishme të situatës në zonën e programit.

Zona kufitare e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë – Republikës së Shqipërisë përbën një nga zonat më të varfra dhe me më pak mundësi dhe kushte të favorshme për zhvillim social-ekonomik në të gjithë kontinentin evropian, për shkak të karakterit rural, malor dhe të largët të

Zonës BNK. Përveç kësaj, situata aktuale e zhvillimit të Zonës së Programit është rrjedhojë e një sërë faktorësh historikë, demografikë, politikë, gjeografikë dhe ekonomikë, të cilët nuk mund të kapërcehen në një periudhë kohore të shkurtër.

Ndërhyrja dhe aktivitetet e propozuara rrjedhin nga “grupi i problemeve” e kombinuar me analizën strategjike të bilancit dhe burimet e kufizuara të Programit. Ajo synon të trajtojë nyjat problematike më të rëndësishme dhe mundësitë strategjike të identifikuar nëpërmjet analizës social-ekonomike dhe SWOT, përkatësisht:

1. nivelet e ulëta të aktivitetit ekonomik së bashku me mospërputhjen e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;
2. infrastrukturën e pazhvilluar dhe të vjetërsuar; dhe
3. potencialet në zhvillimin e turizmit dhe shkëmbimin kulturor.

Realisht nuk pritet që **Zona e Programit** të rritet shpejt edhe pse **po shkon drejt një zhvillimi social-ekonomik më të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm** përmes testimit të instrumenteve dhe zgjidhjeve reja, duke mësuar nga rajone të tjera dhe duke mobilizuar dhe shfrytëzuar potencialin e brendshëm. Kjo mund të çojë në standarde më të larta të jetesës, vetëbesim dhe siguri sociale.

Programi përqendrohet në tri prioritetet tematike të Rregullores IPA II që rrjedhin nga analiza e nevojave-mundësive. Përkatësisht, këto janë:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (i nxitur nga mundësitë);
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (i nxitur nga nevojat dhe mundësitë);



3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (i nxitur nga nevojat).

Programi BNK përfshin e një prioritet mbi asistencën teknike.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Procesi i programimit të këtij Programi IPA II BNK për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë filloi në korrik të vitit 2013. E gjithë rrjedha e programimit u bazua në përvojën e përbashkët të procesit që ishte zhvilluar në periudhën 2007–2013.

Zhvillimi i këtij dokumenti të Programit u drejtua nga Task-Forca e përbashkët e përbërë nga përfaqësues të dy strukturave operative, delegatët e

zyrës së NIPAC në të dyja vendet, përfaqësues të rajoneve të Zonës së Programit NUTS-3 dhe disa njësi vetëqeverisëse. Puna e JTF u lehtësua dhe mbështet nëpërmjet Projektit të Asistencës Teknike CBIB+, financuar nga BE-ja, i cili solli praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë proces.

Sesionet e punës së SO-ve dhe JTF-ve u realizuan në të gjithë fazën e programimit, në mënyrë që të siguronin komunikim efektiv për të identifikuar prioritetet tematike për t'u trajtuar në strategjinë e zhvillimit të zonës së Programit dhe për ngritjen e strukturave të përshtatshme të zbatimit dhe të monitorimit. Përveç konsultimeve midis dy OS-ve, në kuadër të lehtësimit të të mësuarit dhe rrjetëzimit nën Projektin CBIB+, u zhvilluan:

Data/vendi	Aktiviteti
18.7.2013, Strugë	Takim i strukturave operative: identifikimi i sfidave dhe çështjeve kryesore; shkurtimi fillestar i listës së prioritetëve tematike dhe marrëveshja për analizën SWOT.
23.9.2013, Shkup	Takimi i parë me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Delegacionin e Bashkimit Evropian, ekipin e programimit dhe pikën e kontaktit kombëtare në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.
27.9.2013, Tiranë	Trajnim mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë: 14 pjesëmarrës (OSs, JTF, JTS, CBIB+): shpjegimi i procesit të programimit të IPA II CBC, diskutimi i mësimëve të nxjerra nga programi/et aktual/e, planifikimi hap pas hapi (analiza e situatës, gjetjet kryesore (SWOT, nevojat), bërja e zgjedhjeve strategjike – zgjedhja e prioritetëve, përcaktimi i prioritetëve, treguesit dhe objektivat), kontrolli i logjikës së ndërhyrjes, çështjet horizontale dhe ndërsektoriale.
30.9.2013, Shkup	Trajnim mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë: 21 pjesëmarrës (OSs, JTF, JTS, CBIB+): shpjegimi i procesit të programimit të IPA II CBC, diskutimi i mësimëve të nxjerra nga programi/et aktual/e, planifikimi hap pas hapi (analiza e situatës, gjetjet kryesore (SWOT, nevojat), bërja e zgjedhjeve strategjike – zgjedhja e prioritetëve, përcaktimi i prioritetëve, treguesit dhe objektivat), kontrolli i logjikës së ndërhyrjes, çështjet horizontale dhe ndërsektoriale.
4.10.2013, Shkup	Takim i Task-Forcës së përbashkët: reagime nga analiza SWOT fillestare, takimi me ekipin e Asistencës Teknike, diskutim mbi prioritetet tematike dhe logjikën e ndërhyrjes, hapat për të përfunduar dokumentin e Programit (14 pjesëmarrës).
24.10.2013, Strugë	Takim i Task-Forcës së përbashkët: situata përfshirëse dhe analiza SWOT, konfirmimi i prioritetëve tematike dhe përzgjedhja fillestare e aktiviteteve dhe aksioneve; diskutimi mbi treguesit; alokimet financiare.
7.11.2013, Tiranë	Takim i Task-Forcës së përbashkët: diskutimi mbi Strategjinë e Ndërhyrjes së Programit dhe Aktivitetet.
21-22.11.2013, Beograd	Forumi Rajonal Konsultativ CBC
6.12.2013, Elbasan	Konsultim publik: u prezantua Dokumenti i Programit, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioritetëve tematike dhe hapat e ardhshëm. Zgjedhja e prioritetëve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (14 pjesëmarrës).
11.12.2013, Tiranë	Takimi i Komitetit Monitorues të përbashkët: një temë e veçantë e rendit të ditës ishte prezantimi i procesit të programimit 2014–2020 midis ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë-Republikës së Shqipërisë para përfaqësuesve të JMC-së nga ministrinë e linjës së të dyja vendeve, përfaqësuesve të pushtetit vendor, EUD dhe OS-ve (36 përfaqësues).
12.12.2013, Tiranë	Takim teknik me OS-në, DG ENLARG, EUD dhe CBIB+: u zhvillua diskutim mbi Strategjinë e Programit dhe programe të tjera CBC në zhvillim e sipër.
12.12.2013, Pogradec	Seminar i konsultimit publik paraprak: u prezantua Dokumenti i Programit te palët



	e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshëm. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (11 pjesëmarrës).
13.12.2013, Korçë	Seminar i konsultimit publik paraprak: u prezantua Dokumenti i Programit te palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshëm. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (13 pjesëmarrës).
16.12.2013, Dibrë	Seminar i konsultimit publik paraprak: u prezantua Dokumenti i Programit te palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshëm. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (15 pjesëmarrës).
14.3/2014, Strugë	Konferenca e konsultimit publik me pjesëmarrjen e palëve të interesuara nga të dyja vendet: Komenti mbi përmbajtjen teknike të ndërhyrjes së Programit dhe propozimi për riformulimin e aktiviteteve të Programit (54 pjesëmarrës).
31.3.2014, Strugë	Takimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik: diskutim mbi përmbajtjen e Programit (drafti i dytë), konsensus për ndërhyrjen, aksionet dhe aktivitetet që kanë vijuar nga aktivitetet e konsultimit publik, të mbajtura deri në këtë moment (20 pjesëmarrës).
Maj 2014	Dorëzimi i draftit final të programit te Komisioni Evropian.

Gjithashtu, partnerë të tjerë të rëndësishëm socialë dhe ekonomikë u ftuan të marrin pjesë aktivisht në procesin e programimit për Programin IPA CBC II për periudhën 2014–2020 midis ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i kësaj ishte i trefishtë:

1. Të informojë publikun e gjerë mbi gjendjen e përgatitjes së programit për bashkëpunimin ndërkufitar, duke përfshirë fushat orientuese të aktiviteteve të pranueshme për tu mbështetur në kuadrin e këtij programi;
2. Të kontribuojë për analizën SWOT dhe identifikimin e nevojave dhe mundësive prioritare për ndërhyrjet CBC; dhe
3. Ti ofrojë publikut të gjerë një mundësi për të shprehur mendimet e tyre dhe për të dhënë kontribut të vlefshëm në procesin e programimit. Konsultimi publik është organizuar para finalizimit të dokumentit të Programit.

Krahas atyre, parimi i partneritetit është zbatuar nëpërmjet konsultimeve individuale të koordinuara me mbi 80 organizata të shoqërisë civile, kryesisht për analizën SWOT dhe caktimin e prioriteteve tematike, si edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së palëve kryesore të interesuara rajonale dhe lokale në seminarët konsultative.

SEKSIONI 2 ZONA E PROGRAMIT

Mbulimi gjeografik dhe madhësia e zonës përfituese të Programit rrjedh nga asistencë e mëparshme IPA CBC për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë dhe mbulon tri rajone NUTS-3 në secilin nga vendet. Këto rajone janë të shënuara më poshtë.

Rajonet e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë	Madhësia e Zonës së Programit (km ²)	Zona e Programit si % e madhësisë së shtetit
Pellagonia	4,717	18.3
Jug-Perëndimi	3,340	13.0
Pollogu	2,416	9.4
TOTAL	10,473	40.7

Rajonet e Republikës së Shqipërisë	Madhësia e Zonës së Programit (km ²)	Zona e Programit si % e madhësisë së shtetit
Korça	3,711	12.9
Dibra	2,586	9.0
Elbasani	3,199	11.1
TOTAL	9,496	33.0

Burimi: Zyra e Statistikave, INSTAT

Madhësia e përgjithshme e Zonës Ndërkufitare në të dyja vendet është 19,969 km². Rajonet e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përbëjnë 52,5% dhe rajonet e Republikës së Shqipërisë përbëjnë 47,5% të madhësisë së zonës së bashkëpunimit ndërkufitar.

Gjatësia e kufirit midis të dyja vendeve që përfaqësojnë zonën e Programit është 191 km. Vija kufitare është e shumëllojshme: 151 km është kufi tokësor, 12 km është kufi në lumin Drin dhe 28 km i kufirit përshkon liqenin e Ohrit dhe Prespës.

Ka 4 pika të vendkalimeve kufitare ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë:

1. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Qafëthanës, duke çuar në Pogradec, Librazhd dhe Elbasan;
2. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Tushemishtit, në skajin juglindor të liqenit të Ohrit, duke çuar në Pogradec;
3. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Bllatës, duke çuar në Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel;
4. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Goricës, duke çuar në brigjet veriore të liqenit të Prespës.

Gjashtë rajonet që përbëjnë zonën e Programit kanë një popullsi prej 1,427,675 banorë, nga të cilët ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë përmban 54% të këtij numri dhe Republika e Shqipërisë përmban 46% të tyre.⁷


Rajonet e pranueshme në territorin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përfshijnë 27 komuna, ndërsa në territorin e Republikës së Shqipërisë janë 12 rrethe (me 17 komuna), që hyjnë në zonën e Programit. Këto janë të shënuara më poshtë.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë:

- Rajoni i Pellagonisë përfshin 9 komuna: Manastir, Demir Hisar, Dollnen, Krivogashtan, Krushevë, Mogilla, Novac, Prilep dhe Resnjë;
- Rajoni i Pollogut përfshin 9 komuna: Bogovinjë, Bërvenicë, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë, Vrapçisht dhe Zhelinë;
- Rajoni Jugperëndimor mbulon 9 komuna: Qendër Zhupë, Dibër, Debarcë, Kërçovë, Brod, Ohër, Plasnicë, Strugë dhe Vevçan.

Në Republikën e Shqipërisë:

- qarku i Dibrës përfshin rrethet: Bulqizë, Burrel dhe Dibër;
- qarku Elbasan përfshin rrethet: Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd dhe Peqin;
- qarku Korçë përfshin rrethet: Devoll, Korçë, Kolonjë dhe Pogradec.



⁷ Deri në fund të vitit 2012; burimi: INSTAT-i dhe Zyra Shtetërore e Statistikave.



2.1 Analiza e situatës – përmbledhje

Zona e Programit karakterizohet nga burime të pasura natyrore, diversitet etnik dhe kulturë e ngjashme, por me gjuhë të ndryshme të folura. Megjithatë, më e rëndësishmja është se zonat kufitare në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë shfaqin trashëgimi të ndryshme ekonomike, që përcakton arsyetimin dhe potencialin për bashkëpunim ndërmjet njerëzve dhe institucioneve përtej kufirit për integrim dhe kohezion social dhe ekonomik më të mirë të rajonit.

Kjo përmbledhje bën dallimin ndërmjet aspekteve të përgjithshme dhe demografike, ekonomike dhe sociale të kohezionit, që frymëzojnë Strategjinë për ndërhyrjen e bashkëpunimit ndërkufitar 2014–2020, ndërsa një situatë më e hollësishme dhe analiza SWOT janë bashkëlidhur si shtojca në dokumentin e Programit.

Aspektet e përgjithshme dhe demografike

1. **Natyrë dhe mjedisi janë të pasura me male, fusha kodrinore të kryqëzuara me lumenj, lugina dhe liqene.** Kjo zonë përmban tri rezervuare të mëdha të ujit në rajon: liqenin e Ohrit, Prespës dhe Dibrës, të rrethuar nga një park kombëtar, duke krijuar kështu **kushte të favorshme për zhvillimin e energjisë hidrike**, në të cilën të dyja vendet kanë investuar tashmë. Zonat ekologjikisht të ndjeshme janë të pajisura me mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe **rajoni përmban gati gjysmën e pyjeve të të dyja vendeve.**

2. **Zona e Programit përmban dy korridore të transportit panevropian:** Korridori VIII dhe Dega D e Korridorit X, të cilat hapin mundësi ekonomike përgjatë dy rrugëve të transportit, por gjithashtu krijojnë sfida në aspektin e mirëmbajtjes së mjedisit dhe infrastrukturës.

3. **Të dyja vendet shfaqin një nivel pothuajse të barabartë të zhvillimit ekonomik** dhe gëzojnë përmirësimin e vazhdueshëm në marrëdhëniet dypalëshe, si dhe rritje në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka marrë statusin e vendit kandidat në BE, ndërsa aplikimi i Republikës së Shqipërisë varet nga progresi i mëtejshëm i reformës së administratës publike dhe rishikimi i rregullave dhe procedurave parlamentare.

4. Të dyja vendet gëzojnë norma pozitive të rritjes natyrore, por numri i popullsisë po rritet më

shpejt në Republikën e Shqipërisë se sa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. **Megjithatë, me përjashtim të rajonit të Pollogut dhe atij Jugperëndimor, zona e programit po përjeton tendencë negative.** Të dyja vendet vuajnë nga migrimet e jashtme, të cilët mund të kontribuojnë në shpopullim. Indeksi mesatar i dendësisë së popullsisë është i ngjashëm në të dyja anët e kufirit, por shifra shumë të ulëta të dendësisë së popullsisë janë regjistruar në rrethet (prefekturat) e Dibrës dhe Korçës, të cilat tregojnë karakterin e tyre rural dhe periferik.

5. Popullsia në zonën e programit është relativisht e re (36 vjeç), por **Pellagonia me një moshë mesatare të popullsisë prej 40 vjeç, përbën dallim nga pjesa tjetër e rajonit.**

Kohezioni ekonomik

6. Pabarazitë rajonale në të dyja vendet në aspektin e GDP-së për frymë, në përgjithësi konsiderohen të moderuara, por **zona e programit përmban rajone që në mënyrë të qartë mbeten prapa; këto janë: Pollogu në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Dibra në Republikën e Shqipërisë** (përkatësisht 47% dhe 62% e shifrave kombëtare).

7. **Struktura e ekonomisë e përcaktuar nga GVA është e ndryshme në të dyja anët e kufirit.** Ndërsa rajonet e Republikës së Shqipërisë mbështeten në bujqësi, pylltari, peshkim dhe tregjet me shumicë dhe pakicë, rajonet në territorin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbështeten në industri, e cila është më e zhvilluar se në Shqipëri, ndërtim dhe tregjet e shërbimeve. **Megjithatë, këto nuk përkthehen në GDP shumë më të lartë për shifrat kapitale dhe tregojnë nivele të ulëta të konkurrencës së këtyre sektorëve dhe industrive.**

8. **Konkurrenca e ulët është reflektuar në nivelet e ulëta të ndërkombëtarizimit të ekonomisë së zonës së Programit.** Vetëm Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Elbasani në Republikën e Shqipërisë, dëshmojnë një pozicion të shquar në tregun e jashtëm, kryesisht për shkak të industrisë minerare, ndërsa rajonet e tjera luajnë rol të parëndësishëm.

9. **Sipërmarrja e dëshmuar nga dendësia e SME-ve në raport me dendësinë e popullsisë është në nivele shumë të ulëta, e cila është një çështje e shqetësimit të lartë. Rregullat administrative të**



komplikuat dhe afatgjatë për tregtinë e jashtme konsiderohen si burokraci, duke penguar mundësitë e tregtisë.

10. Shkalla e punësimit është e ulët në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në mënyrë të konsiderueshme më e lartë në Republikën e Shqipërisë, por për këtë të fundit shkalla e punësimit të lartë rezulton nga niveli minimal i jetesës dhe nga prodhimi bujqësor në shkallë të ulët, i cili siguron një formë të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe të popullsisë rurale dhe shërben si amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

11. Zona e programit ka **potencial të lartë turistik**, por këto mundësi janë përqendruar kryesisht në anën e kufirit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

12. **Ekonomia rurale është e fragmentuar**, por në një shkallë më të lartë në zonën e programit në Republikën e Shqipërisë dhe pronarët e vegjël bujqësorë kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese.

13. Infrastruktura e transportit është e pazhvilluar dhe kjo lidhet si me rrugët lokale edhe me rrugët kryesore të Korridorit VIII.

Kohezioni social

14. Zona e programit përmban pakica etnike të konsiderueshme: shqiptarë, romë, turq dhe të tjerë.

15. Nivelet e papunësisë janë shumë të larta për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe relativisht të ulëta në Republikën e Shqipërisë. Për këtë të fundit, kjo dukuri është shkaktuar nga punësimi i lartë (kryesisht informal) në pronat bujqësore.

16. Pagat neto të punonjësve janë në nivele të ngjashme.

17. **Zona e Programit në Republikën e Shqipërisë përjeton përjashtim digjital.** Përdorimi i kompjuterëve dhe i Internetit është në nivele të ulëta të papranueshme.

18. Aksesimi në arsimin fillor është i balancuar, por ka një sforcim të dëshmuar në arsimin e mesëm në rajonin e Dibrës. Kjo prefekturë, gjithashtu, pëson shkallën më të lartë të largimit

të popullsisë me arsim të lartë në të gjithë zonën e Programit.

19. Nuk ka të dhëna specifike mbi RDI, por praktikisht mungon bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit në të dyja vendet dhe fusha e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit nuk është eksploruar.

20. Niveli i ulët i menaxhimit të mbetjeve, i çiftëzuar me intensitetin e lartë të minierave, janë një shqetësim i madh mjedisor. Kjo lidhet me përdorimin e mbetjeve të ngurta dhe mungesën e trajtimit të ujërave të zeza në pjesën më të madhe të zonës së programit.

21. Organizatat e shoqërisë civile janë të pranishme në zonën e programit, megjithatë pozita e tyre financiare është e dobët. Përveç kësaj, **OJQ-të në Republikën e Shqipërisë** hasin vështirësi me procedurën e regjistrimit dhe, si pasojë, legjitimiteti i tyre është penguar.

22. **Infrastruktura e kujdesit shëndetësor është e pazhvilluar dhe veçanërisht në zonën e programit të Republikës së Shqipërisë, është e vështirë për të përfituar nga ky shërbim.**

2.2 Gjetjet kryesore

Analiza social-ekonomike e kombinuar me vlerësimin e analizës SWOT identifikoi nyjat kyçe problematike për zonën e programit. Këto janë:

- nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik (performancës dhe produktivitetit);
- lidhur me këtë ka mospërputhje të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;
- qasje e pastrukturuar në investimet publike dhe aktivitetet e përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin.

Tri nyjat kryesore problematike janë ndarë më tej në nënnyja për të reflektuar rrjedhën e marrëdhënies shkak-pasojë, që ofron një kontekst strategjik dhe arsyetimin për zonat e ndërhyrjes CBC. Grupi logjik i problemit (ose vendimit) është përshkruar më poshtë.

Përveç këtyre nyjave strategjike, **kapaciteti i ulët institucional i njërive të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile paraqitet si një problem thelbësor ndërsektorial** dhe çështje shumë problematike, e cila manifestohet në planifikimin e mangët dhe alokimin e burimeve të kufizuara.



MOSPËRPUT HJE NË TREGUN E PUNËS	NIVEL I ULËT I PERFORMANCËS EKONOMIKE	INVESTIM PUBLIK I ULËT DHE I PAFOKUSUAR	KAPACITETE TË ULËTA ADMINISTRATIVE	NYJA PROBLEMATIKE
-Nivel i ulët i edukimit -Mungesë universitetesh ose akses i kufizuar në to -Mungesë e të mësuarit të vazhdueshëm -Aftësi të vjetërsuara -Marrëdhënie më të ulëta midis edukimit dhe tregut të punës	-Teknologji e vjetërsuar -Mungesë aksesit në treg -Aftësi të ulëta menaxhuese të bizneseve -Mbijetesë e ulët e bizneseve të reja -Akses i ulët në kapital -Përpunim i ulët bujqësor -Akses i kufizuar në shërbimet cilësore të biznesit -Mungesë ndërgjegjësimi -Mungesë e “mendimit sektorial”	-Strategji të pamjaftueshme -Proces i pamjaftueshëm i vendimmarrjes -Mungesë financimi -Mungesë ndërgjegjësimi -Vështirësi në hartimin e projekteve		SHKAQET (PROBLEMET RRËNJËSORE)
Infrastrukturë e pazhvilluar --- Rënie e cilësisë së jetesës --- Erozion i imazhit --- Rrezik për destabilitet Migrim i fuqisë punëtore Territore të prapambetur Papunësi --- Fuqi e ulët blerëse --- Ekonomi gri --- Mungesë pune Rritje e ulët ekonomike				EFEKTET

Shkaqet (ose problemet rrënjësore) në tabelën e mësipërme janë identifikuar përmes analizës së situatës dhe analizës SWOT. Ato njihen si pikat që kanë karakter ndërsektorial apo ndërtematik dhe kështu lidhen me tri prioritetet tematike për ndihmë për bashkëpunimin territorial siç janë identifikuar në aneksin III të Rregullores së IPA II:

1. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;⁸

2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Përveç problemeve, turizmi dhe trashëgimia kulturore janë identifikuar si një mundësi e rëndësishme ekonomike dhe një mjet për të rritur më tej kontaktet dhe shkëmbimin njerëz-për-njerëz. Kjo lidhet me një tjetër

prioritet tematik për asistencën për bashkëpunim territorial në shtojcën III të Rregullores së IPA II, që është inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Të gjitha prioritetet tematike janë renditur në mënyrë individuale nga palët e interesuara në procesin e programimit CBC (bashkitë, OJQ-të, ministritë e linjës, shoqëritë e shërbimeve publike dhe subjektet e tjera publike etj.), sipas rëndësisë së perceptuar të tematikave dhe çështjeve.⁹ Rënditja paraqet një reagim të rëndësishëm të programimit që pasqyrohet në qasjen nga poshtë-lart dhe është ndërtuar mbi parimin e partneritetit. Megjithatë, kjo nuk i merr në konsideratë kufijtë e politikave dhe burimeve, të cilët janë aplikuar vetëm nëpërmjet mekanizmit dhe parimit të koordinimit (pjesa 3).

⁸ Të lidhura me punësimin (TP1) i cili do të konsiderohet si një çështje ndërsektoriale

⁹ Rënditja u krye nëpërmjet pyetësorit individual SWOT që u plotësua nga aktorët kryesorë.

SEKSIONI 3 STRATEGJIA E PROGRAMIT

Strategjia njeh prioritetet e komunikuar nga palët e interesuara të programit (seksioni 2.2), të cilat më pas janë përpunuar dhe paraqitur nga strukturat operative CBC dhe Task-Forca e Përbashkët në krye të përpjekjeve të programimit, duke aplikuar parimin e koordinimit. Zgjedhjet strategjike janë bërë duke marrë parasysh parimet e mëposhtme mbizotëruese:

Koherenca – prioritetet tematike nuk u ndryshuan dhe janë të njëjtë që janë komunikuar në shtojcën III të Rregullores IPA II dhe përkatësisht në Dokumentin e Strategjisë Shumëkombëshe;

Partneriteti – prioritetet e përshtatshme janë zgjedhur bazuar në reagimet e marra nga organizatat që përfaqësojnë autoritetet rajonale, lokale, urbane dhe autoritetet e tjera publike, partnerët shoqërorë dhe ekonomikë, si dhe shoqërinë civile, partnerët mjedisorë, organizatat joqeveritare dhe organizatat përgjegjëse për promovimin e barazisë;

Përqendrimi – strategjia ofron një fokus të rëndësishëm dhe efikas të burimeve të kufizuara dhe të ndërhyrjes bazuar në specifikat sociale dhe ekonomike të zonës së programit që fokusohet në temat e përzgjedhura dhe mbi objektivat dhe masat me një rëndësi të veçantë nga kohezioni social-ekonomik dhe perspektiva e dëshiruar e zhvillimit.

Plotësueshmëria me Programin Kombëtar – programi plotëson dhe përforcon strategjitë kombëtare, ashtu siç janë përcaktuar në dokumentet e Strategjisë së Vendit, duke mbështetur bashkëpunimin rajonal dhe territorial.

3.1 Arsyetim – arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes

Përmbajtja e Strategjisë së propozuar rrjedh nga:

1. Analiza e situatës dhe analiza SWOT;
2. Nyjat problematike të identifikuar dhe mundësitë strategjike; dhe
3. Renditja e prioritetëve tematike sipas rëndësisë së tyre për zonën e programit: nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore, rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve dhe mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Një zhvillim social-ekonomik më i balancuar, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në zonën kufitare stimulohet. Ky është titulli dhe objektivi i përgjithshëm i programit, duke pasur parasysh perspektivën afatmesme në ndërhyrjen e propozuar.

Programi synon të ketë sinergji me objektivat specifike të IPA II dhe dokumentet e Strategjisë së Vendit në lidhje me: përkrahjen për zhvillimin e shoqërisë civile dhe dialogut social, nxitjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, përfshirjen sociale dhe ekonomike dhe bashkëpunimin territorial.

Tabela 1. Pasqyrë sintetike e justifikimit për përzgjedhjen e prioritetëve tematike

Prioritetet tematike të zgjedhur	Justifikimi për zgjedhjen
Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4, Rregullorja IPA II)	Bazohet në mundësitë strategjike të identifikuar që lidhen me rëndësinë në rritje të turizmit si një mundësi ekonomike, ndërsa nxitja e shkëmbimit kulturor dhe promovimi i trashëgimisë natyrore do të mbështesë nismat njerëzore për njerëz dhe dialogun ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve.
Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7, Rregullorja IPA II)	Synon të trajtojë nivelet e ulëta të punësimit në zonën e programit. Kjo do të trajtohet nëpërmjet përmirësimit të aksesit në tregje, rritjes së përdorimit të instrumenteve të TIK, duke përfshirë tregtinë elektronike dhe shfrytëzimin më efikas të mundësive të zinxhirit të vlerave në zonën kufitare.
Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2, Rregullorja IPA II)	Synon të përgjigjet nevojave specifike të një prej sektorëve më të neglizhuar të politikave. Në kontekstin CBC ky prioritet do të trajtojë çështjet e promovimit të ekonomisë së pastër dhe të gjelbër, përdorimit më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbështetjen e infrastrukturës së elasticitetit klimatik në shkallë të vogël (kundër përmblytjeve dhe zjarreve) dhe erozionin e tokës në zonën kufitare malore.

Asistenca teknike do të sigurojë një menaxhim efikas të programit gjatë gjithë ciklit të jetës dhe zhvillimin e kapaciteteve të palëve të interesuara të programit. Alokimi financiar ndaj këtij prioriteti është 10% e buxhetit të programit.

Alokimi i buxhetit indikativ nëpër prioritetet tematike është një konsensus ndërmjet parimit të përqendrimit kombinuar me shpërndarjen e balancuar të fondeve. Rëndësi e veçantë i është dhënë edhe intensitetit të kapitalit të projekteve të mundshme dhe renditjes aktuale të prioritetëve tematike, ku turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore janë temat më të preferuara për mbështetje.

Prioriteti tematik	Shpërndarja e buxhetit të fondeve të BE-së (%)
1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)	31.5
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)	31.5
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)	27.0
4. Asistenca teknike	10.0
TOTAL	100

Parimi i rritjes së mençur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse është i njohur si një çështje ndërsektoriale dhe është aplikuar në të gjitha prioritetet tematike të programit dhe në objektivat e tyre.

Gjithashtu, strategjia e propozuar bazohet në gjetjet kryesore dhe rekomandimet e raportit të vlerësimit të draftit CBC ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë për vitet 2007–2013. Prandaj, çështjet e mëposhtme merren në konsideratë:

- Mbështetja për projekte të vogla infrastrukturore të përbashkëta që nuk kërkojnë studime dhe projekttime të sofistikuar dhe komplekse;

- Asistenca ndaj projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e studimeve dhe projekttimeve për financim nga burime të brendshme dhe donatorë të tjerë;

- Fokus strategjik për veprime më të fuqishme, të cilët synojnë të sjellin ndikim më të prekshëm;

- Përmirësimi dhe orientimi më strategjik i JTS nën asistencën teknike, veçanërisht në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis përfituesve të mundshëm të ndodhur në zonën e programit dhe jo jashtë saj, për të siguruar gatishmërinë e tyre për të aplikuar nën parimin e partnerit kryesor;

- Forcimi i rolit të koordinimit strategjik të SO-ve;

- Orientimi i JTS-ve drejt rrjeteve dhe ndarjes së përvojës së projektit ndërmjet organizatave nga zona e programit;

- Nxitja e një roli më aktiv të JTS-ve në monitorimin e programit dhe zhvillimin e mjeteve dhe manualeve të brendshme dhe për përdoruesit e jashtëm;

- Përmirësimi i planifikimit dhe zbatimit të operacioneve nga SPT-ja.

Rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga dy vlerësimet e ndërmjetme mbi programet CBC të fokusuara në strukturat qeverisëse dhe në ecurinë e ndihmës, janë marrë në konsideratë¹⁰:

- Dokumenti i programimit duhet të jetë subjekt i:

1. konsultimeve publike dhe të pasqyrojë në mënyrë të qartë procesin e konsultimeve, duke përfshirë një pasqyrë të personave që morën pjesë dhe rezultatet e procesit të konsultimit;

2. të përfshijë çështjet e ndërlidhura në të gjitha dokumentet e programimit dhe

3. të kryejë një vlerësim të bazuar në parashikime (që do të përfshihet në dokument).

- Në lidhje me çështjet organizative, strukturat e programimit, duhet të:

1. kryejnë një auditim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe vlerësimin e nevojave për trajnim;

2. transferojnë detyrat të JTS-të, duke përfshirë edhe përgatitjen për grantet e asistencës teknike;

¹⁰ Vlerësimi i Ndërmjetëm i Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar midis vendeve kandidatë / kandidatë të mundshëm (kufijtë e Ballkanit Intraperëndimor) nën Komponentin e Bashkëpunimit Ndërkufitar të IPA; Raporti II – Performanca e ndihmës




3. mbështesin zbatimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit.

3.2 Përshkrimi i prioriteteve tematike të Programit

Përshkrimi i secilit prioritet tematik (TP) është organizuar në formën e fletës me të dhëna për prioritet me përmbajtje dhe strukturë të njëjtë për secilin prioritet, ndërsa prioriteti i asistencës teknike ka një përbërje të veçantë.

Numërimi i prioritetit tematik të programit është radhitur sipas radhës së rëndësisë së TP, e llogaritur gjatë ushtrimeve të programimit duke iu referuar regjistrimit të caktuar të TP të identifikuar në Rregulloren e IPA II.

Figura e mëposhtme përshkruan logjikën e ndërhyrjes së programit dhe kryqëzimin e prioriteteve individuale me çështjet e ndërthurura dhe horizontale.



Meqë perspektiva e programimit për vitet 2014–2020 është më e orientuar drejt rezultateve se sa kuadri i IPA 2007–2013, të gjithë treguesit e rezultateve të paraqitur në fletët e të dhënave më poshtë synojnë që të informojnë mbi përzgjedhjen e operacioneve dhe projekteve që do të mbështeten. Këto do të kontribuojnë drejtpërdrejt në përcaktimin e treguesve për Programin.

Përmbajtja e ndërhyrjes e përshkruar më poshtë ka marrë në konsideratë vërejtjet dhe komentet konstruktive të prodhuara gjatë aktiviteteve të konsultimeve publike të zhvilluara në zonën e programit në periudhën dhjetor 2013 – mars 2014.

Prioriteti tematik 1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)

Përmbledhje e prioritetit tematik dhe referenca strategjike

Evropa është destinacioni nr. 1 i turizmit në botë, me turizmin kulturor dhe një numër të madh të vendeve turistike, si dhe me një rrjedhë të fortë të vizitorëve ndërkombëtarë dhe vendas. Politikat e turizmit duhet të përshtaten me këto tendenca dhe të zhvillojnë një ofertë cilësore, duke promovuar kulturat dhe traditat lokale dhe duke i kushtuar vëmendje aspekteve të qëndrueshëm: ruajtja e trashëgimisë, e peizazhit dhe e kulturës lokale. Zona e programit synon të shfrytëzojë mundësitë strategjike që dalin nga potenciali më i gjerë i të gjithë kontinentit, i cili është në përputhje me konceptin e turizmit të qëndrueshëm dhe kulturor të promovuar nga DG Sipërmarrje dhe Industri.

Turizmi ka qenë i njohur si një nga mundësitë ekonomike prioritare që janë me interes për popullsinë në zonën CBC. Edhe pse industria e mikpritjes është e shpërndarë në mënyrë të



pabarabartë në zonën e programit, në të dyja vendet industria po rritet. Aktualisht, aktivitetet e lidhura me turizmin janë burimi kryesor i të ardhurave për popullsinë në rajonet e Ohrit dhe Prespës në muajt e verës, por ka shumë potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm kulturor dhe zbavitës në të gjithë rajonin CBC.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave të ndryshme në rajonin CBC është në rritje, por ende ekziston një mungesë praktike e iniciativave të qëndrueshme të përbashkëta në një shkallë më të gjerë. Aktivitetet e përfshira në këtë prioritet tematik do të mbështesin bashkëpunimin midis institucioneve, bazuar në vlerësimin e ofertës heterogjene dhe potencialin e kulturave dhe traditave të ndryshme të pranishme në zonë, si dhe aksionet njerëzit-për-njerëzit. Këto duhet të kontribuojnë për trajtimin e sfidave, të tilla si: ruajtja e burimeve natyrore dhe kulturore, nxitja e mirëqenies së komuniteteve lokale, përmirësimi i cilësisë së vendeve të punës në fushën e turizmit, kufizimi i ndikimit mjedisor të transportit që lidhet me turizmin etj.

Objektivi specifik

Objektivi specifik i këtij prioriteti tematik synon të zhvillojë potencialin e turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore (SO 1.1).

Prioriteti tematik do të inkurajojë shumëllojshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve turistike. Duke mbështetur projekte që

promovojnë produkte tematike turistike të qëndrueshme, programi do të forcojë bashkëpunimin trans-nacional në lidhje me turizmin e qëndrueshëm, do të inkurajojë një përfshirje më të madhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të autoriteteve lokale, dhe do të stimulojë konkurrencën e industrisë së turizmit me anë të një fokusimi të përmirësuar mbi shumëllojshmërinë e produkteve tematike të qëndrueshme dhe të turizmit kulturor. Gjithashtu, prioriteti tematik synon të rrisë aftësitë e stafit të angazhuar në industrinë e mikpritjes, duke përfshirë trajnimin profesional për të eliminuar mangësitë në aftësitë për të prezantuar një ofertë të larmishme turistike, p.sh., për guidat turistike dhe trajnerët e specializuar në sportet e dimrit, sportet malore, turizmin rural dhe aventurën, personeli i shërbimit të hoteleve etj.

Rezultatet e pritshme

Ky prioritet tematik synon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

1.1.1 Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur;

1.1.2 Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej.

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë organizuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e synuara të përfituesve
1.1.1.1 Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve të përbashkëta turistike dhe i investimeve në shkallë të vogël në infrastrukturën publike të turizmit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Ofruesit e shërbimeve turistike –OJQ-të, OSHC-të –Parqet kombëtare –Dhomat e tregtisë –Rrjetet / grupet e NVM-ve
1.1.1.2 Trajnim për rritjen e aftësive në industrinë e mikpritjes	–Institucionet arsimore e AAP –Institucionet e arsimit të lartë –Institucione të tjera formale dhe joformale arsimore dhe trajnuese –OJQ-të, OSHC-të –Rrjetet / grupet e NVM-ve
1.1.2.1 Restaurimi / rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, dhe e mjedisit të lidhur me këto objekte	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Ofruesit e shërbimeve turistike –OJQ-të –Institucionet kulturore (muzetë, bibliotekat, orkestrat etj.) –Operatorët në industrinë e mikpritjes (NVM)
1.1.2.2 Mbështetje për aktivitete të përbashkëta	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale



kulturore	–OJQ-të –Institucionet e arsimit (në të gjitha nivelet) –Institucionet kulturore (muzetë, bibliotekat, orkestrat etj.) –Banorët dhe organizatat e tyre
-----------	---

Treguesit e Performancës së Zbatimit të Prioritetit Tematik

Rezultati 1.1.1 i objektivit specifik: mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur

Treguesi i kontributit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i shërbimeve/produkteve të reja/përmirësuara	Shërbimet/produktet e reja të përmirësuara	0	4	10	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Nr. i personave të trajnuar	Trajnimi i njerëzve në industrinë e mikpritjes	0	50	500	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

Treguesi i rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i turistëve që përdorin shërbimet e reja/përmirësuara	Turistët përdorin shërbimet e reja/përmirësuara	0	2,000	5,000	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

Treguesi i ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë*	Vlera e synuar (2020)**	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të turistëve (me fjetje)	Numri mesatar i qëndrimeve me fjetje për turistët e regjistruar	2,8 net qëndrim me fjetje (të dhënat e 2013-s, duke përfshirë edhe statistikën nga të dyja vendet në zonat përfituese)	I rritur me 1 natë	Zyra Statistikore Shtetërore dhe INSTAT	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Burimi: Zyra Statistikore Shtetërore, http://www.stat.gov.mk/prikaziPublikacija_1.aspx?rbr=483. Të dhënat janë marrë nga anketa tremujore e ndërmarrjeve në Shqipëri, 2013

** Grumbullues

Rezultati 1.1.2 i objektivit specifik: bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej

Treguesi i kontributit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i vendeve të trashëgimisë kulturore të përmirësuara	Përmirësimi i vendeve të trashëgimisë kulturore	0	2	4	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Nr. i aktiviteteve të organizuara	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore	0	10	20	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Financimet e reja për libraritë e dixhitalizuara	Financime të reja për koleksione / librari kulturore të krijuar	0	2	5	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Grumbullues



Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i vizitorëve në vendet e trashëgimisë kulturore	Njerëzit vizitojnë vendet e trashëgimisë kulturore	PËR TU VEND OSUR *	I rritur me 7% për vendet dhe subjektet e ndërhyrjes së programit	I rritur me 15% për vendet dhe subjektet e ndërhyrjes së programit	Sistemi i monitorimit Zyra Statistikore Shtetërore dhe INSTAT-i	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
% e palëve të treta të përfshira në aktivitetet	Raporti i palëve të interesuara që u angazhuan në aktivitetet kulturore në kuadër të programit	1465*	E rritur me 10% në krahasim me 2007–2013	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) 2013

Modalitetet e zbatimit¹¹

Aktivitetet e parashikuara nën këtë prioritet tematik do të zbatohen nëpërmjet modaliteteve të skemës së granteve në bazë të metodologjisë së thirrjeve për projektpropozime brenda regjimit të PRAG.

Aktiviteti që synon përmirësimin e aftësive të personelit të industrisë së mikpritjes duhet të përfshijë përfaqësuesit e industrisë si aktorët kryesorë në secilin projekt propozim.

Në kuadër të këtij prioriteti tematik është parashikuar një gamë e gjerë e përfituesve të mundshëm. Vetëm për aktivitetin 1.1.2.2 pritet një numër i konsiderueshëm i projekteve të vogla që do të nxisin bashkëpunimin njerëz-për-njerëz dhe institucion-për-institucion.

Aktivitetet 1.1.1.1 dhe 1.1.2.1 do të zbatojnë projekte me ndikim më të rëndësishëm afatgjatë, të tilla si infrastruktura e turizmit në shkallë të vogël dhe renovimi i monumenteve historike dhe kulturore.

Qëllimi i ndërhyrjes në këtë prioritet tematik mund të kryqëzohet pjesërisht me mbështetjen e dhënë nëpërmjet prioritetit tematik 2, veçanërisht në lidhje me sipërmarrjet private, të cilat do të jenë aplikues dhe përfitues të pranueshëm. Në këtë aspekt, është hartuar linja ndarëse në vijim: palët e

interesuara të prioritetit tematik (partnerët ose bashkëpunëtorët sipas modaliteteve PRAG) që bien në kategorinë e SME-ve duhet të përfshihen nën seksionin 1 të NACE: akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit.

Dy skenarë janë parashikuar për të siguruar mbështetje granteve:

1. Aktivitetet 1.1.1.1, 1.1.2.1 do të mbështeten në perspektivën afatmesme pasi kërkojnë një mbështetje më të gjerë për lehtësimin, mobilizimin dhe zhvillimin e projektit se sa aktivitetet e tjera. Kështu, ato do të përfshihen vetëm në raundin e dytë dhe të tretë të thirrjeve për projektpropozime, ndërsa aktivitetet 1.1.1.2 dhe 1.1.2.2 do të mbështeten nëpërmjet raundit të parë dhe të tretë të thirrjeve për projektpropozime.

2. I gjithë prioriteti tematik do të zbatohet nëpërmjet një thirrje për projektpropozime (përfshirë mund të bëhet për aktivitetin 1.1.2.2 i cili mund të përsëritet në çdo thirrje për projektpropozime, kur është rasti për të reduktuar barrierat e hyrjes për aplikuesit me kapacitet më të ulët financiar).

Një thirrje e vetme për propozime mund të mbulojë më shumë se një prioritet tematik. Kur është e nevojshme dhe e mundur, thirrja për projektpropozime do të përfshijë ndarjet e buxhetit nga alokimet e ndryshme financiare vjetore, në mënyrë që të promovojë projekte në një shkallë më të madhe.

¹¹ Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.



Prioriteti tematik 2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)

Përmbledhje e prioritetit tematik dhe referenca strategjike

Papunësia e lartë, nivelet e ulëta të punësimit dhe vlerës së shtuar në ekonominë e zonës së programit është një çështje e shqetësimit të lartë. Kështu, nxitja, mbështetja dhe krijimi i vendeve të punës dhe burime alternative të të ardhurave paraqitet si një nga objektivat kryesorë të politikës së zhvillimit social-ekonomik të rajonit CBC në këto rrethana.

Prioriteti tematik do të synojë të mbështesë aksesin në tregjet të operatorëve ekonomikë në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë në zonën e programit, rritjen e përdorimit të instrumenteve të TIK dhe teknologjisë, dhe shfrytëzimin e mundësive të pashfrytëzuara të zinxhirit të vlerave, duke përfshirë ato në ekonominë rurale. Pritet që këto të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës, zhvillimin e tregtisë dhe investimet e reja në zonën e programit.

Aktivitetet e këtij prioriteti tematik kanë si qëllim të trajtojnë një numër të kufizuar të mundësive strategjike që lidhen me konkurrencën, e cila mbetet një nga shtyllat kryesore të Strategjisë së Evropës 2020. Qëllimi i ndërhyrjes së propozuar është plotësisht në përputhje me qasjen e sektorit IPA II: zona A e politikës - procesi i tranzicionit

dhe ndërtimi i institucioneve, sektori: zhvillimi i sektorit privat dhe objektivi tematik 3 i ndërhyrjes së fondeve strukturore: konkurrueshmëria e SME-ve.

Objektivi specifik

Ky prioritet tematik përqendrohet në forcimin e kapaciteteve prodhuese të SME-ve dhe aksesit të tyre në tregje (SO 2.1).

Ndërhyrja do të përqendrohet në përmirësimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi mundësitë që rrjedhin nga hapjet e zinxhirit të vlerave ekonomike ekzistuese, mbështetjen në drejtim të produktit dhe procesit të certifikimit të cilësisë të kërkuar në tregjet ndërkombëtare, dhe në përdorimin e gjerë të teknikave të shitjes moderne, duke përfshirë tregtinë elektronike. Në mënyrë që të rritet ekonomia rurale dhe mundësitë e saj strategjike, do të sigurohet një fushatë për të hapur / zhvilluar tregjet e organizuar të prodhimeve të freskëta.

Rezultatet e pritshme

Rezultati i pritshëm i lidhur me objektivin specifik të prioritetit tematik është:

2.1.1. Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti i SME-ve dhe bizneseve të reja për të hyrë në tregjet e reja dhe zinxhirët e vlerave janë rritur.

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë grupuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e Synuara të Përfituesve
2.1.1.1 Asistencë për SME-të dhe bizneset e reja për ndërkombëtarizim dhe gjetjen e partnerëve të biznesit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Organizatata anëtare të biznesit (p.sh. dhomat e tregtisë / artizanatit) –Shoqatat e SME-ve, grupimet dhe rrjetet e tyre –Organizatata RDI dhe institucionet e arsimit të lartë
2.1.1.2 Investime në tregun e vogël ndërkufitar dhe në objekte tregtare	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Qendrat për zhvillim të rajoneve planifikuese –Ndërmarrjet publike (në pronësi mbi 50% nga organet publike) - në rast të zhvillimit të tregjeve ndërkufitare dhe objekteve tregtare (përfshirë tregjet e prodhimeve të freskëta) –Shoqatat e SME-ve, grupimet e tyre dhe organizatat anëtare të biznesit (p.sh. dhomat e tregtisë / artizanatit) –Shoqatat e fermerëve

**Treguesit e performancës së zbatimit të prioritetit tematik**

Treguesi i kontributit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i aktiviteteve të tregtisë së jashtme	Aktivitete që synojnë tregun e jashtëm	0	5	10	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i bizneseve që marrin pjesë në aktivitete të reja të tregtisë së jashtme	Nr. i bizneseve që përfitojnë nga aktivitetet e reja të tregtisë së jashtme	0	30	50	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i SME-ve me certifikata të reja të konformitetit të fituara (ISO, HACCP etj.)	SME-të që kanë certifikata të reja të konformitetit	0	8	20	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i tregjeve të reja dhe objekteve tregtare të zhvilluara nëpërmjet marrëveshjeve	Nr. i marrëveshjeve me tregje të reja dhe objekte tregtisë	0	1	3	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbullues

Treguesi i rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Ndarja e vlerës së eksportit të mallrave dhe shërbimeve (%)	Raporti i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në lidhje me tregtinë e përgjithshme	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 2%	Rritje me 5%	Sistemi i monitorimit, Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor
Qarkullimi i bizneseve	Rritja e shitjeve totale të një shoqërie për një periudhë të caktuar	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 3%	Rritje me 8%	Sistemi i monitorimit, Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT-i	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Vlera bruto e shtuar nga sektori	Përqindje e rritur e vlerës së të mirave dhe shërbimeve të prodhuara në sektorin ekonomik brenda zonës gjeografike	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 2% në krahasim me vitin 2013	Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor

* Të dhënat do të llogariten pasi zyrat e statistikave të sigurojnë informacionin e nevojshëm.

Modalitetet e zbatimit¹²



Të gjitha aktivitetet e prioritetit tematik 2 do të zbatohen nëpërmjet modaliteteve të skemës së granteve.

Ndihma e dhënë për bizneset individuale duhet të jetë në përputhje me ligjet e BE-së: i) ndihma shtetërore e dhënë nën GBER ose ii) tavani i ndihmës minimale dhe maksimale të jetë deri në 85%, për të siguruar bashkëfinancimin minimal të kërkuar për IPA.

Vija ndarëse e kufirit midis aktivitetëve të realizuara në bazë të këtij prioriteti tematik dhe prioritetit tematik 1 është përcaktuar në bazë të pranueshmërisë së aplikantëve: SME-të dhe rrjetet e tyre që përfitojnë nga ndërhyrjet e prioritetit tematik 2 nuk duhet të bien nën seksionin I të NACE: Aktivitetet e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore.

Janë parashikuar dy opsione për të ofruar ndërhyrjen në bazë të këtij prioriteti tematik, në varësi të karakteristikave përfundimtare të ofertës financiare:

1. Aktiviteti 2.1.1.1 mund të mbështetet në raundin e parë dhe të tretë të thirrjeve për projektpropozime, ndërsa aktiviteti 2.1.1.2 gjatë raundit të dytë ose të tretë të thirrjeve për projektpropozime (për të shmangur përplasje në një thirrje për projekte me aktivitetin 1.1.2.1 që pritet gjithashtu të konsumojnë pjesë të mëdha të financimit - këto projekte pritet të jenë të konsiderueshme në madhësi dhe me kohëzgjatje më të madhe se çdo iniciativë tjetër).

2. I gjithë prioriteti tematik mund të zbatohet nëpërmjet një thirrje për projektpropozime.

Prioriteti tematik 3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)

Përmbledhje e prioritetit tematik dhe referenca strategjike

Zona e programit karakterizohet nga një mjedis dhe natyrë e pasur dhe e larmishme, dhe në përgjithësi njihet si një territor i pastër dhe i gjelbër. Megjithatë, në rajon mungon infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit, si dhe strategjitë dhe praktikët për njohjen në kohë, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut. Zona kufitare është e prirur drejt motit të pafavorshëm dhe dukurive klimatike,

veçanërisht stuhive të rënda dhe reshjeve që rezultojnë në përmbytje lokale dhe rrëshqitje të tokës, duke dëmtuar rrugët, pronat private dhe tokën bujqësore. Në stinët e thata, zjarret rrezikojnë dhe dëmtojnë ekonominë rurale dhe prodhimin e të korrave. Kështu, rimëkëmbja prej katastrofave klimatike është një nga çështjet që duhet të trajtohen nëpërmjet këtij prioriteti tematik.

Përveç kësaj, përmirësimi i mbledhjes së mbetjeve të ngurta, menaxhimit të mbetjeve dhe praktikët e parandalimit të erozionit të tokës, konsiderohen si fusha prioritare të ndërhyrjes në rajonin CBC.

“Të jetosh mirë, brenda kufijve të planetit tonë” është titulli kryesor i Programit të ri të Veprimit për Mjedisin deri në vitin 2020, i propozuar nga Komisioni Evropian. Ky prioritet tematik i programit CBC bazohet në këtë nismë, dhe është në përputhje me politikat e Zonës B të IPA II: zhvillimi rajonal, sektori: mjedisi dhe ndryshimet klimatike dhe objektivat tematikë 5 dhe 6 të ndërhyrjes së fondeve strukturore: përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, parandalim dhe menaxhimi i rrezikut dhe mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i efikasitetit të burimeve.

Aktivitetet e këtij prioriteti tematik përfshijnë të dyja llojet e projekteve: “projektet e butë” me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe promovimin e përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve, ekonomisë të gjelbër; si dhe mbështetjen e investimeve të vogla në infrastrukturën për mbrojtjen e mjedisit, e cila konsiderohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në rajonin ndërkufitar dhe në prodhimin e efektit të demonstrimit. Gjithashtu, ndërhyrja synon të trajtojë kapacitetet e ulëta financiare dhe institucionale të shoqërive të shërbimeve publike, si dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe metodave të prodhimit bujqësor.

Objektivi specifik

Kryetitulli i objektivit specifik të këtij prioriteti tematik (SO 3.1) mbetet rritja e ndërgjegjësimit për një ekonomi më të gjelbër, mjedis më të pastër dhe ndryshimet klimatike.

Qartësisht, prioriteti tematik ka një dimension hapësinor që kërkon një qasje të bazuar në vend, pasi territore të caktuara kufitare janë të veçantë nga të tjerët. Ky prioritet tematik do të përqendrohet në ndërtimin e ndërgjegjësimit dhe njohurive, integrimin e komuniteteve dhe grupeve të synuara, dhe në zbatimin e masave reale për të

¹² Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.



trajtuar çështjet e parashikuara në seksionin e mësipërm. Fokus i veçantë do të drejtohet ndaj përpunimit të produkteve pyjore drusore dhe furnizimit me ujë.

Rezultatet e pritshme

Ky prioritet tematik do të arrijë rezultatet e mëposhtme:

3.1.1. Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur;

3.1.2 Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar.

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë grupuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e synuara të përfituesve
3.1.1.1 Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Qendrat për zhvillim të rajoneve të planifikuara –Shoqëritë e shërbimeve publike –Parqet kombëtare –OSHC-të, OJQ-të –Dhomat e tregtisë –Organizatrat RDI –Shoqatat e banorëve në zonat ndërkufitare, kryesisht në zonat rurale –Shoqatat e fermerëve –Institucionet e arsimit primar, dytësor dhe tretësor, dhe ato të hulumtimit –Rrjetet e SME-ve
3.1.2.1 Promovimi i investimeve të vogla në infrastrukturë për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe mbrojtjen e mjedisit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Qendrat për zhvillim të rajoneve të planifikuara –Qendrat kombëtare dhe rajonale për menaxhimin dhe monitorimin e fatkeqësive –Shoqëritë e shërbimeve publike –Shoqatat e fermerëve –OSHC-të, OJQ-të –Dhomat e tregtisë –Shoqatat e banorëve në zonat ndërkufitare, kryesisht në zonat rurale

Treguesit e Performancës së Zbatimit të Prioritetit Tematik

Rezultati 3.1.1 i objektivit specifik: ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur.

Treguesi i Kontributit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i fushatave ndërgjegjëse mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të mjedisit	Fushata të reja publike mbi çështjet e mjedisit në nivel projekti	0	5	12	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të përmirësuar brenda zonës	Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të modernizuara brenda zonës	0	3	6	Sistemi i monitorimit	Vjetor



Nr. i aksioneve të pastrimit	Nr. i nismave të pastrimit të zbatuara në nivel projekti	0	4	8	Sistemi i monitorimit	Vjetor
------------------------------	--	---	---	---	-----------------------	--------

* Grumbulluese

Treguesi i rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
% e popullsisë në zonën CBC e ndërgjegjësuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit në sektorët kyç	Norma e popullsisë së informuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe çështjet e mjedisit	PËR TU VENDOSUR*	1% (rreth 14,000)	3.5% (rreth 50,000)	Sistemi i monitorimit	Vjetor
% e të gjitha bizneseve dhe organizatave që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve	Raporti ndërmjet atyre që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta dhe të gjitha organeve ekzistuese në zonë	PËR TU VENDOSUR*	5%	10%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Përdorimi i ujit nga familjet dhe bizneset	Përqindja e humbjeve të ujit e reduktuar	PËR TU VENDOSUR*	Rënie e përdorimit të ujit me 10%	Sistemi i monitorimit Zyra Shtetërore e Statistikave dhe INSTAT-i	Vjetor
% e mbetjeve të grumbulluara për riciklim	Norma e mbetjeve të ricikluara në raport me sasinë e mbledhur	PËR TU VENDOSUR*	Rritja e mbetjeve të grumbulluara për riciklim me 15%	Sistemi i monitorimit	Vjetor
	Norma e numrit të vendshkarkimeve të paligjshme të mbyllura në raport me numrin fillestar të vendshkarkimeve ekzistuese	PËR TU VENDOSUR nga JTS me bashkitë, ministrinë e mjedisit	Ulja e numrit të vendshkarkimeve të paligjshme me 10%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Rezultati 3.1.2 i objektivit specifik: infrastruktura publike në rrezik nga përmytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar

Treguesi i kontributit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i projekteve të mbështetur	Nr. total i projekteve të reja të mbështetur nën këtë objektiv	0	5	12	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i objekteve të siguruar për mbrojtjen nga përmytjet dhe zjarri	Nr. i objekteve të reja të siguruar për mbrojtjen nga përmytjet dhe zjarri	0	0	2	Sistemi i monitorimit	Vjetor



zjarret						
Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit	Nr. i fushatave të reja të ndërgjegjësimit	0	2	5	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja	Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja	0	100	250	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* *Grumbulluese*

Treguesi i rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Gjatësia e rrugëve të mbrojtura	Nr. i km të rrugëve të ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore të mbrojtura në raport me nr. e km të rrugëve në nevojë për mbrojtje	0	3%	10% e rrugëve të ekspozuara ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor
Madhësia e sipërfaqes bujqësore të mbrojtur	Norma e sipërfaqes së tokës bujqësore të mbrojtur në raport me sipërfaqen totale të tokës në nevojë për mbrojtje	0	2%	5% e tokës e ekspozuar ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT-i, Sistemi i monitorimit	Vjetor
Madhësia e zonave pyjore të mbrojtura	Norma e sipërfaqes së zonës pyjore të mbrojtur në raport me sipërfaqen totale të zonës pyjore në nevojë për mbrojtje	0	2%	5% e pyjeve të ekspozuar ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT-i, Sistemi i monitorimit	Vjetor

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Madhësia e zonës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të mbuluar nga aktivitetet	Sipërfaqja e pranueshme e programit CBC është mbuluar nga aktivitetet e projektit	0	3%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

Modalitetet e zbatimit¹³

Aktivitetet do të zbatohen nëpërmjet financimit me grante, duke ndjekur modalitetet e PRAG për dhënien e granteve.

Zbatimi i prioritet tematik do të kërkojë përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të interesit në nivel lokal dhe rajonal. Pritet që me kalimin e kohës të ketë një ndikim më të ndjeshëm nga motivimi i autoriteteve lokale dhe shoqërive publike komunale në rajonin e bashkëpunimit ndërkufitar për të marrë një rol aktiv në zbatimin e programit: investimet e vogla në mjedis do të projektohen në kuadër të mandatit të tyre nëpërmjet procedurave transparente të prokurimit publik, dhe nuk do të kërkohej përgatitja e dokumentacionit të detajuar dhe të shtrenjtë të projektit të financuar nga fondet e programit.

Financimi i granteve mund të ofrohet në bazë të skenarëve të mëposhtëm alternativë:

1. Të dyja aktivitetet mund të zbatohen paralelisht.
2. Aktiviteti 3.1.1.1 mund të zbatohet gjatë raundit të parë dhe të tretë të thirrjeve për projektpropozime, ndërsa aktiviteti 3.1.2.1 - në rrjedhën e raundit të dytë të thirrjeve për projektpropozime.

¹³ Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

Asistenca teknike

Objekti i asistencës teknike është të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu, ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dyja vendet përfitues të IPA II. Për më tepër, siç ka treguar përvoja në ciklin e programit 2007–2013, ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.

Alokimi për asistencën teknike do të përdoret për të mbështetur punën e strukturave kombëtare operative (OS) dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC), në sigurimin e fillimit, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin efikas të programeve, si dhe për një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Sekretariati të Përbashkët Teknik (JTS) me bazë në territorin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe një Zyrë Antena në Republikën e Shqipërisë. JTS do të jetë në krye të menaxhimit të përditshëm të programit dhe do të raportojë mbi ecurinë e tij OS-ve dhe JMC-së.

Rezultatet e synuara:

Mbështetja administrative për strukturat operative (OS) dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (JMC) të programit është rritur.

Ky prioritet do të sigurojë një zbatim normal të programit gjatë të gjitha fazave të tij. Ai përfshin disponueshmërinë e mjeteve financiare dhe vendosjen e personelit të kualifikuar përgjegjës për të ndihmuar strukturat operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, si dhe krijimin dhe zbatimin e mekanizmave dhe procedurave të menaxhimit, monitorimit dhe kontrollit. Nëse kërkohet, ai gjithashtu do të kontribuojë në përgatitjen e ciklit pasardhës financiar (2021–2027).

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri më 2022	Burimi
Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar ¹⁴	Përqindje	0	60 %	Anketë

Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur.

Ky prioritet do të ofrojë mundësi për përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të strukturave menaxhuese të programeve, si dhe të aplikuesve të mundshëm dhe përfituesve të granteve. Aktivitete specifike për ngritjen e kapaciteteve do të planifikohen dhe zbatohen në bazë të nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të programit. Si pjesë e mësimave të nxjerra nga cikli i programit 2007–2013: i) do të pritët një pjesëmarrje në rritje e anëtarëve të KPM në detyrat e përcaktuara nën kuadrin ligjor të IPA II; ii) kapaciteti i aplikuesve të mundshëm për zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare do të rritet; dhe iii) kapaciteti i përfituesve të granteve për të përmbushur detyrimet e kontratave të tyre në mënyrë të kënaqshme, të do të përforcohet.

¹⁴ Kërkon një studim të rregullt dhe të thjeshtë duke përdorur një pyetësor standard me pyetje të mbyllura.

**Treguesit e rezultatit:**

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri më 2022	Burimi
Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme ¹⁵	Përqindje	123 *	+ 45%	AIR
Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm	Përqindje	59	10 %	AIR

Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet.

Programet CBC kanë qenë shumë të famshëm në zonat përfituese, përveç të tjerave, falë veprimeve të vizibilitetit të ndërmarra gjatë ciklit të programit 2007–2013. Duke parë numrin e aplikuesve në thirrjet pasuese, është vënë re se ka një interes në rritje për iniciativat e bashkëpunimit. Këto arritje duhet të ruhen dhe të përmirësohen edhe gjatë zbatimit të perspektivës financiare 2014–2020. Një shumëllojshmëri e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve të publicitetit duhet të zhvillohet për të siguruar informacion të rregullt midis palëve të interesuara të programit dhe një audience më të gjerë.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri më 2022	Burimi
Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese	Numër	1398*	2000	AIR
Vizitat në faqen e internetit të programit	Numër	40*	700	AIR

* AIR 2013

Lloji i aktiviteteve:

Një listë joshëse e aktiviteteve të mundshme të mbuluara nga alokimi i asistencës teknike do të përfshijë:

- Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij.
- Organizimi i aktiviteteve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikatat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial.
- Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE-së.
- Përgatitja e manualeve/doracakëve të brendshëm dhe/ose të jashtëm.
- Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve etj.).
- Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit.
- Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës.
- Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve.

Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promovuese dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit etj.

Mbështetje për punën e Task-Forcës së përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026.

¹⁵ Ju lutemi, të vini re se në perspektivën financiare 2014-2020, thirrjet e mundshme të përshtatura/ strategjike për propozime janë parashikuar me fokus të qartë dhe/ose kërkesa të caktuara në lidhje me përfituesit e mundshëm. Gjithashtu, thirrjet për projektpropozime mund të përdorin parimin e rotacionit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike (TP) dhe objektivave të tyre specifike, dhe në këtë aspekt numri i propozimeve jo domosdoshmërisht mund të rritet. Për këto arsye, rritja e pritshmërisë së aplikimeve të marra mund të llogaritet për çdo thirrje të njëpasnjëshme në mënyrë individuale, dhe do të ndikohet nga një faktor që mund të llogaritet në bazë të: 1) Buxheti i përgjithshëm në dispozicion, 2) Prioritetet tematike, objektivat specifike dhe rezultatet e përfshira në thirrjen për projektpropozime, 3) Shumat minimale dhe maksimale të lejuara të granteve, 4) Numri i aplikimeve dhe granteve të lejuara për aplikues / bashkë-aplikues/entet e lidhur, dhe 5) Çdo dispozitë tjetër e veçantë që ndikon në kritere të ndryshme të pranueshmërisë, të zbatueshme për një thirrje specifike për projektpropozime.

**Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë (listë joshteruese):**

- strukturat e menaxhimit të programit;
- aplikuesit e mundshëm;
- përfituesit e granteve;
- përfituesit përfundimtarë të projektit;
- publiku i gjerë.

Modalitetet e zbatimit

Plani i vizibilitetit dhe komunikimit duhet të prodhohet në përputhje me kërkesat e përgjithshme të IPA II dhe praktikat më të mira mbi transparencën dhe trajtimin e barabartë.

Përfituesit duhet të informohen në mënyrë korrekte dhe të plotë mbi rregulloret për publicitetin. Kujdes i veçantë i kushtohet rregullave të vizibilitetit edhe gjatë monitorimit të zbatimit të projektit.

Organet e përfshira në zbatimin e programit janë përgjegjëse për të siguruar që përfituesit përfundimtarë të marrin masat për informimin dhe publicitetin mbi aktivitetet e bashkëfinancuara në kuadër të IPA II, në përputhje me udhëzimet e BE-së mbi vizibilitetin.

Tabela 2. Përmbledhje e strategjisë së programit

Prioriteti tematik (TP)	Objektivat specifike	Rezultatet	Treguesit	Llojet e aktiviteteve (shembuj)
Prioriteti tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore. (TP4)	Objektivi specifik i këtij prioriteti tematik synon të zhvillojë potencialin e turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore	1.1.1 Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur; 1.1.2 Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej.	1.1.1 Nr. i turistëve që përdorin shërbimet e reja/ përmirësuar. Nr. i shërbimeve/ produkteve të reja/përmirësuar. Nr. i personave të trajnuar. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të turistëve (me fjetje). 1.1.2 Nr. i vizitorëve në vendet e trashëgimisë kulturore. Nr. i vendeve të trashëgimisë kulturore të përmirësuar. Nr. i aktiviteteve të organizuara. Nr. i librarive të reja të digjitalizuara. % e palëve të interesuara të përfshirë në aktivitete.	1.1.1.1 Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve të përbashkëta turistike dhe i investimeve në shkallë të vogël në infrastrukturën publike të turizmit. 1.1.1.2 Trajnim për rritjen e aftësive në industrinë e mikpritjes. 1.1.2.1 Restaurimi / rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, dhe e mjedisit të lidhur me këto objekte. 1.1.2.2 Mbështetje për aktivitete të përbashkëta kulturore.
Prioriteti tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve. (TP7)	Forcimi i kapaciteteve prodhuese të SME-ve dhe aksesit të tyre në tregje.	2.1.1 Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti i SME-ve dhe bizneseve të reja për të hyrë në tregjet e reja dhe zinxhirët e vlerave janë rritur.	Vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve (%). Qarkullimi i bizneseve GVA. Nr. i aktiviteteve të tregtisë së jashtme. Nr. i bizneseve që marrin pjesë në aktivitete të reja të tregtisë së jashtme. Nr. i SME-ve me certifikata të reja të konformitetit të fituara (ISO, HACCP etj.). Nr. i tregjeve të reja dhe objekteve tregtare të zhvilluara nëpërmjet	2.1.1.1 Asistencë për SME-të dhe bizneset e reja për ndërkombëtarizim dhe gjetjen e partnerëve të biznesit. 2.1.1.2 Investime në tregun e vogël ndërkufitar dhe në objekte tregtare.



			marrëveshjeve.	
Prioriteti tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut. (TP2).	Rritja e ndërgjegjësimit për një ekonomi më të gjelbër, mjedis më të pastër dhe ndryshimet klimatike.	3.1.1 Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur; 3.1.2 Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar.	3.1.1 Përdorimi i ujit nga familjet dhe bizneset. % e mbetjeve të grumbulluara për riciklim. Nr. i fushatave ndërgjegjëse mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të mjedisit. Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të përmirësuar brenda zonës. Nr. i aksioneve të pastrimit. % e popullsisë në zonën CBC e ndërgjegjësuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit në sektorët kyç. % e të gjitha bizneseve dhe organizatave që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve. 3.1.2 Gjatësia e rrugëve të mbrojtura. Madhësia e sipërfaqes bujqësore të mbrojtur. Madhësia e zonave pyjore të mbrojtura. Nr. i projekteve të mbështetur. Nr. i objekteve të siguruar për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarret. Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit. Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja. Madhësia e zonës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të mbuluar nga aktivitetet.	3.1.1.1 Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit. 3.1.2.1 Promovimi i investimeve të vogla në infrastrukturë për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe mbrojtjen e mjedisit.
Asistenca teknike	Të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në	Mbështetja administrative për strukturat operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit të programit është rritur.	Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar. Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme.	Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij. Organizimi i aktiviteteve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikatat më të mira të nismave të tjera



	nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dyja vendet përfitues të IPA II. Ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.	Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur. Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohej.	Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm. Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese. Vizitat në faqen e internetit të programit.	të zhvillimit territorial. Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE-së. Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm. Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve etj.). Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit. Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës. Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve. Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promovuese dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit etj. Mbështetje për punën e Task-Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026. Tjetër.
--	---	--	---	--



3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura

Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale kanë të bëjnë me temat e ndërlidhura me modalitetet e zbatimit të prioriteteve tematike të përzgjedhura dhe me politikat e komunitetit të karakterit horizontal.

Programi pranon aksionet **njerëz-për-njerëz** dhe **rrjetet institucionale/të bashkëpunimit për LPP** si modalitete që do të zbatohen në të gjitha prioritetet e zgjedhura tematike.

Përveç kësaj, legjislacioni i BE-së kërkon që çështjet specifike horizontale dhe ndërsektoriale që janë pjesë e politikave të komunitetit, të trajtohen në mënyrën e duhur në të gjitha programet e financuara nga BE-ja. Në këtë kontekst, strategjia ka të bëjë me prioritetet e Evropës 2020 në harmoni me rrethanat rajonale, duke trajtuar një vizion të ekonomisë sociale të tregut në Evropë, duke sjellë kështu nivele të rritura të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit social. Kjo strategji është e bazuar në tri prioritetet e përbashkët përforcues: **rritje e mençur, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse** për të gjithë. Në këtë kontekst, **qëndrueshmëria sociale** është çështja që integrohet në këtë program të bashkëpunimit ndërkufitar, e cila synon të parandalojë çdo diskriminim në bazë të gjinisë, prejardhjes raciale apo etnike, fesë ose besimit, paafësisë, moshës ose orientimit seksual. Ndërsa **qëndrueshmëria e mjedisit** do të kërkojë kryesisht pajtueshmërinë me direktivën e habitateve 92/43/KE, direktivën për zogjtë 79/409/KE dhe direktivat në lidhje me rrjetin evropian të zonave të mbrojtura NATURA 2000. Në krye të kësaj, çështjet mjedisore do marrin në konsideratë drejtpërdrejt aspekte që, ndër të tjera, lidhen me menaxhimin e mbetjeve, efikasitetin e energjisë dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike si pjesë e prioritetit 3.

Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale do të trajtohen në mënyrë të dyfishtë:

1. Nëpërmjet operacioneve dhe aktiviteteve të drejtpërdrejta, duke nxitur dhe mbështetur rritjen gjithëpërfshirëse dhe qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore;

2. Nga përfshirja e tyre si çështje të ndërlidhura që kanë ndikim të tërthortë dhe integrohen në operacionet dhe aktivitetet brenda çdo prioriteti tematik.

Rrjedhimisht, strukturat operative janë të nevojshme për të futur dispozita të veçanta në dokumentet që shtrojnë bazat për aktivitetet dhe

operacionet, p.sh. skemat e granteve, termat e referencës etj., në mënyrë që të sigurohet që:

- Aktivitetet dhe operacionet të mos vendosin pengesa të lidhura me gjininë, pikëpamjet, orientimin seksual, racor apo origjinën etnike, veçanërisht në lidhje me punësimin dhe politikat e HR të ndjekura ndaj personave të cilët do të jenë të punësuar në kuadër të projekteve të zbatuara nën skemat e granteve ose përmes ndërhyrjeve të asistencës teknike;

- Përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuara të jetë një nga kriteret që duhet të respektohet për zhvillimin e infrastrukturës;

- Përfituesit e granteve të bashkëpunimit ndërkufitar të sigurojnë që përfituesit përfundimtarë të kenë mundësi të barabarta aksesit në të gjitha shërbimet, trajnimet, asetet ose pajisjet fikse ose jomateriale të blera nëpërmjet aktiviteteve dhe operacioneve;

- Aktivitetet dhe operacionet gjithashtu duhet të hartohen në përputhje me parimet e një mjedisi të qëndrueshëm dhe promovimit të mbrojtjes së mjedisit, dhe të prodhojnë ndikim pozitiv ose të paktën neutral në mjedis. Që aktivitetet dhe operacionet të kenë ndikim pozitiv, duhet të hartohen me qëllim që, ose të marrin në konsideratë të paktën një nga pikat e mëposhtme:

- përmirësimin e zinxhirit të menaxhimit të mbetjeve (për mbetjet e ngurta dhe/ose të lëngshme);

- zvogëlimin e vëllimit të mbetjeve tashmë të krijuara, në fazën e planifikimit dhe projektimit të projektit individual;

- përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

- elasticitetin klimatik;

- proceset pjesëmarrëse të planifikimit dhe konsultimit publik për proceset e planifikimit të zhvillimit hapësinor dhe të investimeve.

Projektet të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e vendeve të punës (duke përfshirë dialogun social), nxitjen e punësimit dhe forcimin e kushteve të punës, si dhe të promovojnë sigurimin e barazisë.

Temat horizontale dhe të ndërlidhura të këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar duhet të harmonizohen edhe nëpërmjet prioritetit të Asistencës Teknike që synon forcimin e efikasitetit dhe efektivitetit të ndërhyrjeve të bashkëfinancimit nga fondet e IPA II me cilësi të lartë dhe



menaxhim të shëndoshë në nivel kombëtar dhe me mbështetje gjithëpërfshirëse në nivel lokal.

Projektet e përgatitura në kuadër të qasjes së Zhvillimit të Bazuar në Zonë (ABD) për të lehtësuar rritjen e qëndrueshme në zonat gjeografike të përcaktuara në rajonet ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor, në zona të veçanta rurale që karakterizohen nga probleme të veçanta komplekse zhvillimore, mund të konsiderohen për financim në kuadër të këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar. Puna përgatitore për qasjen ABD tashmë të zbatuar në rajonin ndërkufitar që mbulon ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

dhe Republikën e Shqipërisë, do të merret në konsideratë.

SEKSIONI 4 PLANI FINANCIAR

Tabela 1 tregon sasinë vjetore të parashikuar të kontributit të Bashkimit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar për periudhën 2014–2020. Tabela 2 ofron një shpërndarje të parashikuar për alokimet për secilin prioritet tematik si dhe një parashikim mbi shumën maksimale të bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian.

Tabela 1. Alokimet e parashikuara financiare në vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014–2020

Viti	Programi IPA II CBC Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë							Totali (EUR)
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014–2020
Operacionet CBC (të gjitha prioritetet tematike)	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 530 000	10 710 000
Asistenca teknike	510 000	0.00	0.00	510 000	0.00	0.00	170 000	1 190 000
Totali (EURO)	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	11 900 000

Tabela 2. Alokimet e parashikuara financiare për prioritet gjatë periudhës 2014–2020 dhe shkalla e kontributit të BE-së

PRIORITETET	Programi IPA II CBC ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë 2014–2020			
	Kontributi i BE-së	Bashkëfinancimi i përfituesve	Financimi total	Shkalla e kontributit të BE-së
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
1.Prioriteti tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore	3 750 000.00	661 764.71	4 411 764.71	85%
2.Prioriteti tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve	3 750 000.00	661 764.71	4 411 764.71	85%
3.Prioriteti tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	3 210 000.00	566 470.58	3 776 470.58	85%
4.Asistenca teknike	1 190 000.00	0.00	1 190 000.00	100%
GRANTI TOTAL	11 900 000.00	1 890 000.00	13 790 000.00	

Kontributi i BE-së është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkëfinancimit të BE-së në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

Bashkëfinancimi i prioritetëve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

Shuma e dedikuar për asistencën teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të caktuar për programin. Shkalla e bashkëfinancimit të BE-së do të jetë 100%.



Fondet për prioritetet tematike do të jepen nëpërmjet vendimeve të Komisionit Zbatues, duke mbuluar alokime një deri në trevjeçare, sipas nevojës. Fondet për asistencën teknike do të jepen nëpërmjet një vendimi të veçantë të Komisionit Zbatues.

SEKSIONI 5 DISPOZITAT ZBATUESE

Në kuadër të këtij programi nuk janë parashikuar thirrje për projekte strategjike.

Ashtu siç është parashikuar nën prioritetin e asistencës teknike, aplikuesit kanë të drejtë të kenë mbështetje gjatë hartimit dhe zhvillimit të projektit.

Duke pasur parasysh që baza duhet të identifikohet përpara ndërhyrjes së programit, të gjithë aplikuesit duhet të ofrojnë informacionin e kërkuar për të llogaritur vlerën e treguesve bazë. Informacioni duhet të sigurohet për aplikuesin kryesor, të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët.

Për shkak të burimeve të kufizuara financiare, nuk ka asnjë dispozitë për të synuar nëntema ose aktivitete specifike për thirrje për propozime.

Modalitetet e propozuara të zbatimit janë të detajuara në përshkrimin e çdo prioriteti, të bazuar në supozimin se gjatë periudhës së zbatimit të programit do të kryhen tri raunde të thirrjeve për projektpropozime dhe në faktin që nuk është parashikuar asnjë projekt strategjik për zbatim. Tabela e mëposhtme përmbledh këto modalitete bazuar në dy skenarë të hartuar nën paragrafin e modaliteteve të zbatimit të seksionit 3.2. Megjithatë, këta skenarë kanë një natyrë supozuese dhe mund të ndryshojnë në bazë të mundësive të tjera që mund të shqyrtohen gjatë zbatimit të programit dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe rezultateve të prokurimit.

Skenari 1

Ky skenar parashikon organizimin e tri rundeve të thirrjeve për propozime me ndarje të barabartë financiare për çdo prioritet tematik, me afërsisht 1/3 e buxhetit total të programit për prioritet. Të gjitha thirrjet do të synojë secilin prioritet dhe aktivitete të zgjedhura.

Të gjitha grupet e synuara do të kenë akses të barabartë në financimin e ofruar nga programi.

Raundi i thirrjeve për projektpropozime	Aktivitetet
I pari	1.1.1.2 1.1.2.2 2.1.1.1 3.1.1.1
I dyti	1.1.1.1 1.1.2.1 2.1.1.2 3.1.2.1
I treti	1.1.1.1 1.1.2.1 1.1.1.2 1.1.2.2 2.1.1.1 2.1.1.2 3.1.1.1



Skenari 2

Sipas këtij skenari çdo thirrje për projektpropozime do të synojë një prioritet të vetëm, përveç raundit të parë ku aktiviteti 1.1.2.2 është përjashtuar. Ky aktivitet do të përfshihet në raundin e dytë dhe të tretë të thirrjeve për projektpropozime, në mënyrë të përsëritur.

Raundi i thirrjeve për projektpropozime	Aktivitetet
I pari	Prioriteti 1, përveç aktivitetit 1.1.2.2 që mund të qarkullojë gjatë gjithë periudhës së zbatimit
I dyti	Prioriteti 2 me aktivitetin 1.1.2.2
I treti	Prioriteti 3 me aktivitetin 1.1.2.2

Të gjitha projektet dhe aksionet do të përzgjidhen për mbështetje duke pasur parasysh çështjet horizontale dhe ndërsektoriale të parashikuara në pikën 3.3.

Projektet duhet të projektohen dhe paketohen në përputhje me parimin e partnerit kryesor.

LISTA E SHTOJCAVE SHTOJCA 1

Analiza e Situatës dhe Analiza SWOT

Analiza e Situatës së Zonës së Programit

Rajoni kufitar midis ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë karakterizohet nga gjuhë të ndryshme të folura dhe larmi etnike, por kulturë, histori dhe vlera tradicionale të ngjashme. Karakteristikat e mëposhtme kryesore hapësinore dhe klimatike dominojnë zonën e programit:

Vargu Jugor i Alpeve Dinarike (Dinariket) me pyje dhe kullota të bollshme, natyrë të pasur dhe mjedis të kombinuar me fusha dhe ultësira, pengon aksesin në të gjithë rajonin: diferenca ndërmjet majës më të lartë (Golem Korabi 2.753 m mbi nivelin e detit) dhe zonave fushore të Pellagonisë (130 m mbi nivelin e detit) është më shumë se 2.600 m.

Liqeni i Ohrit, i Prespës dhe Liqeni artificial i Dibrës, së bashku me parqet kombëtare Galiciça dhe Shebenik-Jabllanicë dhe fushat, kamionët dhe livadhet e tyre, sigurojnë kushte të favorshme për faunën dhe florën dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit. Pyjet mbulojnë rreth 44% të zonës së programit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe 37% të zonës së programit të Republikës së Shqipërisë. Liqeni i Ohrit është deklaruar nga UNESCO-ja si vend kulturor dhe natyror i trashëgimisë botërore dhe liqeni i Prespës është një zonë Ramsar me rëndësi ndërkombëtare.

Dy korridoret kryesore të transportit mbarevropian nxjerrin në pah vendndodhjen e rëndësishme gjeostrategjike të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë në Evropën Juglindore. Korridori VIII (Durrës-Shkup-Sofje-Varna) dhe Dega D e Korridorit X (Igumenicë-Manastir-Prilep-Veles) ndikojnë fuqishëm në dinamikën e zonës së programit, ekonominë, njerëzit dhe mjedisin e saj.¹⁶

¹⁶ Korridoret e përcaktuara sipas konkluzioneve të Konferencës së Kretës (1994) dhe Konferencës së Helsinkit (1997) mbi korridoret multimodal panevropian dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar nga vendet e Ballkanit Perëndimor (2004).



Zona kufitare është e pasur me minerale, p.sh. krom, qymyr, hekur-nikel, bakër, gëlqere, kuarc, rërë dhe mermer.

Rajoni ndërkuftar karakterizohet nga kushte të ndryshme klimatike: nga transkontinentale në veri, në transmesdhetare në jug dhe në pjesët qendrore. Megjithatë, në zonat më malore të këtyre rajoneve dimri është i ftohtë dhe i lagësht, ndërsa vera është e nxehtë dhe e thatë. Temperaturat në zonat malore përgjatë kufirit variojnë prej -16 deri në +36 gradë (minimumi dhe maksimumi). Mesatarja vjetore e reshjeve në anën e Republikës së Shqipërisë (+1.400 mm) është më e lartë se sa në anën e kufirit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (600 mm).¹⁷

Aspektet politike

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka qenë identifikuar si një kandidat potencial për anëtarësim në BE që në vitin 2003. Vendi ka aplikuar për anëtarësim në BE në mars të vitit 2004 dhe i është dhënë statusi i kandidatit në vitin 2005.

Në mënyrë të ngjashme me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Republika e Shqipërisë u identifikua si një kandidat potencial për anëtarësim në BE në vitin 2003. Në vitin 2009, Republika e Shqipërisë paraqiti kërkesën zyrtare të saj për anëtarësimin në BE. Në vitin 2010, Komisioni

vlerësoi se përpara se negociatat e pranimit të mund të hapen formalisht, Republika e Shqipërisë duhet të punonte akoma për të arritur një shkallë të nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe, në veçanti, për të përmbushur 12 prioritetet kyçe të identifikuara nga Opinioni. Më vonë në vitin 2012, Komisioni rekomandoi që Republikës së Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit të BE-së, duke i lënë si detyrë plotësimin e masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe të administratës publike, si dhe rishikimin e rregullave të procedurave parlamentare.

Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kuadri udhëzues i referencës politike është informuar nga Plani Kombëtar për Miratimin e *Acquis*, i cili informon politikat kombëtare dhe veprimet e qeverisë. Objektivat kryesorë strategjikë të Programit të Punës së Qeverisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë që kanë të bëjnë me periudhën 2011-2015, përfshijnë:

1. Përsheptimi i rritjes ekonomike, punësimit dhe standardit të jetesës së qytetarëve, duke përfshirë cilësinë e jetesës;

2. Integrimi i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në BE dhe NATO-s;

3. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit dhe zbatimi efikas i ligjit duke ndërmarrë reforma të thella në gjyqësor dhe në administratën publike;

4. Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira ndëretnike bazuar në parimet e tolerancës dhe

¹⁷ Burimi: Banka Botërore



respektit reciprok dhe zbatimi i Marrëveshjes Kuadër të Ohrit; dhe

5. Mbështetja e investimeve në arsim, shkencë dhe teknologji informacioni, si elemente kryesore të një shoqërie të bazuar në dije.

Strategjia për Zhvillimin Rajonal 2009-2019 e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë identifikon bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar, si një nga shtyllat dhe objektivat kryesorë të zhvillimit të balancuar social-ekonomik rajonal. Rajonet kufitare, së bashku me zonat rurale dhe malore janë përcaktuar si zona me nevoja të veçanta zhvillimi, duke u bërë kështu një prioritet për ndërhyrje social-ekonomike.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim e Republikës së Shqipërisë 2014–2020 (NSDI) konsiderohet si kuadri i politikave gjithëpërfshirëse për vendin në kontekstin e integritetit në BE. Ajo përcakton katër shtyllat e politikës strategjike që përcaktojnë themelet për ndërhyrjet sektoriale dhe të bazuara në vend:

1. Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës që trajton aspekte, si: sistemi zgjedhor, drejtësia dhe punët e brendshme, të drejtat e njeriut dhe media, qeverisja efektive dhe politikat e jashtme dhe të mbrojtjes;

2. Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik konkurrues dhe të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit efikas të burimeve që mbulojnë: stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makroekonomike, ekonominë konkurruese të tregut, përdorimin efikas të burimeve, zhvillimin e integruar rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

3. Nxitja e përfshirjes sociale, mirëqenies dhe zhvillimit të tregut të punës, të cilat synojnë të promovojnë: politikat e punësimit dhe përfshirjes sociale, politikat sociale;

4. Zhvillimi i një shoqërie të bazuar në dituri, inovacion dhe teknologji digjitale, që përfshin ndërhyrjet në fushat në vijim: arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Shqipërisë dallon **zonat kufitare si subjekt të planifikimit të politikave ndërsektoriale** dhe i bën çështjet ndërkufitare pjesë të planifikimit të politikave të zhvillimit në nivel qarku.

Raportet e vitit 2012 nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi zbatimin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë theksojnë se marrëdhëniet midis dy vendeve vazhdojnë të përmirësohen dhe ato tregojnë baza të shëndosha për shfrytëzimin e mundësive ekonomike në të dyja anët e kufirit.

Demografia

Dinamikat në demografi janë të ndryshme në të dyja vendet. Ndërsa norma e popullsisë së përgjithshme të Republikës së Shqipërisë ka pësuar rritje të ndjeshme dhe është dyfishuar në 50 vjetët e fundit, popullsia e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është rritur me mesatarisht 29%.

Në fund të vitit 2012, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë kishin një popullsi prej përkatësisht 2,061,044 dhe 2,815,749 banorë. Zona e programit përfshin 770,802 banorë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (37.4% e popullsisë së përgjithshme të saj) dhe 656,873 banorë në Republikën e Shqipërisë (23.3% e popullsisë së përgjithshme të saj). Një ndarje më e detajuar e nivelit të popullsisë sipas NUTS-3 dhe dendësisë së popullsisë (persona/km²) është dhënë më poshtë.

Zona e Programit	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë
Pellagonia	232,959	49.4
Pollogu	317,003	131.2
Jugperëndimi	220,840	66.1
Gjithsej në zonën e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë	770,802	73.6
Dibra	137,811	37.1
Elbasani	297,476	115.0
Korça	221,586	23.3
Gjithsej në zonën e Republikës së Shqipërisë	656,873	69.2

Burimi: Zyra e Statistikave e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, INSTAT



Rajoni i Pollogut me kryeqytetin e tij në Tetovë dhe Elbasani me qytetin kryesor të Elbasanit janë njësitë statistikore më të mëdha në zonën e programit në aspektin e popullsisë. Roli i shquar policentrik i qendrave të tyre kryesore urbane është reflektuar në dendësinë e popullsisë së dy rajoneve.

Femrat përbëjnë 49.9% të popullsisë në tri rajonet e pranueshme në territorin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, e cila pasqyron strukturën e popullsisë sipas gjinisë në të gjithë vendin. Në zonën e programit në Republikën e Shqipërisë femrat përbëjnë 49.5% të popullsisë së saj, që është pak nën mesataren e vendit (49.9%).

Për sa i përket rritjes natyrore të popullsisë, zonat e programit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë karakterizohen nga rritje pozitive natyrore në rajonin e Pollogut dhe atë jugperëndimor, ndërsa të gjitha zonat përfituese në Republikën e Shqipërisë dhe në Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, po përjetojnë tendenca negative.

Megjithatë, vetëm normat e rritjes natyrore të bashkuara me bilancin e migrimit të kohëve të fundit ilustrojnë tendencat aktuale demografike. Brenda zonës së programit, vetëm rajonet e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë gëzojnë bilanc pozitiv të migrimit, ndërsa të gjithë rajonet në Republikën e Shqipërisë vuajnë nga tendencat negative të migrimit, të cilat kontribuojnë në shpopullimin e zonave të tyre. Bilanci negativ i migrimit në rajonet përkatëse të Republikës së Shqipërisë është shkaktuar nga zhvendosja e kontingjentit të punës të grup-moshës 25-40-vjeçare për të kërkuar për mundësi punësimi në rajone të tjera. Ndërsa largimi i meshkujve është më i përhapur në Dibër dhe Elbasan, Korça paraqet migrimin më të shpejtë të femrave drejt zonave të tjera.

Asnjëri nga të dyja vendet nuk përjeton plakjen e popullsisë. Përkundrazi, mosha mesatare në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë mbetet e njëjtë për dy vitet e fundit (38 vjeç) dhe popullsia në Republikën e Shqipërisë bëhet më e re (me një mesatare prej 36 dhe 35 vjeç përkatësisht).¹⁸ Brenda zonës së programit, mosha më e lartë mesatare e popullsisë është në Pellagoni (40 vjeç) dhe mbetet e qëndrueshme gjatë viteve të fundit, ndërsa rajoni më i ri është ai i Pollogut (35 vjeç), me tendenca të

ngjashme me ato të vëzhguara në Republikën e Shqipërisë.

Popullsia e re (grup-mosha 0-14 vjeç) përbën 17.1%, ndërsa popullsia e moshuar (65+ vjeç) përbën 11.9% të popullsisë së përgjithshme të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në Republikën e Shqipërisë, shifrat përkatëse janë: 20.3% dhe 11.6%, dhe nuk ka mospërputhje të mëdha midis rajoneve të vendit. Përkundrazi, Pollogu dhe Pellagonia regjistrojnë diferencën më të lartë në lidhje me pjesën e popullsisë së tyre të moshuar: përkatësisht 8.5% dhe 15.0%.¹⁹

Raporti i moshës së të punësuarve është një çështje shqetësuese në Republikën e Shqipërisë. Edhe pse indeksi pësoi një rënie të ngadaltë dhe arriti në 47 në vitin 2012 ndërsa për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është përcaktuar në 41, rritja natyrore e bashkuar me rritjen e parashikuar të jetëgjatësisë mund të ndikojë negativisht në ekonomi. Në zonën e programit, Pellagonia është rajoni më i prekur nga plakja e popullsisë (shkalla e moshës së të punësuarve është 43), ndërsa në Republikën e Shqipërisë është Korça (mesatarisht 50%).²⁰

Kohezioni ekonomik

Të dyja vendet shfaqin nivel të ngjashëm të zhvillimit dhe janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesataren nga Banka Botërore. Megjithatë niveli i brendshëm i të ardhurave bruto i tyre thjesht e kalon vijën ndarëse midis ekonomive të tyre dhe të vendeve me të ardhura të ulëta – të mesme.

Prodhimi i brendshëm bruto

Duke pasur parasysh faktin se analizat janë kryer mbi nivelin NUTS-3 dhe GDP-ja për frymë tregon pozitë të shquar të kryeqyteteve të të dyja shteteve, si të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë, në vendet e tjera pasuria është e shpërndarë në mënyrë të moderuar në të dyja shtetet, me pabarazi më të larta të vërejtura në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në krahasim me Republikën e Shqipërisë. Në vitin 2011, GDP për frymë arriti në 3,631 € në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 3,214 € në Republikën e Shqipërisë. Tabela e mëposhtme ilustron pabarazitë ndërmjet rajoneve të zonës së programit dhe treguesit e performancës së dy vendeve.

¹⁸ Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave; llogaritja e bazuar në të dhënat e papërpunuara të INSTAT-it.

¹⁹ Burimi: *si më lart*

²⁰ Burimi: *si më lart*



Zona e Programit	GDP për frymë (EURO)	Indeksi (për vend = 100)
Pellagonia	3,702	102
Pollogu	1,719	47
Jug-perëndimi	2,638	73
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	3,631	100
Dibra	1,999	62
Elbasani	2,796	87
Korça	2,526	79
Republika e Shqipërisë	3,214	100

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT

Rajoni i Pollogut është më i pazhvilluari në të gjithë zonën e programit dhe Dibra mbetet prapa në zonën e Republikës së Shqipërisë. Në të vërtetë, rajoni i Dibrës është më i varfri në aspektin e performancës ekonomike në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Të dyja rajonet janë në kufi me njëri-tjetrin.


Në vitin 2012, GDP-ja e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë u tkurr me 0.2%, ndërsa Republika e Shqipërisë ka shënuar një rritje të ulët prej 0.7%.

Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve

GVA ilustron strukturën e ekonomisë së zonës së programit dhe kjo është e qartë nga të dhënat statistikore që tregojnë se struktura e ekonomisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është i ndryshëm nga struktura e ekonomisë së Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë mbështetet në tregjet me shumicë dhe pakicë që përbëjnë 31% të GVA-së së vendit, por ky sektor është i një rëndësie më të vogël në prefekturat e zonave të programit në Republikën e Shqipërisë. Këto janë rajone kryesisht bujqësore me prodhimin bujqësor të Dibrës dhe Korçës që kontribuojnë në 1/3 e GVA-së në këto rajone. Bujqësia në rajonet e zonës së programit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka kontribut më të vogël në GVA-në rajonale, duke pasur si sektorë kryesorë për gjenerimin e vlerës së shtuar në ekonominë e vendit industrinë dhe shërbime të tjera. Miniera dhe industria e Pellagonisë është faktori më i rëndësishëm që kontribuon në pasurinë e këtij rajoni. Në të vërtetë, vlera e saj e shtuar industriale në shifra absolute pothuajse e barazon vlerën e shtuar bruto industriale të të gjitha rajoneve të tjera në zonën e programit të të dyja vendeve.

Kontributi në GVA nga sektorë të ndryshëm është përshkruar në figurën më poshtë.



Burimi: llogaritje bazuar në Zyrën Shtetërore të Statistikave; INSTAT



Tregtia e jashtme

Të dhënat mbi tregtinë e jashtme ilustrojnë potencialin ekonomik të çdo territori dhe është e qartë se zona e programit karakterizohet nga nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik dhe konkurrencës ndërkombëtare. Në mënyrë të qartë, Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Elbasani në Republikën e Shqipërisë luajnë rolin më të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e ekonomisë në zonën e programit (tabela më poshtë).

Zona e Programit	Aksionet në eksport (%)	Aksionet në import (%)
Pellagonia	6.4	3.9
Pollogu	2.7	2.9
Jugperëndimi	1.9	1.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	100	100
Dibra	1.4	0.1
Elbasani	9.9	7.1
Korça	3.2	2.6
Republika e Shqipërisë	100	100

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Republika e Shqipërisë)

Minierat dhe energjia

Zona kufitare ndërmjet dy vendeve është e pasur me minerale dhe burime natyrore. Ndërsa miniera e qymyrit është më e rëndësishmja për zonën kufitare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në basenet e Kërçovës dhe Pellagonisë, zona kufitare e Republikës së Shqipërisë, përveç qymyrit, shfrytëzon hekurin, bakrin dhe kromin. Brezi ndërmjet Bilishtit dhe Librazhdit ka depozita të konsiderueshme të hekurit dhe nikelit mineral. Prefekturat e Dibrës dhe Elbasanit janë të pasura me krom, me minierën e kromit në Bulqizën Veriore që ka një rëndësi strategjike. Qymyri shfrytëzohet në Korçë, megjithatë depozitat e qymyrit në këtë zonë përbëjnë vetëm rreth 10% të të gjitha depozitave të qymyrit në Republikën e Shqipërisë.

Depozitat e qymyrit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë janë linjit me vlerë relativisht të ulët në kalori dhe me përmbajtje të lartë të lagështirës dhe të hirit nga epokat gjeologjike të Pliocenit dhe të Miocenit.

Minerale të tjera përfshijnë: titan-magnez, talk, granit, mermer, gurë gëlqerorë, dolomitë dhe gurë të tjerë dekorativë karbonatikë.

Rajonet Pollog dhe ai jugperëndimor në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përmbajnë 9 termocentrale hidroelektrike, ndërsa në Pellagoni ndodhet një impiant i energjisë diellore. Zona kufitare e Republikës së Shqipërisë përmban 41 hidrocentrale, kryesisht në lumenjtë Drin dhe Devoll. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit të energjisë elektrike të instaluar ilustron avantazhin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe pse është Republika e Shqipërisë ajo që prodhon energji elektrike të gjelbër në sajë të impianteve të saj hidroelektrike.

Rajonet në zonën e programit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë prodhojnë 60% të energjisë elektrike të përgjithshme në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa rajonet në Republikën e Shqipërisë përbëjnë 47% të kapacitetit të impianteve të energjisë së vendit.


Zona e Programit	Kapaciteti (MW)
Pellagonia	685
Pollogu	190
Jugperëndimi	258
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	1,889
Dibra	39.7
Elbasani	18.9
Korça	32.0
Republika e Shqipërisë	195.8

Burimi: Zyra e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (Republika e Shqipërisë), 2012

Sipërmarrja

Zona e programit karakterizohet nga veprimtari ekonomike nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Megjithatë rëndësia e tyre në ekonominë rajonale është më e ulët sesa në rajonet e tjera të të dyja vendeve. Vetëm 32% e SME-ve të përgjithshme të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe 17% e SME-ve të përgjithshme të Republikës së Shqipërisë ndodhen në zonën e programit, dhe këto vlera konsiderohen shumë të ulëta në raport me numrin e popullsisë në rajonet kufitare.

Pabarazitë rajonale tashmë të theksuara ndikojnë edhe në disproporcionin e intensitetit të SME-ve në secilin rajon të pranueshëm. Nga e gjithë zona e programit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë më të përhapura në Pellagoni në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Korçë në Republikën e Shqipërisë. Siç përshkruhet në grafikun e mëposhtëm, rrethet e tjera përmbajnë një numër më të ulët të SME-ve.



Burimi: Llogaritje bazuar në Zyrën Shtetërore të Statistikave; INSTAT

Ndërsa minierat dhe industritë e lidhura me to në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë në gjendje të tërheqin bizneset e vogla dhe të krijojnë mundësi për zinxhirin e vlerave, industritë e rënda në Republikën e Shqipërisë prodhojnë pak efekt përhapje dhe shumë pak mundësi ekonomike për bizneset e vogla.

Zakonisht, në zonat kufitare bizneset shfrytëzojnë mundësitë e tregtisë ndërkombëtare, por tregtia midis dy vendeve dhe të tretëve është e kufizuar nga pengesat administrative, kryesisht në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa gëzojnë përparësi të lartë krahasuese të kostove të importit dhe eksportit të mallrave, SME-të në Republikën e Shqipërisë operojnë në një nga kuadrot më të pafavorshme administrative në Evropë për ndërkombëtarizimin e biznesit. Aspektet kryesore të këtij problemi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme (në bazë të të dhënave të SBA).

Faktori	Republika e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Kostot e kërkuara për të importuar (USD)	1,380	710
Koha e kërkuar për të importuar (ditë)	11	18
Nr. i dokumenteve të kërkuar për të importuar	6	9
Kostot e kërkuara për të eksportuar (USD)	1,376	725
Koha e kërkuar për të eksportuar (ditë)	12	19
Nr. i dokumenteve të kërkuar për të eksportuar	6	7

Burimi: Të dhënat e SBA, Ndërmarrja DG



Barra administrative dhe konkurrenca e varfër rezultojnë në deficit të konsiderueshëm të tregtisë së jashtme midis dy vendeve, në disfavor të Republikës së Shqipërisë.

Punësimi

Bazuar në gjetjet e LFS, në fillim të vitit 2012 dhe 2013, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë kishin përkatesisht 56.5% dhe 63.2% popullsi në moshë pune (grup-mosha 15-64 vjeç) ekonomikisht aktive, me pabarazi të mëdha nëpër rajonet e të dyja vendeve. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përqindja më e lartë (60.9%) ishte regjistruar në rajonin Juglindor, dhe më e ulëta në rajonin e Pollogut (44.3%). Edhe pse shifrat rajonale nuk janë në dispozicion për Republikën e Shqipërisë, vlerësohet se rajoni i Tiranës regjistron normat më të larta të aktivitetit, në krahasim me pjesën tjetër të vendit. Zonat e kufirit të Republikës së Shqipërisë përmbajnë norma të aktivitetit nën mesataren e vendit.

Shkalla e punësimit prej 44% në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është më e ulët se ajo në Republikën e Shqipërisë (50.1%). Në zonën kufitare CBC Pellagonia ka normën më të lartë (46.9%) ndërsa Pollogu dhe jugperëndimi – përkatesisht 29.3% dhe 32.4%. Rajonet e bashkëpunimit ndërkufitar në Republikën e Shqipërisë kanë norma punësimi më të larta, ku të gjithë e kalojnë mesataren e vendit: Dibra 55%, Elbasani 55.7% dhe Korça 53.8%. Këto norma të larta të punësimit rezultojnë nga niveli minimal i jetesës dhe nga prodhimi bujqësor në shkallë të ulët, i cili siguron një formë të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe të popullsisë rurale dhe shërben si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

Norma e punësimit	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Meshkuj	52.4	56.6
Femra	35.3	43.7

Burimi: LFS nga Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT

Nivelet e punësimit sipas gjinisë, gjithashtu, përshkruajnë pabarazi të mëdha midis dy vendeve. Për Republikën e Shqipërisë, si meshkujt ashtu edhe femrat janë më aktivë në tregun e punës dhe gjejnë më shpesh mundësi për të bërë të ardhura se sa homologët e tyre në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Megjithatë, këto pabarazi rezultojnë kryesisht nga pjesa e lartë e punësimit në sektorin e bujqësisë, ku punojnë 40% e meshkujve dhe 60% e femrave, ekonomikisht aktivë.

Në bazë të sektorëve, pjesën më të madhe të kontributit në krijimin e punësimit në Republikën e Shqipërisë e ka bujqësia (duke përfshirë peshkimin dhe pyjet), e cila punëson rreth 48.7% të popullsisë ekonomikisht aktive, ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kë sektor përbën 17.3% të të gjithë të punësuarve. Prodhimi industrial, industria dhe ndërtimi është punëdhënësi më i madh në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe përbën 29.9% të të gjithë të punësuarve. Në Republikën e Shqipërisë ky sektor kontribuon vetëm në 16% të mundësive për punësim.

Nuk ka të dhëna specifike mbi punësimin sipas sektorëve në nivel rajonal, por vlerësohet se sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në ish-

Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe sektori i bujqësisë në Republikën e Shqipërisë.

Turizmi

Natyra, trashëgimia kulturore dhe historike janë themelet kryesore të zhvillimit të turizmit në zonën kufitare. Potenciali turistik është i rëndësishëm në zonën kufitare, por ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë e ka më të zhvilluar industrinë e turizmit dhe i shfrytëzon mundësitë e zinxhirit të vlerave në shkallë shumë më të madhe se Republika e Shqipërisë. Kjo ilustron nga numri i qëndrimeve me fjetje në qendra akomoduese: ndërsa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka regjistruar më shumë se 2,1 milionë në vitin 2012, Republika e Shqipërisë regjistroi vetëm 0.8 milion qëndrime turistike me fjetje. Turizmi familjar në Republikën e Shqipërisë përbën 55.6%, ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 62.2% të të gjithë industrisë së turizmit. Me më shumë se 26.8 mijë dhoma në qendrat akomoduese, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka kapacitet më të lartë strehimi se sa Republika e Shqipërisë (me vetëm 18.9 mijë dhoma).

Megjithatë, ka dallime strukturale dhe rajonale midis dy vendeve: ndërsa destinacionet turistike



prioritare në Republikën e Shqipërisë janë në bregdetin Adriatik dhe Jon, infrastruktura e turizmit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përqendrohet në rajonin jugperëndimor. Në të vërtetë, trafiku i turizmit në jugperëndim është më i madhi i të gjitha rajoneve të vendit dhe përbën 45.1% të numrit të përgjithshëm të turistëve në vend, me zonat kryesore turistike rreth liqeneve të Ohrit dhe Prespës. Trafiku i turizmit në zonën e programit të Republikës së Shqipërisë është relativisht i parëndësishëm kur krahasohet me zonën ndërkufitare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe pse për shkak të mungesës së të dhënave specifike rajonale mbi këtë temë nuk mund të nxirren konkluzione të mëtejshme.

Ekonomia rurale

Lartësia e tokës në zonën e programit krijon kushte të favorshme për pylltarinë dhe janë pikërisht zona jugperëndimore dhe Pellagonia në

ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të gjitha rajonet CBC në Republikën e Shqipërisë, zonat ku mbulimi i pyjeve është mbi mesataren e të dyja vendeve. Në të vërtetë, Republika e Shqipërisë përmban një ndër pjesët më të vogla të tokës së punueshme në të gjitha tokat bujqësore në Evropë. Lartësia e tokës ndikon negativisht në ekonominë rurale të komuniteteve të zonës kufitare dhe zvogëlon mundësitë bazike ekonomike dhe të të ardhurave që rrjedhin nga shfrytëzimi i tokës.

Megjithatë, ekonomia rurale dhe bujqësia është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë në të dyja vendet, edhe pse Republika e Shqipërisë mbështetet në prodhimin e ushqimit në shkallë shumë më të madhe se sa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Tabela e mëposhtme jep faktet thelbësore të potencialit ekonomik rural lidhur me token bujqësore (shifrat në '000 ha nëse nuk citohet ndryshe).

Shteti / rajoni	Tokë e përgjithshme bujqësore	Tokë e punueshme dhe kopshte	Tokë e punueshme si % e tokës bujqësore	Madhësia mesatare e fermës (ha)
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	1,268	510	40	1.60
Pellagonia	263	112	43	2.90
Pollogu	169	43	25	4.10
Jugperëndimi	136	50	37	3.00
Republika e Shqipërisë	2,875	696	24	1.20
Dibra	249	41	16	0.72
Elbasani	327	73	22	1.26
Korça	371	91	25	1.27

Burimi: INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe llogaritje të bazuara në të dhënat e Bankës Botërore për madhësinë e fermës në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2012

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë toka e punueshme përbën 40% të të gjithë tokës bujqësore, ndërsa në Republikën e Shqipërisë ky raport është 24%. Mesatarisht, në zonën e programit të të dyja vendeve pjesa e tokës së punueshme në raport me madhësinë e përgjithshme të tokës bujqësore është nën mesataren e vendit, duke sjellë kushte të pafavorshme për ekonominë rurale. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë prodhimi bujqësor ka kushte më të favorshme natyrore për kulturat bujqësore dhe prodhimin blegtoral.

Ekonomia rurale e të dyja vendeve është e fragmentuar. Në Republikën e Shqipërisë madhësia mesatare e fermës është 1.2 ha dhe vetëm rajoni i Dibrës është nën mesataren e vendit. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë madhësia mesatare e fermës është 1.6 ha, por zona e programit përmban fermat më të mëdha bujqësore në krahasim me çdo zonë tjetër të vendit.

Prodhimet bimore kryesore në zonën e programit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Prodhimet bujqësore janë radhitur në bazë të prodhimit të përgjithshëm për vendin dhe rajonin.



Shteti / rajoni	Prodhimi kryesor bujqësor
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Gruri, perimet, patatet, misri, tërfili
Pellagonia	Gruri, perimet, patatet, frutat, jonxha, duhani
Pollogu	Misri, patatet, perimet, jonxha, tërfili
Jugperëndimi	Patatet, gruri, misri, jonxha, perimet, frutat
Republika e Shqipërisë	Gruri, misri, perimet, fasulet, patatet, tërshëra
Dibra	Misri, gruri, perimet
Elbasani	Gruri, misri, perimet, tërshëra, fasulet, patatet, bagëtitë, frutat dhe rrushi
Korça	Gruri, misri, perimet, fasulet, elbi

Burimi: përpunimi në bazë të INSTAT-it, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Republika e Shqipërisë) dhe Zyra Shtetërore e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), 2012

Ndërsa zona CBC e Republikës së Shqipërisë është e specializuar në drithëra, perime, fasule dhe prodhimin e tërshërës, ekonomia rurale e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është më e larmishme dhe rajonet janë të specializuara në varietete të kulturave. Rajonet e jugperëndimit dhe Elbasanit janë shembuj ku të ardhurat janë të larta dhe prodhimi është i larmishëm, ndërsa Korça dhe Pollogu kanë të ardhura më të ulëta në prodhimin bujqësor.

Ekonomia rurale në zonën e programit ndikohet negativisht nga erozioni i tokës. Lartësia e tokës, veçanërisht në zonat ku alternohen malet, kodrat dhe luginat me karakterin e rrëmbyeshëm të reshjeve, kontribuon në humbjet e përshpejtuara të tokave. Nuk ka të dhëna specifike rajonale mbi erozionin e tokës, por në nivel kombëtar Republika e Shqipërisë është vlerësuar të ketë një humbje prej më shumë se 16 t/ha në vit, ndërsa për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kjo shifër është vlerësuar të kalojë 18 t/ha.²¹

Infrastruktura e transportit

Të dhënat kryesore mbi infrastrukturën dhe transportin janë përshkruar në tabelën e mëposhtme.

Treguesi	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Hekurudha (km)	696	399
Rrugë në total (km)	13,983	18,000
Lokomotiva	52	53
Transport hekurudhor për mallra ('000 t-km)	478,925	8,333
Makina të pasagjerëve	313,084	300,974
Mjete për transportin e mallrave	27,917	71,278
Autobusë	2,636	6,698

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), INSTAT-i, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Republika e Shqipërisë), 2012

Nuk ka të dhëna që ilustrojnë ndarjen rajonale të infrastrukturës së transportit, por për të dyja vendet rruga e interesit të përbashkët të transportit është Korridori VIII Perëndim-Lindje dhe për zonën kufitare është një seksion i rrugës Elbasan-Kafasan-Shkup. Autostrada Tiranë-Elbasan e përfunduar kohët e fundit është një përmirësim i rëndësishëm në këtë rrugë ndërkombëtare, e cila përmirëson kushtet e sigurisë së transportit rrugor dhe aksesin në të.

Transporti rrugor duket si mënyra më e rëndësishme e transportit, pasi nuk ka asnjë hekurudhë që lidh të dyja vendet – linja Shkup–Kërçovë nuk shtrihet më tej në drejtim të Ohrit dhe në kufi.

Kohezioni social

Ky seksion përshkruan tiparet kryesore të kapacitetit të zonës së programit për të siguruar mirëqenien e popullit të saj duke minimizuar dallimet dhe duke shmangur marginalizimin.

Papunësia

²¹ Burimi: Qendra e Përbashkët Kërkimore, Komisioni Evropian



Sipas metodologjisë LFS, shkalla e papunësisë përfaqëson pabarazi të mëdha ndërmjet dy vendeve kufitare. Në mënyrë të qartë, papunësia është një çështje shumë shqetësuese dhe problematike në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa në Republikën e Shqipërisë pjesa më e madhe e fuqisë punëtore thithet nga ekonomia e fragmentuar rurale.

Zona e Programit	Papunësia (%)
Pellagonia	25.3
Pollogu	34.2
Jugperëndimi	42.3
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	31.0
Dibra	8.7
Elbasani	6.0
Korça	10.4
Republika e Shqipërisë	13.4

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, LFS 2012

Të ardhurat

Pagesa mesatare neto për të punësuarit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë arrin në 335 € dhe në Republikën e Shqipërisë deri në 356 €. Pra, njerëzit në Republikën e Shqipërisë fitojnë 7% më shumë se sa ata që jetojnë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Pagat neto ndryshojnë në rajone të ndryshme në të dyja vendet, por në zonat përfituese të programit nuk ka pabarazi të konsiderueshme në nivelin e të ardhurave neto.

Zona e Programit	Paga neto, për vend=100
Pellagonia	91.7
Pollogu	95.6
Jugperëndimi	90.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	100
Dibra	97.0
Elbasani	95.7
Korça	100.3
Republika e Shqipërisë	100

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, llogaritje në bazë të të dhënave të INSTAT-it

Teknologjia e informacionit

Zona e programit karakterizohet nga pabarazi të larta në aksesin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit, e cila është një nga forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik bashkëkohor. Pabarazitë lidhen me diferencat ndërmjet dy vendeve dhe midis rajoneve të pranueshme të Republikës së Shqipërisë.

Zona e Programit	Përdorimi i Kompjuterave	Përdorimi i internetit
Pellagonia	61.0	55.0
Pollogu	64.0	64.0
Jugperëndimi	64.0	57.0
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	64.0	58.0
Dibra	15.5	6.5
Elbasani	16.8	8.3
Korça	14.5	11.0
Republika e Shqipërisë	20.2	14.1

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, LSMS 2012

Të dhënat e mësipërme ilustrojnë një ndarje digjitale ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë, ku familjet dhe bizneset shqiptare janë padysim të

ekspozuara ndaj përjashtimit digjital. Kjo dukuri përbën një shqetësim kritik, pasi nuk rezulton nga paaftësia apo mosha e njerëzve. Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë normat krahasimore janë të larta, por prapë mbeten më të ulëta se në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, me afërsisht 30% nën mesataren.

Arsimi

Në të dyja vendet shkalla e arsimit është konsideruar e lartë: 96% për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 97% për Republikën e Shqipërisë. Nuk ka devijime të mëdha rajonale nga mesatarja kombëtare apo pabarazi ndërmjet rajoneve që përbëjnë zonën e programit.

Edukimi dhe shkollimi

Shkollimi dhe arsimimi janë strukturat dhe instrumentet qendrore për të zhvilluar dhe për të formësuar kapitalin njerëzor, i cili ka një rol themelor në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme të bazuar në dije, konkurrencës, kohezionit social dhe qëndrueshmërisë.

Ndërsa aksesimi në arsimin fillor është relativisht i ekuilibruar dhe shkollat nuk janë të mbipopulluara, arsimi i mesëm është disi më i sforcuar, veçanërisht në Republikën e Shqipërisë, me qarkun e Dibrës të ekspozuar kryesisht ndaj infrastrukturës së pamjaftueshme të shkollave. Në këtë rajon, numri mesatar i nxënësve për mësues është dukshëm më i lartë se mesatarja për vendin (shih tabelën më poshtë).

Zona e programit	Nr. i nxënësve për mësues (arsimi fillor)	Nr. i nxënësve për mësues (arsimi i mesëm)	Nr. i studentëve të diplomuar në 1,000 banorë
Pellagonia	11	14	118
Pollogu	12	13	71
Jugperëndimi	10	13	92
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	12	13	103
Dibra	15	21	39
Elbasani	14	16	63
Korça	13	15	77
Republika e Shqipërisë	16	16	94

Burimi: llogaritja e bazuar në të dhënat e papërpunuara nga Zyra Shtetërore e Statistikave dhe INSTAT-i, 2011

Shekulli XXI karakterizohet nga emigrimi i personave me arsim të lartë, e cila është një dukuri e përhapur me rritjen e rolit të qyteteve dhe qendrave urbane, duke thelluar ndarjen urbane-rurale. Ky fenomen ndikon seriozisht në zonën e programit, me përjashtim të rajonit të Pellagonisë. Në vendet e tjera problemi është i përhapur (më shumë në Republikën e Shqipërisë), me kulmin negativ në Dibër, ku përqindja e njerëzve me arsim universitar është më e ulëta në mbarë territorin e programit CBC.

Furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbetjeve

Në zonën e programit, rreth 97% e familjeve nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë të lidhura me sistemet individuale ose publike të furnizimit me ujë dhe 95% - me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Përkatësisht, në Republikën e Shqipërisë, këto shifra janë: 95% dhe 87%.

Nuk ka statistika mbi vëllimin e trajtimit të ujërave të zeza, por vlerësohet se të paktën deri në 10% të mbetjeve të lëngshme trajtohen. Përveç shfrytëzimit të pakontrolluar të plehrave kimike në bujqësi, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza është arsyeja kryesore për eutrofikimin e përsheptuar të pjesës më të madhe të ekosistemeve ujore në zonën e programit (liqene dhe lumenj).

Për sa u përket mbetjeve të ngurta, 70% e mbetjeve të gjeneruara në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është mbledhur, por për Republikën e Shqipërisë kjo pjesë është vlerësuar në nivele të konsiderueshme më të ulëta.

Tabela e mëposhtme përshkruan statistikat mbi mbetjet e ngurta të grumbulluara në zonën e programit.



Zona e programit	Ton ('000)	Ndarja (%), për vend=100
Pellagonia	72	13.0
Pollogu	59	10.6
Jugperëndimi	49	8.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	555	100
Dibra	33.1	2.9
Elbasani	81.1	7.1
Korça	62.1	5.4
Republika e Shqipërisë	1,137	100

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Ministria e Mjedisit (Republika e Shqipërisë), 2012

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kapaciteti i vendgrumbullimeve të mbetjeve të ngurta është i shpërndarë në mënyrë të arsyeshme nëpër rajone dhe korrespondon në mënyrë të kënaqshme me vëllimin e mbetjeve të gjeneruara. Ndërsa për Republikën e Shqipërisë nuk disponohen të dhëna lidhur me këtë aspekt.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta është një çështje shqetësuese për shkak të raportit të ulët të mbetjeve të krijuara dhe atyre të mbledhura. Përveç kësaj, ndarja gjatë depozitimit të mbetjeve është pothuajse joekzistuese, e cila rrit koston e menaxhimit të mbetjeve dhe ndikon në mjedis.

Infrastruktura e kujdesit shëndetësor

Infrastruktura e kujdesit shëndetësor përmban pabarazi domethënëse përgjatë kufirit. Mesatarisht, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ofron mundësi më të mira të trajtimit të specializuar mjekësor dhe Pellagonia ka infrastrukturën më konkurruese të kujdesit shëndetësor në të gjithë zonën e programit. Edhe pse territori CBC në anën e Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë më shumë shtretër në spitale se mesatarja për të gjithë vendin, Shqipëria ka hyrë në marrëveshje strategjike me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, sipas së cilës qytetarët e Republikës së Shqipërisë me sëmundje kronike mund të përdorin spitalet dhe klinikat në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për një trajtim më të specializuar. Kjo ndodh për shkak të pranisë së kufizuar të pajisjeve moderne apo aksesit të vështirë fizik të infrastrukturës shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, kryesisht në zonat më të largëta.

Zona e programit	Nr. i spitaleve	Nr. i shtretërve të spitaleve	Nr. i shtretërve të spitaleve për 1,000 banorë
Pellagonia	3	1,419	6,1
Pollogu	7	646	2
Jugperëndimi	5	815	2
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	73	9,076	4,4
Dibra	3	508	3,7
Elbasani	6	1,020	3,4
Korça	4	752	3,4
Republika e Shqipërisë	44	8,410	3

Burimi: Ministria e Shëndetësisë (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Shqipërisë)

Analiza SWOT

Kjo analizë SWOT ndjek logjikën e prioriteteve tematike të asistencës IPA II dhe përshkruan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet duke marrë parasysh karakterin apo efektin e tyre strategjik (cilësia e nevojës ose e mundësisë). Kjo analizë SWOT mbulon vetëm ato tema që janë konsideruar për përfshirjen në ndërhyrjen strategjike dhe shton analizën e grupit të problemeve të përshkruar në seksionin 2.2 të dokumentit të programit.²²

SWOT-i është hartuar në bazë të pyetësorëve individualë të plotësuar nga palët e interesuara të programit, reagimet nga strategjitë ekzistuese të zhvillimit rajonal në rajonet e NUTS-3 në zonën kufitare, dhe konkluzionet e ekspertëve mbi profilin social-ekonomik të rajonit.

Analiza më poshtë ndjek rendin sipas rëndësisë së prioriteteve tematike të zgjedhura për Programin IPA II CBC 2014–2020.

Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore (TP4)

Aktualisht, niveli i pabarabartë i zhvillimit të infrastrukturës turistike në rajonin ndërkufitar e bën rajonin e përgjithshëm jotërheqës për një ofertë gjithëpërfshirëse turistike, veçanërisht në anën e Republikës së Shqipërisë. Kështu, format alternative të turizmit mund të përdoren si bazë për ndërtimin e një imazhi të zonës së programit si një destinacion tërheqës turistik.

Trashëgimia e pasur kulturore nuk është e ruajtur dhe paraqitur mirë. Kështu, iniciativat për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet njerëzve dhe institucioneve nga rajoni CBC duhet të intensifikohen në të ardhmen.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Efekt) Ofertë e pasur turistike bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore, trashëgiminë kulturore, monumentet fetare, ujërat termale, sportin dhe argëtimin	(Dobësi strategjike) Nuk ka nivel të balancuar të infrastrukturës së turizmit (akomodim, sporte, terrene) dhe mungesa e strategjisë për ofertë të qëndrueshme turistike të rajonit CBC
(Pikë e fortë strategjike) Eksperienca në pritjen e mysafirëve vendas dhe ndërkombëtarë	(Efekt) Mungesa e njohjes ndërkombëtare të të gjithë rajonit CBC si destinacion atraktiv turistik
(Pikë e fortë strategjike) Një pjesë e territorit CBC rrit njohjen e tij si destinacion turistik i rëndësishëm për turizmin familjar	(Efekt) Mirëmbajtja e papërshtatshme e monumenteve historike dhe kulturore
Mundësitë	Kërcënimet
(Efekt) Ofertë turistike e integruar, e bazuar në kulturë, sport, kohë të lirë, aventurë, turizmin spa (të llixhave)	(Efekt) Mungesa e strategjisë së integruar të zhvillimit të turizmit dhe masave të përkushtuara për rajonin CBC
(Mundësi strategjike) Shkëmbim më efikas dhe i integruar i përvojave ndërmjet dy vendeve dhe operatorëve	(Kërcënim strategjik) Investime të pabalancuara në infrastrukturën e turizmit
(Mundësi strategjike) Plani i përbashkët për hartëzimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore dhe historike	(Efekt) Imazhi i papërshtatshëm i rajonit CBC
(Mundësi strategjike) Aktivitete të përbashkëta kulturore	

Konkurrenca, biznesi, tregtia dhe investimet (TP7)

SME-të, sipërmarrja dhe ekonomia rurale paraqiten si një nga forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik në zonën e programit. Ato janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të politikës dhe të tregut, kryesisht për shkak të konkurrencës së kufizuar dhe orientimit të tregut të tyre. Kështu, industritë e lehta, sektorët e qëndrueshëm të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit janë konsideruar si një potencial për rritje më të qëndrueshme ekonomike të rajonit CBC në tërësi.

²² Në korrik 2013 strukturat operacionale arritën në përfundimin se lista e TP-ve duhet të ngushtohet para hyrjes në fazën e konsultimeve më të gjera të programimit për shkak të burimeve të kufizuara financiare të programit. Më pas, TP-të janë renditur sipas rëndësisë së tyre dhe janë përfshirë në ndërhyrjen për vitet 2014–2020.



Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Pikë e fortë strategjike) Baza ekzistuese e SME-ve në rajonin e përgjithshëm me aktivitete të shumëllojshme	(Dobësi strategjike) SME-të janë të karakterit mikro dhe jashtëzakonisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve politike, fiskale apo të tregut
(Pikë e fortë strategjike) Prodhimi i larmishëm bujqësor dhe ekonomia rurale në të gjithë rajonin	(Dobësi strategjike) Mungesa e specializimit, vlerës së shtuar, hulumtimit dhe orientimit të plotë të tregut
(Efekt) Bizneset e mesme të qëndrueshme dhe konkurruese, veçanërisht në rajonet e Pollogut, Elbasanit dhe Pellagonisë	(Efekt) Konkurrenca e kufizuar e produkteve në nivel rajonal dhe kombëtar, nivelet e ulëta të GVA
	(Dobësi strategjike) Bujqësia e karakterizuar nga fragmentim i madh, produktivitet i kufizuar dhe mungesë e orientimit në treg
	(Dobësi strategjike) Burimet natyrore në dispozicion të bujqësisë konkurruese dhe praktikave të prodhimit të ushqimit, të pashfrytëzuara
	(Kërcënim strategjik) Ofertë e kufizuar e produkteve gjysmë-të gatshme me sasi të qëndrueshme
Mundësitë	Kërcënimet
(Efekt) Zhvillimi ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të disponueshme natyrore dhe zinxhirët e vlerave	(Efekt) Mospërputhje të mëdha në nivelin e zhvillimit dhe aktivitetet ekonomike midis rajoneve të ndryshme në zonën e bashkëpunimit ndërkufitar
(Mundësi strategjike) Specializimi i SME-ve dhe fuqizimi i tyre përmes shtimit të vlerës së produkteve të tyre	(Efekt) Aktivitete të pamjaftueshme të eksportit
(Mundësi strategjike) Identifikimi i produkteve që mund të njihen në nivel ndërkombëtar	(Efekt) Mikrosipërmarrjet jorezistuese ndaj ndryshimeve të tregut
(Mundësi strategjike) Prodhimi bujqësor dhe përpunimi i ushqimit organik ose të paktën i qëndrueshëm organik	(Kërcënim strategjik) Prodhimi bujqësor i gjerë me tërheqje të kufizuar të tregut
(Mundësi strategjike) Bashkëpunim dhe tregti më të zhvilluara midis shoqërive në rajonin e Bashkëpunimit Ndërkufitar	(Kërcënim strategjik) Erozioni i lartë i tokës për shkak të lartësisë së tokës
(Mundësi strategjike) Zhvillimi i infrastrukturës së biznesit dhe rrjeteve të biznesit (inkubatorët, qendrat mbështetëse të biznesit, shoqatat etj.)	

Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)

Pavarësisht minierave intensive në territorin e kufizuar, rajoni i bashkëpunimit ndërkufitar është perceptuar si “zonë e gjelbër” e përshtatshme për zhvillimin ekonomik të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për shkak të pyjeve të bollshme, lumenjve dhe liqeneve. Megjithatë, rajoni nuk ka asnjë sistem për monitorimin e mjedisit apo për parandalimin e rrezikut. Për më tepër, mungesa e infrastrukturës mjedisore minimale të kërkuar (trajtimi i mbetjeve ujore, grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta etj.) mund të çojë në ndotjen e mëtejshme të pakontrolluar në rajon dhe në rënien e tërheqjes nga aktivitetet e biznesit të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Pikë e fortë strategjike) Prania e burimeve të shumëllojshme natyrore (uji, pyjet, flora dhe fauna, klima)	(Dobësi strategjike) Mungesa e planeve për mbrojtjen e mjedisit, monitorimin dhe sistemet e parandalimit të rrezikut për çdo lloj të ndotjes në rajon dhe parandalimin e erozionit të tokës
(Efekt) “Zonë e pastër”, pa ndotje të mëdha industriale	(Dobësi strategjike) Mungesa e kontrollit të shfrytëzimit të burimeve natyrore (minierat, pyjet)
(Pikë e fortë strategjike) Prania e zonave të ndryshme klimatike (malore, kontinentale dhe mesdhetare) mundëson prodhimin më të specializuar të bujqësisë dhe zhvillimin e turizmit alternativ	(Efekt) Ndërgjegjësimi i ulët i popullsisë për mbrojtjen e mjedisit



Mundësitë	Kërcënimet
(Efekt) Zhvillimi i strategjisë së përbashkët për mbrojtjen e mjedisit të rajonit CBC, monitorimin, njohjen e hershme dhe parandalimit e rrezikut	(Efekt) Rajonet e vogla me një kërcënim për ndotje që mund të rrezikojë zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekonomike / turistike
(Mundësi strategjike) Zhvillimi i programeve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve	(Kërcënim strategjik) Mungesa e stimuljeve dhe investimeve në mbrojtjen e mjedisit dhe / ose teknologjive më miqësore
(Mundësi strategjike) Hartimi dhe zhvillimi i projekteve, studimeve të fizibilitetit për mbrojtjen e ujërave ndërkombëtare dhe ujërave nëntokësore	(Kërcënim strategjik) Ujërat ndërkombëtare me rrezik të lartë të ndotjes

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME

PJESA E PARË: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

Neni 2 – Përfutjesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

Neni 3 – Kërkesat e raportimit

Neni 4 – Vizibiliteti dhe komunikimi

Neni 5 – Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 6 – Pranueshmëria e shpenzimeve

PJESA E DYTË: DISPOZITAT E ZBATUESHME TË MENAXHIMIT TË TËRTHORTË NGA PËRFITUESI I IPA II

Neni 7 – Parime të përgjithshme

Neni 8 – Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

Neni 8a – Detyrimet për informim, sanksionet administrative dhe mosveprimi

Neni 9 – Kontrollat paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollat paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni

Neni 10 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura

Neni 11 – Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfutjesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

Neni 12 – Ndërprerja e pagesave

Neni 13 – Mbulimi i fondeve

PJESA E TRETË: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14 – Konsultimi mes përfutjesve të IPA II dhe Komisionit

Neni 15 – Amendimi i kësaj marrëveshjeje financimi

Neni 16 – Pezullimi i kësaj marrëveshjeje të financimit

Neni 17 – Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare

Neni 18 – Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës Marrëveshja e Financimit është zbatuar dhe përfshin periudhën operative të zbatimit, si dhe një fazë të mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit është përcaktuar në nenin 2(1) të kushteve të veçanta, dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha në të cilën kanë përfunduar të gjitha aktivitetet operative të mbuluara nga prokurimi dhe kontratat e grantit të Programit të Veprimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2(2) për kushtet e veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

3. Periudha operationale e zbatimit dhe ekzekutimit duhet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues në përmbyllje dhe zbatim të prokurimit dhe kontratave të granteve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare.

4. Kostot që lidhen me operacionet e Programit të Veprimit do të jenë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operativ.

5. Kontratat e grantit dhe të prokurimit do të përfundojnë e shumta brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare, përveç:

a) në ndryshimet në kontratat tashmë të lidhura;



b) kur kontratat individuale të prokurimit përfundojnë pas një ndërprerjeje të parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të jenë të nënshkruara pas zbatimit operacional;

d) kur ndryshimi i entitetit është i ngarkuar me detyra të besuara.

6. Kur një kontratë granti ose prokurimi, nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda dy viteve të nënshkrimit të saj, do të ndërpritet automatikisht dhe fondet e saj do të bllokohen.

Neni 2

Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76(3) të kuadrit të marrëveshjeve përkatëse, përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë ngushtë dhe duhet të përmbushin bashkërisht në veçanti funksionet e mëposhtme dhe të marrin përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar në përputhje me nenin 68 të marrëveshjeve kuadër përkatëse ose rishikimet e tyre;

b) sigurojnë pjesëmarrjen në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM), mbledhje dhe takime të tjera dypalëshe;

c) emërojnë përfaqësuesin e tyre në KPM;

d) krijojnë Sekretariatën e Përbashkët Teknik (SPT) dhe sigurojnë që ka personel të mjaftueshëm;

e) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike të KPM-së;

f) mbështesin punën e KPM-së dhe sigurojnë informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, në veçanti të dhënat që lidhen me ecurinë e programit operativ në arritjen e objektivave specifike dhe synimeve për prioritet tematike, si ngritja e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

g) krijojnë një sistem për të mbledhur informacion të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

h) hartojnë raportet vjetore dhe finale të zbatimit siç janë përmendur në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në përputhje me nenin 3;

i) të përgatisin dhe të zbatojnë një plan koherent për komunikim dhe vizibilitet;

j) të hartojnë një plan vjetor të punës për Sekretariatën e Përbashkët Teknik, të miratuar nga KPM-ja.

Neni 3

Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenin 80(1) të marrëveshjeve përkatëse Kuadër, strukturat operuese do të përdorin modelin e parashikuar në shtojcën III të kësaj marrëveshjeje financimi.

2. Për qëllim të kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuar në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit nën menaxhimin e tërthortë, të përcaktuar në nenin 59(1) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në raportin vjetor për zbatimin e ndihmës IPA II, NIPAC do të përdorë modelin e dhënë në shtojcën IIIA të kësaj marrëveshjeje financimi.

3. Për qëllim të kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në pikën “a” të nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër mbi raportin vjetor financiar apo deklaratat, NAO si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të përdorë modelin e parashikuar në Shtojcën IV të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Për qëllim të nenit 59(4) të Marrëveshjes Kuadër, NIPAC (KKIPA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i paraqesë Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e ndihmës së IPA II të Programit të Veprimit, jo më vonë se katër muaj pas disbursimit (pagesës) të fundit për kontraktuesit e saj ose përfituesit e granteve.

5. Për qëllim të nenit 59(6) të Marrëveshjes Kuadër NOA (ZKA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të sigurojë deri më datë 15 janar të vitit financiar vijues, në format elektronik, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit, themeluar sipas nenit 10(5). Kjo duhet të mbështetet nga një raport i nënshkruar i paaudituar përmbledhës financiar, në përputhje me pikën “c” të shtojcës IV.

Neni 4

Vizibiliteti dhe komunikimi

1. Siç parashikohet në dispozitat e nenit 24(1), 76(3)(k), dhe nenit 78(8)(f) të Marrëveshjes Kuadër



përkatëse, përfituesit e IPA II duhet të përgatisin një plan koherent të aktiviteteve të vizibilitetit dhe të komunikimit, të cilat do t'i paraqiten Komisionit për një marrëveshje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete të vizibilitetit dhe komunikimit duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimeve dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara sipas kësaj marrëveshjeje financiare duhet të garantojnë që përfituesit e IPA II të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti kontraktues, do të garantojë që Komisioni, ose dikush apo personi i autorizuar nga Komisioni, dhe përfituesit e të tjerë të IPA II, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do ta përdorë një material të tillë vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6

Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj marrëveshjeje financiare:

- a) borxhet dhe pagesat e shërbimit të borxhit (interesi);
- b) dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- c) Kostoja e deklaruar nga përfituesi dhe financiar nga një veprim apo program pune, që merr një grant nga Unioni;
- d) humbjet e këmbimit të monedhës;
- e) kreditë për palët e treta;
- f) gjokat, sanksionet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor.

2. Blerja e tokës që nuk është e ndërtuar dhe e tokës me ndërtim në shumën deri në 10% të totalit të shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë,

do të jetë e pranueshme për financim sipas ndihmës për bashkëpunim ndërkuftar IPA II, nëse ajo është e justifikuar nga natyra e veprimit dhe të dhënat në shtojcën I.

PJESA E DYTË

DISPOZITAT E ZBATUESHME TË MENAXHIMIT TË TËRTHORTË NGA PËRFITUESI IPA II

Neni 7

Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është të vendosë rregullat për zbatimin e Programit të Veprimit nën menaxhimin të tërthortë dhe në veçanti rregullat që lidhen me detyrat që i janë besuar zbatimit të buxhetit, siç përshkruhet në shtojcën I dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni në kryerjen e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në pikën “b” të nenit 76(3) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II, bashkërisht, duhet të përgatisin një marrëveshje dypalëshe dhe të sigurojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoritet Kontraktues do të bashkëpunojë me përfituesin e IPA II që është Autoritet Kontraktues, për të siguruar se detyrat në vijim janë plotësuar:

- a) të kryejnë ndjekjen operative dhe menaxhimin e operacioneve, siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76(4) të Marrëveshjes Kuadër;
- b) të kryejnë verifikime në përputhje me nenin 76(5) të Marrëveshjes Kuadër;
- c) të mbrojnë interesin financiar të Unionit, siç parashikohet në nenin 51 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8

Procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit

1. Detyrat e përmendura në nenin 7 (3) do të kryhen nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe grantit. Në veprimet e jashtme, në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara të shikimit dhe komunikimit të referuara në Nenin 4 (2).



2. Në përputhje me nenin 18 (2) të Marrëveshjes Kornizë, Komisioni do t'i sigurojë përfituesit të IPA II, që është Autoriteti Kontraktues, udhëzime të mëtejshme në lidhje me përshtatjen e procedurave dhe dokumenteve standarde të përcaktuara dhe botuara nga Komisioni për dhënia e kontratave të prokurimit dhe grantit në veprimet e jashtme për rastin specifik të bashkëpunimit ndërkufitar.

3. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të kryejë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, do të lidhë kontratat që rezultojnë dhe të sigurojë që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmët e auditimit janë në gjuhën e kësaj Marrëveshje Financimi. Për qëllimet e pjesës së dytë të kësaj marrëveshjeje financimi, çdo referencë për kontratat e granteve do të përfshijë gjithashtu marrëveshje kontributi dhe çdo referencë për përfituesit e granteve do të përfshijë gjithashtu organizata që kanë nënshkruar marrëveshje kontributi.

4. Përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë plotësisht në krijimin e komiteve vlerësuese siç parashikohet në pikën (a) të nenit 76 (4) të marrëveshjeje kornizë përkatëse.

5. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të mbajë të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale mbështetëse nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje Financimi, ose që nga një datë e hershme në rast se procedura e prokurimit, bën thirrje për propozime ose procedura e dhënies së grantit të drejtpërdrejtë ishte nisur para hyrjes në fuqi të këtij Marrëveshje Financimi:

(a) Për procedurat e prokurimit në veçanti:

a) Njoftimi i parashikimit me dëshmi të publikimit të njoftimit të prokurimit dhe çdo korigjim;

b) Emërimi i panelit të listës së ngushtë;

c) Raporti i listës së ngushtë (përfshirë anekset dhe aplikacionet;

d) Dëshminë e publikimit të njoftimit për listën e ngushtë;

e) Letra për kandidatët jo të përzgjedhur;

f) Ftesë për tender ose ekuivalent;

g) Dosja e tenderit duke përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e takimeve, dëshminë e publikimit;

h) emërimi i komisionit vlerësues;

i) raporti i hapjes së tenderit, përfshirë anekset;

j) raporti i vlerësimit / negocimit, përfshirë anekset dhe ofertat e marra;²³

k) letër njoftimi;

l) letër motivuese për dorëzimin e kontratës;

m) letra për kandidatët e pasuksesshëm;

n) njoftimi për dhënie / anulim, përfshirë provën e botimit;

o) kontratat e nënshkruara, ndryshimet, riders, raportet e zbatimit, dhe korrespondencën përkatëse.

(b) Për thirrjet për propozime dhe dhënien e drejtpërdrejtë të granteve në veçanti:

a) emërimi i komisionit vlerësues;

b) raporti i hapjes dhe administrative duke përfshirë anekset dhe aplikacionet e marra;²⁴

c) letra për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm pas vlerësimit të konceptit;

d) raporti i vlerësimit të konceptit;

e) raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë ose raporti i negociatave me anekset përkatëse;

f) kontrolli i kualifikimit dhe dokumentet mbështetëse;

g) letra për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm me listë rezervë të miratuar pas vlerësimit të plotë të aplikimit;

h) letër motivuese për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) njoftim për dhënie / anulim me dëshmi të publikimit;

j) kontratat e nënshkruara, ndryshimet, riders dhe korrespondencën përkatëse.

Përveç kësaj, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 5 (a) dhe (b) të këtij neni do të jenë plotësohet nga të gjitha dokumentet përkatëse mbështetëse siç kërkohet nga procedurat e përmendura në seksionin 1 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimet dhe kostot e funksionimit, për shembull raportet e kontrolleve të projektit dhe në vend, pranimin e furnizimeve dhe punëve, garancitë, autorizimet, raportet e inxhinierëve mbikëqyrës.

Të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale do të ruhen për të njëjtën kohëzgjatje në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kornizë.

²³ Eliminimi i ofertave të pasuksesshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

²⁴ Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit.



Neni 8a

Detyrimet për informim, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Kur zbatohen procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve, përfituesi i IPA II do të sigurojë që asnjë kontratë e financuar nga BE-ja e prokurimit ose e grantit të mos i jepet një operatori ekonomik ose një aplikuesi të grantit. nëse operatori ekonomik ose aplikuesi i grantit i cili ose vetë, ose një person që ka kompetenca përfaqësimi, vendimmarrje ose kontroll mbi të është në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi i IPA II, që është Autoriteti Kontraktues, do të informojë Komisionin menjëherë kur një kandidat, tenderues ose aplikant është në një situatë të përjashtimit nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, ka kryer parregullsi dhe mashtrim, ose është gjetur në shkelje serioze e detyrimeve të saj kontraktuale.

3. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të marrë parasysh informacionin që përmbahet në 'Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përjashtimit' të Komisionit (EDES) gjatë dhënies së kontratave të prokurimit dhe grantit. Aksesit në informacion mund të sigurohet përmes pikave (eve) të ndërlidhjes ose përmes konsultimit duke përdorur mjetet e mëposhtme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Zyrtari i Kontabilitetit të Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikën dhe me e-mail në BUDG-COL-EXCL-DB@ec.europa.eu në kopje në adresën e Komisionit të përmendur në nenin 3 të kushteve të veçanta).

4. Kur përfituesi i IPA II, që është Autoriteti Kontraktues, bëhet i vetëdijshëm për një situatë përjashtimi në zbatimin e detyrave të përshkruara në Shtojcën I, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do t'i imponojë një operatori ekonomik ose një aplikant për grante një përjashtimi nga procedurat e tij të ardhshme të prokurimit ose dhënies së grantit. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues gjithashtu mund të vendosë një gjobë financiare proporcionale me vlerën e kontratës në fjalë.

Përjashtimet dhe / ose ndëshkimet financiare do të vendosen pas një procedure kundërshtare që

siguron të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Komisionin në përputhje me paragrafin I të këtij neni.

5. Në lidhje me paragrafin 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues kryen një dështim për të vepruar, nëse nuk vendos përjashtim dhe / ose një gjobë financiare për operatorin ekonomik ose aplikantin e grantit.

6. Në rast të dështimit për të vepruar, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Komisionin duke shpjeguar arsyet e dështimit të tij për të vepruar. Komisioni rezervon të drejtën të përjashtojë një operator ekonomik ose një aplikant për grante nga procedurat e ardhshme të financimit të BE-së, dhe / ose të vendosë një gjobë financiare për operatorin ekonomik ose aplikantin e grantit ndërmjet 2% dhe 10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

Neni 9

Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle paraprake (*ex ante*) për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat e mëposhtme të prokurimit ose dhënies së granteve:

a) për miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tij;

b) për miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;

c) për miratimin e përbërjes së komisioneve të vlerësimit;

d) për miratimin e raporteve të vlerësimit dhe vendimet e dhënies së kontratës²⁵;

e) për miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtesa e kontratës.

2. Në lidhje me kontrollin paraprak, komisioni duhet të vendosë:

a) të kryejë kontrolle paraprake për të gjitha dosjet, ose

²⁵ Për kontratat e shërbimit këto hapa që përfshijnë kontrollet paraprake, lidhen me miratimin e listës së përzgjedhur.



b) të kryejë kontrolle paraprake në një përzgjedhje e këtyre dosjeve, ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet paraprake.

3. Nëse Komisioni vendos për të kryer kontrolle paraprake në përputhje me paragrafin 2, shkronjat (a) ose (b) të këtij neni, ai duhet të informojë përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues i dosjeve të përzgjedhura për kontrollet paraprake. Ky përfitues i IPA II do të japë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll paraprak së fundi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë për të kryer kontrolle të mëpasshme (ex-post), duke përfshirë auditimet dhe kontrollet e çastit, në çdo kohë, për ndonjë kontratë ose grantet e dhëna nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, që rrjedh nga kjo marrëveshje financimi. Ky përfitues i IPA II do të të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin pasi të informohet se kjo dosje është përzgjedhur për kontroll të mëpasshëm (ex post). Komisioni mund të autorizojë një person ose njësi ekonomike për të kryer kontrolle ex post në emër të saj.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostoja e njohur

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operative e përfituesit të IPA II, që është Autoriteti Kontraktues për Programin e Veprimit, duhet të hapë të paktën një llogari bankare në euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit do të jetë shuma e balanceve në të gjitha llogaritë bankare të Programit të Veprimit, të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat pjesëmarrëse që operojnë të përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

2. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përgatisë dhe të dorëzojë në Komisionin planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit. Këto parashikime duhet të përditësohet për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 3 (2) dhe për çdo kërkesë për

fonde. Parashikimet do të bazohen në një analizë të dokumentuar dhe të detajuar (duke përfshirë edhe kontraktimin e planifikuar dhe orarin e pagesave sipas kontratës për dymbëdhjetë muajt në vijim), të cilat do të jenë në dispozicion të Komisionit në bazë të kërkesës.

3. Planin fillestar i parashikimit të disbursimit duhet të përmbajë përmbledhjen e parashikimit vjetorë të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të Programit të Veprimit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhjen vjetore të parashikimeve të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit dhe parashikimet mujore disbursimit për katërmëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të kontabilitetit në përputhje me pikën 2 (3) (b) të shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër, i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat që menaxhohen nën Programin e Veprimit të përcaktuar në Shtojcën V.

5. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit e mbajtur nën seksionin 4 të këtij neni, duhet të jetë e bërë, e paguar dhe e pranuar dhe të korrespondojë me kostot aktuale të provuara nga dokumentet mbështetëse dhe të përdoret kur është e përshtatshme për të nisur parafinancimin e paguar nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues sipas kontratave lokale.

6. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit do të shfrytëzohet nga Komisioni për njohjen e të përkohshme të kostos së saj, gjatë zbatimit të Programit të Veprimit (duke përfshirë autorizimin e parafinancimit që i paguhet përfituesit të IPA II, që është Autoriteti Kontraktues), për procesin e miratimit për pagesat, për autorizimin përfundimtar të procedurës së llogarive në fund të Programit të Veprimit, për praktikën vjetore të ndërprera dhe çdo zbatim tjetër të menaxhimit dhe të shqyrtimeve të performancës.

7. Përfituesi i IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

a) Raporti Përmbledhës - siç është përcaktuar në nenin 3 (5);

b) Raportet vjetore siç janë përcaktuar në paragrafët (2) deri (4) të nenit 3;

c) Kërkesa për raportet e fondeve, siç përmenden në nenin 11.



Neni 11

Dispozita për pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

1. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të paraqesë parashikimin e tij fillestarë të disbursimit (pagesës) për Programin e Veprimit, të përgatitur në përputhje me nenin 10 (2), me kërkesën e parë për pagesë të paraфинансuar. Pagesa e parë e paraфинансimit do të bëhet për 100% të pagesës së parashikuar për vitin e parë të planit të parashikuar për disbursim.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të paraqesë kërkesa të vazhdueshme të pagesës së paraфинансimit kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit bie nën pagesën e parashikuar për pesë muajt në vazhdim të Programit të Veprimit.

3. Çdo kërkesë për paraфинансim shtesë do të mbështetet nga raportet e mëposhtme, në përputhje me pikat (a), (b) dhe (d) të shtojcës IV:

a) Një deklaratë përmblledhëse e të gjitha pagesave të bëra për Programin e Veprimit;

b) Balancat bankare për Programin e Veprimit në datën e caktuar të kërkesës;

c) Një parashikim i pagesave për Programin e Veprimit për katërmbëdhjetë muajt në vijim në datën e përcaktuar të kërkesës.

4. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë për çdo paraфинансim pasues shumë të totalit të disbursimeve të parashikimit për katërmbëdhjetë muaj, pas datës së përcaktuar të kërkesës, pa balancat e referuara në nenin 3 (b) të këtij neni në datën e përcaktuar të kërkesës për fondet e rritura nga ndonjë shumë e financuar nga përfituesi IPA II, sipas paragrafit 5 të këtij neni, dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni gëzon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë pasuese të paraфинансimit, nëse tepërcat totale bankare të mbajtura nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues në bazë të këtij programi dhe në të gjitha programet e tjera të IPA I apo të IPA II, të cilat menaxhohen nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, tejkalon parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Në rastet kur pagesa është reduktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues duhet ta financojë programin nga burimet e veta, deri në shumën e

reduktimit. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti kontraktues më pas mund të kërkojë rimbursimin e këtij financimi, si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë për të rimarrë balancat e tepërta bankare, të cilat kanë mbetur të papërdorura për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para se të ushtrojë këtë të drejtë, Komisioni e fton përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, për të dhënë arsyet e vonës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën për to në vazhdim gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Nuk duhet të jetë shkak interesi i gjeneruar nga paraфинансimi bilanceve bankare të Programit të Veprimit.

8. Sipas nenit 33 (4) të Marrëveshjes Kuadër, kur ndërprerja e afatit për kërkesën për pagesë tejkalon dy muaj, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë një vendim nga Komisioni nëse ndërprerja e afatit duhet vazhdojë.

9. Deklarata financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37 (2) të Marrëveshjes Kuadër do të dorëzohet nga NOA (ZKA) jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operativ.

Neni 12

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi sipas neneve 16 dhe 17 përkatësisht dhe krahas nenit 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, në qoftë se:

a) Komisioni ka vendosur, ose paraqet shqetësime serioze, pasi përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, ka bërë gabime të konsiderueshme, ka parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve në fjalë, në zbatimin e Programit të Veprimit, ose ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje financiare;

b) Komisioni ka vendosur, ose paraqet shqetësime serioze, nëse përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka kryer gabime sistematike ose të përsëritura, ose ka parregullsi, mashtrime, apo shkelje të detyrimeve, në këtë ose në të tjera marrëveshje financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrime, ose shkelje të detyrimeve të kenë një ndikim material në zbatimin e kësaj



marrëveshjeje financiare apo vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA II, ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve bazë;

Neni 13 Mbulimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rimarrë fondet nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet në rregulloren financiare, veçanërisht në rast se:

a) Komisioni vendos se objektivat e Programit të Veprimit të përcaktuara në shtojcën I nuk janë arritur;

b) shpenzimet janë të papërshtatshme;

c) shpenzimet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve apo shkeljeve të detyrimeve në zbatimin e Programit të Veprimit, në veçanti në procedurën e dhënies së prokurimit dhe granteve.

2. Në përputhje me ligjin kombëtar, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të rimarrë kontributin e Unionit që i paguhet përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues nga marrësit të cilët janë në një prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1 pika b) ose c) të këtij neni ose të referuara në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti se përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk ka sukses në kthimin e të gjithë ose një pjese të fondeve, nuk do ta pengojë Komisionin për rikuperimin e fondeve nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin e IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, në rimëkëmbjen e saj, kur përfituesi vendoset në territorin e tij. Marrëveshja për rikuperimin do të parashikohet në një marrëveshje dypalëshe, e cila do të lidhet në përputhje me nenin 69 të marrëveshjeve kuadër përkatëse.

4. Shumat e paguara padrejtësisht apo të mbuluara nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, shumat e garancive financiare, performancës dhe parafinancimit, të paraqitura në bazë të prokurimit dhe dhënies së procedurave të granteve, shumat nga gjobat e vendosura nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit

ose përfituesit e granteve, paguar për përfituesit e IPA II që është Autoriteti Kontraktues ose do të ripërdoren për Programin e Veprimit, ose do t'i kthehen Komisionit.

PJESA E TRETË DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14 Konsultime ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesit e IPA II dhe Komisioni do të konsultohen me njëri tjetrin para se të krijojnë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 18 të këtyre kushteve të përgjithshme.

2. Kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai duhet të krijojë të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA II për të korrigjuar situatën dhe të ndërmarrë hapat që janë të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, në pezullimin ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Komisioni do të informojë rregullisht përfituesit e IPA II për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në pjesën e dytë të këtyre kushteve të përgjithshme.

Neni 15 Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo amendament i kësaj marrëveshjeje financiare, duhet të bëhet me shkrim.

2. Nëse përfituesit e IPA II kërkojnë një amendament, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi që kërkohet të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të amendojë *dokumentet model* në shtojcën III, IIIA, IV dhe V, pa nevojën e një amendamenti të kësaj marrëveshjeje financiare. Përfituesit e IPA II do të informohen me shkrim për çdo amendament të tillë dhe për hyrjen e tij në fuqi.



Neni 16

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Nëse ndonjë përfitues IPA II shkel një detyrim sipas kësaj marrëveshjeje financiare.

b) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në bazë të procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18 (2) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, pa cenuar dispozitat në nenin 8 (2).

c) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk i plotëson kërkesat e për zbatimin e detyrave të buxhetit të besuar.

d) Nëse përfituesit e IPA II nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në nenin 2 (1) dhe kur është e mundur edhe menaxhimin të tërthortë sipas nenit 7 (3).

e) Nëse ndonjë përfitues i IPA II vendos të pezullojë ose të ndërpresë procesin e pranimi të anëtarësimit në BE.

f) Nëse ndonjë përfitues i IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetin ligjor, si dhe në raste të rënda të korrupsionit.

g) Në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. “Forcë madhore” do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme, ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon secilën prej tyre në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre, gjë që nuk i atribuohet gabimit ose pakujdesisë nga ana e tyre (ose pjesës së kontraktuesve të tyre, agentëve ose të punësuarve) dhe vërteton mos-rregullimin e situatës, pavarësisht se janë bërë përpjekjet e duhura. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat e tyre të mundshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare, nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk duhet të konsiderohet si shkelëse e obligimeve të saj nëse ajo është penguar nga përmbushja e tyre për shkak të një force madhore, për cilën pala tjetër është informuar siç duhet. Një palë që përballlet me një forcë madhore duhet ta informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, si edhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

Asnjëra prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, nëse është penguar nga përmbushja e tyre nga forca madhore, me kusht që ajo palë të marrë masa për të minimizuar dëmtimet e mundshme.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë masat e duhura parandaluese para se të bëhet pezullimi.

4. Kur pezullimi është njoftuar, duhet të tregohen pasojat e prokurimit dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe marrëveshjet e delegacionit për këto kontrata, si dhe marrëveshjet që duhen nënshkruar për këto kontrata.

5. Pezullimi i kësaj marrëveshjeje të financimit nuk e cenon ndërprerjen e kësaj marrëveshjeje financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 17.

6. Palët do të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes Financiare sapo kushtet ta lejojnë, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo nuk cenon asnjë amendim të kësaj marrëveshjeje financiare që mund të jenë të nevojshme për të përshtatur Programin e Veprimit për kushtet e reja zbatuese, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së zbatimit, ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financiare në përputhje me nenin 17.

Neni 17

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare

1. Nëse çështjet të cilat çuan në pezullimin e Marrëveshjes së Financimit nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditëve, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen Financiare në njoftimin prej 30 ditësh.

2. Kjo Marrëveshje Financimi do të ndërpritet automatikisht, në qoftë se brenda një periudhe prej dy vjet që prej nënshkrimit të saj:

a) nuk është bërë asnjë pagesë;

b) nuk është nënshkruar asnjë kontratë zbatimi apo marrëveshje delegacioni.

3. Kur ndërprerja është njoftuar, duhet të tregohen pasoja e prokurimeve dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe kontratat ose grantet e tilla që duhen nënshkruar.

4. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare nuk do të përjashtojë mundësinë e Komisionit që të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenet 43 dhe 44 të Marrëveshjes Kuadër.



Neni 18

Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, të parashikuara në nenin 14 mund, të zgjidhet nga arbitrazhi, me kërkesën e njëres prej palëve.

2. Secila palë do të caktojë një gjyqtar brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar të dytë. Të dy gjyqtarët nga ana e tyre caktojnë një gjyqtar të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë.

3. Përveç kur gjyqtarët vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Gjykatën e Përhershme të Arbitrit, rregullat opsionale për Arbitrazhin që përfshijnë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet.

4. Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve.

MODEL

**I RAPORTIT VJETOR TË BNK-së MBI
ZBATIMIN E BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR IPA II NDËRMJET
PËRFITUESVE TË IPA II
(NENI 80 I MARRËVESHJES KUADËR)**

Përmbajtja**Akronimet****1. Identifikimi****2. Përmbledhje mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar****2.1 Arritjet dhe analiza e progresit**

2.2 Progresi në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar (neni 80.1a IPA II FWA)

2.2.1 Analiza sasiore**2.2.2 Analiza cilësore**

2.3 Informacione të hollësishme për ekzekutimin financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar (neni 801 (d) IPAIL FWA)

2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga strukturat operuese dhe/ose Komiteti i Përbashkët Monitorues për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti**2.6 Shfrytëzimi i asistencës teknike**

2.7 Ndryshimet në kuadër të zbatimit të programit ndërkufitar (nëse ka)

Akronimet

<...>

1. Identifikimi

PROGRAMI NDËRKUFITAR	Titulli i Programit: Programi ndërkufitar <vendi A> – <vendi B> <viti>/<viti>
	Përfutimi për vitin 20xx:
	Përfutimi për vitin 20xx:
	Përfutimi për vitin 20xx:
RAPORTI VJETOR MBI ZBATIMIN	Viti i Raportimit (nga 1 janari 20xx deri më 31 dhjetor 20xx)
	Përgatitur nga: – <struktura operative, vendi X> – <struktura operative, vendi Y>
	Data e shqyrtimit të raportit vjetor nga Komiteti i Përbashkët Monitorues

Baza ligjore: Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër të IPA II

2. Përmbledhje mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar**2.1 Arritjet dhe analiza e progresit**

– Përmbledhje mbi zbatimin e programit gjatë periudhës së mbuluar (aktivitetet e kryera, thirrjet e bëra, forumet për të kërkuar partnerë, takimet mbi KGM (komunikimin me gazetarët dhe median) etj.).

– Nëse duhet, të përfshihet edhe informacion mbi përgatitjen apo rishikimin e programit 2014–2020

2.2 Progresi në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar (neni 80.1a IPA II FWA)



Progresi i bërë në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike për çdo prioritet tematik (si dhe për prioritetin e asistencës teknike), duke përfshirë edhe elementet cilësore dhe sasiorë që tregojnë përparim në lidhje me objektivat.

2.2.1 Analiza sasimore

– Informacion mbi progresin e bërë në zbatimin e programit ndërkufitar, me përcaktimet sasimore kur është e mundur, duke përdorur objektivat dhe treguesit që përfshihen në program (**plotësoni shtojcën 1**)

Analizë e arritjeve sipas matjeve nga treguesit fizikë dhe financiarë. Treguesit do të ndahen sipas gjinisë, kur është e mundur.

Nëse shifrat (të dhënat) nuk janë vënë akoma në dispozicion, duhet të jepet informacion se kur do të vihen në dispozicion dhe kur do të përfshihen në raportin vjetor mbi zbatimin. Gjithashtu, informacioni mund të paraqitet grafikisht.

2.2.2 Analiza cilësore

– Analiza cilësore e progresit të bërë në zbatimin e programit ndërkufitar, duke përfshirë një analizë të ndikimit të programit në zonën e programit

2.3 Informacione të hollësishme për ekzekutimin financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar (neni 801 (d) IPAl FWA)²⁶

– Informacion mbi kontraktimin dhe ndarja e përfitimeve vjetore (***** plotësoni shtojcën 2**)

– Analiza e faktorëve të mëposhtëm:

- statusi financiar;
- informacion mbi bashkëfinancimet;
- faktorët që kanë penguar dhe /ose vonuar zbatimin financiar;
- faktorët që kanë pasur ndikim pozitiv në zbatimin financiar.

2.4. Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga strukturat operuese dhe/ose Komiteti i Përbashkët Monitorues për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit:

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

– Masat monitoruese të ndërmarrë nga strukturat operuese ose Komiteti i Përbashkët Monitorues përfshijnë marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave.

– Në programet e zbatuara me masa të tërthorta të vlerësimit të menaxhimit të ndërmarrë nga struktura operuese aty ku ndodhet autoriteti kontraktues (neni 57 i FWA-së).

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

– Përmbledhje e çdo problemi të rëndësishëm të hasur në zbatimin e programit dhe çdo veprimi korrigjues të ndërmarrë.

– Rekomandime për veprime (të mëtejshme) korrigjuese.

2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti

– Masat e marra për të siguruar dukshmërinë dhe reklamimin e programit (planin e vizibilitetit), duke përfshirë shembuj të praktikave më të mira dhe duke theksuar ngjarjet e rëndësishme.

2.6 Shfrytëzimi i asistencës teknike

– Shpjegim i detajuar i shfrytëzimit të asistencës teknike

– Përmbledhje e çdo problemi të rëndësishëm të hasur në zbatimin e buxhetit TA

2.7 Ndryshimet në kuadër të zbatimit të programit ndërkufitar (nëse ka)

– Përkthimi i çdo elementi i cili edhe pse nuk rrjedh drejtpërdrejt nga ndihma, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e programit (p.sh. ndryshimet ligjore, ndryshimet socio-ekonomike përkatëse etj.)

*** - Përfshini një aneks 2 – listën e projekteve dhe një përmbledhje të shkurtër.

Periodha e mbuluar nga raporti: 1.1.20XX-31.12.20XX

Raport i lëshuar, më XX.XX.20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e ndihmës IPA II nën menaxhim të indirekt nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, i paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-së

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Referencë e objektivave të dokumenteve strategjike të vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve

2. Përfshirja në programin

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

²⁶ Ky paragraf do të përfshihet në raporte vetëm në rastin e menaxhimit të tërthortë.



5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-së dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.

6. Përfshirja në veprimet shumë-vendesh dhe çdo çështje që lidhet me to.

7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.

8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

9. Koordinimi i donatorëve.

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjithashtu:

10. Zbatimin e gjithanshëm të asistencës së IPA-së nën menaxhim të tërthortë (maksimumi një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-së dhe masat përkatëse të marra/planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).

13. Auditimet – gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

II. INFORMACION SIPAS SEKTORËVE

Titulli i sektorit²⁷: [Transporti]

Pjesa përshkuese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim.

2. Përmbledhje e rezultateve gjatë lëvizjes drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritur sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të sektorit).

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe/ose donatorë/IFI-të brenda sektorit.

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operative dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse ka: [Ministria e Transportit].

6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor.

7. Arritjet kryesore në atë sektor.

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara, p.sh., vonesat në kontraktim dhe masat të marr/planifikuara në vijim.

9. Rekomandime për veprime të mëtejshme.

10. Aktivitetit monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet – gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerrja, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: bashkëpunimi ndërkufitar²⁸

1. Përfshirja në programim, sipas rastit.

2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.

4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet e grumbullimit të të dhënave dhe kur është e zbatueshme, edhe aktivitetet e vlerësimit.

5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

6. Koordinimi me vendin partner.

Nën menaxhim të tërthortë, duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operative ekzistuese dhe ndryshimet që lidhen me të, nëse ka.

2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra /të planifikuara.

3. Rekomandime për veprime të mëtejshme.

4. Auditimet e kryera – gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

II.a. Treguesit e performancës në sektorin [p.sh. transporti] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit²⁹ për program

²⁸ Për Bashkëpunimin Ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

²⁹ Ky duhet të jetë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit.

²⁷ Sipas sektorëve tregues në dokumentet e Strategjisë.



Marrëveshja e Financimit /Programi referues ³⁰	Treguesi për sektor [<i>Transporti</i>]	Burimi	Linja bazë	Objektivi (2017)	Objektivi (2020)	Vlera (2014 ³¹)
2014 Programi i vendit	Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit					
2014-20XX Programi shumëvjeçar	Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti					

II.b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

Marrëveshja e Financimit /Programi referues	Veprimi	Gjendja/Progresi për një veprim të caktuar (p.sh. po përgatiten termat e referencës, tenderi është shpallur, kontraktuar, po zbatohet, është përfunduar)	Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre	Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen	Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese
[2014 Programi i vendit]	Elektrifikimi i linjës bekurudhore nga xxx në kaufi me xxx	P.sh. kontratë shërbimi për përgatitjen e termave të referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punëve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015		P.sh. kontrata e shërbimit për përgatitjen e termave të referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe u nevojiti të ribëhej	p.sh. ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja dhe zbatimi i paketës së katërt të bekurudhave	

³⁰ Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumëvjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s.

³¹ Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.



Nën menaxhim të tërthortë dubet të sigurohen dhe shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1

Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe të menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me FWA-në (maksimumi një faqe).

Shtojca 2

Historitë e suksesshme (Kujdes! Ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian.)

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Si për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë, dubet të paraqitet shtojca e mëposhtme.

Shtojca 4

Udhërrëfyes i qasjes sektoriale – arritjeve (duke theksuar nëse janë përbushur apo jo objektivat e planifikuar).

DEKRET

Nr. 13374, datë 13.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 116/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Komisionit Evropian për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut–Shqipërisë 2014–2020, alokimet për vitin 2020”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Ilir Meta

LIGJ

Nr. 120/2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9917, DATË 19.5.2008, “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR³²

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. “Bankë guaskë” është një bankë ose institucion financiar apo një institucion që kryen aktivitete të ngjashme me ato që kryhen nga bankat ose institucionet financiare, e cila, pavarësisht se është themeluar në territorin e një vendi, nuk ka prani fizike në të, si dhe nuk është pjesë e një grupi të rregulluar financiar. Për qëllime të këtij përkufizimi, prania fizike nënkupton ekzistencën e funksioneve drejtuese dhe administruese në territorin e vendit në të

³² Ky projektligj është përafuar plotësisht me direktivën (BE) 2015/849, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 maj 2015, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 648/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe direktivën e Komisionit 2006/70/KE”, të ndryshuar. Numri CELEX 32015L0849, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 141, datë 5.6.2015, f. 73–117; ndryshuar me CELEX 32018L0843, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 141, datë 19.6.2018, faqe 43–74).



cilin është themeluar banka. Ekzistenca vetëm e agjentëve lokalë apo e punonjësve të nivelit të ulët nuk përbën prani fizike.”.

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. “Klient” është personi i cili është përdorues i shërbimeve të ofruara nga subjektet e nenit 3 të këtij ligji.”.

3. Pika 3.1 shfuqizohet.

4. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

“7/1. “Marrëdhënie korrespondente” është:

a) ofrimi i shërbimeve bankare nga një bankë si korrespondente të një bankë tjetër si pritëse, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të llogarisë rrjedhëse apo të llogarive të tjera të detyrimit dhe të shërbimeve të ndërldhura, si: administrimi i parave, transferimi ndërkombëtar i fondeve, klerimi/shlyerja e çeqeve, llogaritë për pagesa dhe shërbimet e këmbimit valutor;

b) marrëdhënia ndërmjet bankave dhe institucioneve financiare, duke përfshirë rastet kur shërbimet e ngjashme ofrohen nga një institucion korrespondent të një institucion pritës, duke përfshirë marrëdhëniet e krijuara për transaksionet e titujve apo transferimin e fondeve.”.

5. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. “Personat e ekspozuar politikisht” në kuptim të këtij ligji janë:

a) individët, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, pavarësisht nëse kanë detyrimin për deklarin sipas legjislacionit në fuqi për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë;

b) individët, të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme si brenda vendit apo jashtë vendit në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, ministra, zëvendësministra ose pozicione të ngjashme me to, anëtarë të Kuvendit ose organeve legjislative të ngjashme, politikanë të lartë, anëtarë të organeve drejtuese të partive politike, gjyqtarët e gjykatave të larta ose kushtetuese, si dhe çdo gjyqtar i një gjykate, ndaj

vendimeve të së cilës nuk mund të ushtrohen mjetet e zakonshme të ankimit, anëtarët e organeve drejtuese të bankave qendrore, ambasadorët dhe të ngarkuarit me punë, si dhe oficerët me gradë madhore në Forcat e Armatosura, drejtuesit e lartë dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive shtetërore, si dhe drejtorët, zëvendës drejtorët ose anëtarët e bordit ose çdo pozicion tjetër i ngjashëm me to në një organizatë ndërkombëtare.

Individët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike do të konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 (tre) vjet pas largimit nga funksioni.”.

6. Pas pikës 10 shtohen pikat 10/1 dhe 10/2 me këtë përmbajtje:

“10/1. Anëtarët e familjes së personit të ekspozuar politikisht janë:

a) bashkëshorti/ja apo bashkëjetuesi/ja e një personi të ekspozuar politikisht;

b) fëmijët dhe bashkëshortët/et e tyre apo bashkëjetuesit/set e një personi të ekspozuar politikisht;

c) prindërit e një personi të ekspozuar politikisht.

10/2. Persona të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune ose biznesi të personit të ekspozuar politikisht për qëllime të këtij ligji janë:

a) individët që janë bashkërisht pronarë përfitues në persona juridikë ose organizime ligjore apo çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngushtë biznesi me një person të ekspozuar politikisht;

b) personat të cilët janë pronarë përfitues të vetëm një personi juridik apo organizimi ligjor, i cili dihet se është krijuar për përfitimin *de-facto* të personit të ekspozuar politikisht.”.

7. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. “Pronar përfitues” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për Regjistrin e Pronarëve Përfitues.”.

8. Në pikën 13 fjala “pronësi” zëvendësohet me fjalën “pasuri”.

9. Pika 19 ndryshohet si më poshtë:

“19. “Trust” është marrëdhënia ligjore midis të gjallëve apo për shkak të vdekjes, me të cilën një person, themeluesi, vendos asete nën kontrollin e një kujdestari për llogari të një përfituesi apo për një qëllim të posaçëm. Trusti ka karakteristikat e mëposhtme:



a) asetet formojnë një zë të ndarë dhe nuk përfshihen në pasurinë e kujdestarit;

b) titulli i aseteve të trustit mbahet nga kujdestari ose nga një person tjetër për llogari të kujdestarit;

c) kujdestari ka të drejtën dhe detyrën për të kryer me përgjegjshmëri administrimin, përdorimin dhe disponimin e aseteve në përputhje me kushtet e trustit dhe detyrimet e posaçme të parashikuara me ligj.”.

10. Në pikën 25 pas fjalëve “është një pasqyrim digjital i një vlere që mund” shtohet fjala “të depozitohet”, pas fjalës “investimesh” shtohen fjalët “apo si mjet shkëmbimi”, pas fjalëve “si të nxjerra” shtohen fjalët “ose të garantuara” dhe pas fjalëve “bankat qendrore” shtohen fjalët “ose një autoritet publik”.

11. Në pikën 26 në nënndarjen “ii” pas fjalëve “pasurive të çdo lloji” shtohen fjalët “me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) lekë”.

12. Në pikën 29 hiqet fjala “financiar”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “e” fjalët “shtëpi brokerimi” zëvendësohen me fjalët “shoqëri komisionere”.

2. Shkronja “gj” ndryshohet si më poshtë:

“gj) avokatët, noterët dhe profesionet e tjera, kur përgatisin transaksione ose kur marrin pjesë duke vepruar në emër dhe për llogari të klientit të tyre në çfarëdo transaksioni financiar apo të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ose duke ndihmuar në planifikimin dhe kryerjen e transaksioneve për klientët e tyre, apo kryejnë veprime të tjera që mund të rezultojnë si mbështetje për përcaktimin e vlerës së kuotave të pronësisë apo për kryerjen e transaksioneve të mëposhtme:

i. kalimin e pronësisë së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, administrimin e parave, të titujve ose të aseteve të tjera;

ii. hapjen ose administrimin e llogarive bankare, të kursimeve apo të kasetave të sigurisë;

iii. administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare;

iv. krijimin, funksionimin, blerjen, shitjen ose administrimin e personave juridikë dhe/ose organizimeve ligjore;

v. marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare, rritjet apo pakësimet e kapitalit, përcaktimin e pjesëve;

vi. aktet që lidhen me njohjen ose shlyerjen e detyrimeve ndërmjet personave.”.

3. Në shkronjën “h” pas fjalëve “që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme” shtohen fjalët “apo kur veprojnë si ndërmjetës në dhënien me qira të pasurive të paluajtshme në lidhje me transaksionet për të cilat qiraja mujore arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura.”.

4. Në fillim të nënndarjes “v” të shkronjës “k” hiqen fjalët “shitblerjen e veprave të artit apo”.

5. Pas nënndarjes “v” të shkronjës “k” shtohen nënndarjet “v/1” dhe “v/2” me këtë përmbajtje:

“v/1. shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, përfshirë kur kjo kryhet nga galeritë e artit apo shtëpitë e ankandeve, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra-tjetrën është e barabartë apo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën;

v/2. magazinimin, shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, kur kjo kryhet në “zonat e lira”, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra-tjetrën është e barabartë apo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.”.

6. Pas shkronjës “ll” shtohen shkronjat “m” dhe “n” me këtë përmbajtje:

“m) çdo individ, person fizik apo juridik, që tregton mallra apo shërbime në masën që kryen apo pranon pagesa në para fizike në një shumë prej 1 000 000 (një milion) lekësh ose më shumë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura;

n) audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, këshilltarët tatimorë, si dhe çdo person tjetër që merr përsipër të ofrojë drejtpërdrejt apo



nëpërmjet personave të tjerë me të cilët ai person ka lidhje ndihmë materiale, asistencë apo këshillim për çështje tatimore, si biznes kryesor apo veprimtari profesionale.”.

Neni 3

Në nenin 3/1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2 fjala “Organizimet” zëvendësohet me fjalët “Kujdestarët e organizimeve”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Personi përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të organizimeve ligjore që rrjedhin nga ky ligj është kujdestari i këtyre organizimeve.”.

Neni 4

Në shkronjën “c” të nenit 4 pas fjalës “vërtetësinë” shtohen fjalët “ose përshtatshmërinë”.

Neni 5

Në pikën 1 të nenit 4/1 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b” shtohet nënndarja “iii” me këtë përmbajtje:

“iii. në rastin e përfituesve të trusteve ose organizimeve ligjore, të përcaktuara në bazë të karakteristikave të veçanta apo klasës, duhet të marrin informacion të mjaftueshëm rreth përfituesit në mënyrë që të garantohej identifikimi i përfituesit në momentin e kryerjes së pagesës apo të ushtrimit të të drejtave nga përfituesi.”;

2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) për sigurimin e jetës apo sigurimet e tjera të lidhura me investimet, përveç ushtrimit të detyrueshëm të masave që duhet të ndërmerren për ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe pronarit përfitues, subjektet marrin masat e mëposhtme ndaj përfituesit të sigurimit të jetës dhe policave të tjera të sigurimit të lidhura me investimet, sapo përfituesi/sit identifikohet/en apo përcaktohet/en:

i. në rast të përfituesve të identifikuar si persona të emëruar specifikisht apo në rastin e organizimeve ligjore, merren të dhënat për identifikimin e personit;

ii. në rastin e përfituesve të përcaktuar në bazë të karakteristikave, klasës apo nga mjete të tjera, banka ose institucioni financiar duhet të marrë informacion të mjaftueshëm në lidhje me përfituesin/sit për të përcaktuar identitetin e përfituesit në kohën e pagesës.

Në lidhje me nënndarjet “i” dhe “ii”, verifikimi i identitetit të përfituesve do të bëhet në momentin e kryerjes së pagesës. Në rastin e kryerjes tërësisht ose pjesërisht të sigurimit të jetës ose të investimeve në dobi të një pale të tretë, subjektet në dijeni të caktimit të një pale të tretë duhet të identifikojnë pronarin përfitues në kohën e caktimit të personit fizik, të personit juridik apo të organizimit ligjor që përfiton nga polica e sigurimit.”.

3. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) të përcaktojnë se cilët janë individët që zotërojnë ose kontrollojnë klientin, përfshirë ata persona të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik apo organizimin ligjor. Për personat juridikë kjo duhet të përfshijë edhe identifikimin e individëve, të cilët përbëjnë pjesën vendimmarrëse dhe administruese të personit juridik dhe mbajtjen e të dhënave të veprimeve të ndërmarra, si dhe të çdo vështirësie të hasur gjatë procesit të verifikimit. Në rast të organizimeve ligjore, kjo përfshin edhe identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to;”.

Neni 6

Pas pikës 2 të nenit 5 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Për identifikimin elektronik të klientit, verifikimin e identitetit, mbajtjen e të dhënave dhe dokumentacionit, subjektet e këtij ligji mbështeten në shërbimet e besuara për skemat e identifikimit elektronik sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës në fuqi dhe parashikimeve të këtij ligji.”.



Neni 7

Në nenin 6/1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “c” të pikës 1 fjalët “për këtë veprimtari” zëvendësohen me fjalët “për sistemin parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

2. Në fund të fjalisë së dytë të pikës 3 shtohen fjalët “përveç nëse pala e tretë është një degë ose filial përfaqësimi me pronësi të shumicës së aksioneve të subjektit të detyruar, të krijuar në Shqipëri sipas politikave dhe procedurave të shoqërisë mëmë, të cilat janë në përputhje me këtë ligj.”.

Neni 8

Në nenin 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Fjala e dytë e pikës 1 të nenit 7 ndryshohet si më poshtë:

“Për zvogëlimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, krahas kategorive të përcaktuara në këtë ligj dhe faktorëve e situatave të përcaktuara në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij me vendim të Këshillit të Ministrave, subjektet përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh, transaksionesh, produkteve, shërbimesh, kanalesh shpërndarjeje, vendesh ose rrethesh gjeografike, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar.”.

2. Në fund të pikës 2 të nenit 7 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Nëse nga vlerësimi i kombinuar i riskut të klientit, produkteve, të shpërndarjes gjeografike dhe shërbimeve që do të ofrohen dhe kanaleve të shpërndarjes, rezulton një nivel i ulët risku për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjekti me miratimin e nivelit të lartë drejtues mund të vendosë marrëdhënien e biznesit dhe pa praninë fizike të klientit.”.

Neni 9

Në nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Për anëtarët e familjes, personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të personave të ekspozuar politikisht zbatohen masat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Në lidhje me marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me risk të lartë sipas shkronjës “f” të nenit 22 të këtij ligji, subjektet duhet të zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit:

a) të marrin informacion shtesë për klientin dhe pronarin përfitues;

b) të marrin informacion shtesë për natyrën e marrëdhënies së biznesit;

c) të marrin informacion për burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe pronarit përfitues;

ç) të marrin informacion për arsyet e transaksioneve të synuara ose të kryera;

d) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen ose vazhdimin e marrëdhënieve të biznesit;

dh) të kryejnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënieve të biznesit duke rritur numrin, shpeshtësinë apo periodicitetin e kontrolleve të aplikuara dhe zgjedhjen e modeleve të transaksioneve që kanë nevojë për kontroll të mëtejshëm.

Krahas masave të mësipërme, subjektet zbatojnë një ose më shumë nga masat shtesë lidhur me klientët apo transaksionet që përfshijnë vende me risk të lartë:

i. zbatojnë elemente shtesë të vigjilencës së zgjeruar;

ii. përdorin mekanizma të përmirësuar për raportime apo raportim sistematik të transaksioneve financiare të personi/strukturat përgjegjëse brenda subjektit;

iii. kufizojnë marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet me individët apo persona juridikë nga vendet me risk të lartë.”.

3. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Të dhënat, analizat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të këtij neni ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit ose nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga



data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.”.

Neni 10

Në nenin 10 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

Fjala e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transfertat parash ose vlerash, në rastin e transfertave në nisje dhe në mbërritje, duhet të marrin dhe të identifikojnë emrin, mbiemrin, adresën, numrin e dokumentit të identifikimit ose numrin e llogarisë së dërguesit dhe përfituesit, si dhe emrin e institucionit financiar të përfshirë në transfertë.”.

2. Në fjalinë e dytë të pikës 4 fjalët “i cili duhet t’i trajtojë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të sigurohet që ata zbatojnë të njëjtat masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit, mbajtjes së të dhënave dhe raportimit” shfuqizohen.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Të dhënat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të këtij neni ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit ose nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.”.

Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Detyrimet e këtij neni zbatohen edhe nga ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale.”.

Neni 11

Në nenin 11 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të nënndarjes “ii” të shkronjës “a/1” të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Faktorët minimalë që duhet të vlerësohen janë qëllimi i hapjes së llogarisë apo vendosjes së marrëdhënies, niveli i aseteve që do të depozitohen nga klienti apo madhësia e transaksioneve, rregullshmëria ose kohëzgjatja e marrëdhënies së biznesit.”.

2. Nënndarja “iii” e shkronjës “a/1” të pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“iii. të marrin në konsideratë vlerësimet kombëtare të riskut, vlerësimet sektoriale, të dhëna të tjera të ngjashme, rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe/ose autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe vlerësime ose raporte të hartuara nga organizata ndërkombëtare dhe autoritete me kompetencë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për sa i përket riskut që përbëjnë vende të veçanta.”.

3. Pas shkronjës “b” të pikës 1 shtohen shkronjat “b/1” dhe “b/2” me këtë përmbajtje:

“b/1) personi përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duhet të jetë drejtues ose punonjës me njohuri të mjaftueshme për rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të subjektit dhe të ketë kompetencë për të marrë vendime që ndikojnë në ekspozimin ndaj riskut dhe që nuk nevojitet në të gjitha rastet të jetë anëtar i bordit të drejtorëve;

b/2) personi përgjegjës i emëruar sipas parashikimeve të pikës 1, shkronja “b”, të këtij neni, është personi që dërgon raportet sipas nenit 12, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, si dhe u kthen përgjigje kërkesave të autoritetit përgjegjës.”.

4. Në shkronjën “d” të pikës 1 pas fjalëve “dhe të financimit të terrorizmit” shtohen fjalët “përfshirë detyrimin për mosdeklarim sipas nenit 15 të këtij ligji, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale”.

5. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Kur një individ, që bën pjesë në kategoritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji, ushtron veprimtarinë profesionale si i punësuar i një personi juridik apo personi fizik tregtar, detyrimet e këtij neni zbatohen vetëm nga punëdhënësi.”.

Neni 12

Fjala e fundit e pikës 3 të nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen nga organet apo ndërmarrjet publike.”



Neni 13

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë numërohet “1”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Zgjidhja e kontratës së punës, masat disiplinore apo diskriminuese për punonjësin që përmbush detyrimin për raportim brenda subjektit ose tek autoriteti përgjegjës konsiderohen masa pa shkaqe të arsyeshme.”.

Neni 14

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

1. Subjektet duhet të ruajnë dokumentet që rrjedhin nga procesi i vigjilencës së duhur dhe asaj të zgjeruar, të dhënat e llogarive, transaksioneve, korrespondencën me klientin, si dhe rezultatet e analizave të kryera për 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

2. Subjektet duhet të mbajnë regjistra për të dhënat, raportimet dhe dokumentacionin për transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht nëse transaksioni është kryer në emër të klientit ose në emër të palëve të treta, së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës, përfshirë dosjet e llogarive dhe korrespondencën e biznesit, për 5 (pesë) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo e kryerjes së analizës.

3. Subjektet duhet të ruajnë të dhëna për transaksionet, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, me të gjitha hollësitë e duhura për të lejuar rindërtimin e ciklit të plotë të transaksioneve, me qëllim sigurimin e informacionit për autoritetin përgjegjës dhe për autoritetet e tjera kompetente, në bazë të këtij

ligji e të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ky informacion ruhet për 5 (pesë) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo e kryerjes së analizës.

4. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës dhe të autoriteteve të tjera kompetente, dokumentacioni ruhet edhe për 5 (pesë) vjet të tjera nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo e kryerjes së analizës.

5. Dokumentacioni i parashikuar në këtë nen ruhet në formë shkresore ose elektronike, në varësi të mënyrës së krijimit.

6. Subjektet duhet të sigurohen që të gjitha të dhënat për klientin dhe transaksionin dhe informacioni i kërkuar për t'u mbajtur, sipas kësaj dispozite, të vihen menjëherë në dispozicion me kërkesën e autoritetit përgjegjës dhe të autoriteteve të tjera kompetente.”.

Neni 15

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje :

“Neni 16/1

Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale në zbatim të këtij ligji bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Neni 16

Në pikën 2 të nenit 17 fjalët “e nenit 11 të këtij ligji,” zëvendësohen me fjalët “e nenit 28, pika 3, shkronja “b”, të këtij ligji”.

Neni 17

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 pas fjalëve “në nenin 4” shtohen fjalët “shkronjat “c” dhe “ç””.



2. Në pikën 2 fjalët “e nenit 11 të këtij ligji,” zëvendësohen me fjalët “e nenit 28, pika 3, shkronja “c”, të këtij ligji”.

Neni 18

Në nenin 22 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “ç” pas fjalës “inspektimet” shtohen fjalët “në vend dhe në distancë”.

2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:

“d/1) mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit me agjencitë homologe të huaja vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur shkëmbimi vlerësohet se është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit shqiptar.”.

3. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “e/1” me këtë përmbajtje:

“e/1) mund të refuzojë kërkesat për informacion nga organet ligjzbatuese kur dhënia e informacionit:

- i. cenon një hetim apo analizë të nisur;
- ii. është qartazi jo në proporcion me interesat e ligjshme të një personi apo pa lidhje me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa.”.

Neni 19

Pas paragrafit të parë të nenit 22/1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Organet ligjzbatuese informojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për përdorimin e informacionit apo të dhënave të dërguara kryesisht nga kjo e fundit, si dhe për rezultatet e hetimeve apo të inspektimeve të bazuara mbi të dhënat dhe informacionin e dërguar në mënyrë periodike çdo 6 (gjashtë) muaj.”.

Neni 20

Shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

“dh) Bordi i Mbikëqyrjes Publike për audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar.”.

Neni 21

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Masa shtesë për vendet me risk të lartë

Autoritetet mbikëqyrëse dhe/ose licencuese zbatojnë një apo disa nga masat e mëposhtme në raport me vendet me rrezik të lartë:

a) refuzimi i themelimit të filialeve, degëve apo zyrave përfaqësuese të subjekteve nga vende me risk të lartë, ose në raste të tjera marrja në konsideratë e faktit se subjekti është nga një shtet, i cili nuk ka apo nuk zbaton sisteme të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) ndalimi i subjekteve që të themelojnë degë apo zyra përfaqësuese në vendin me risk të lartë apo marrja parasysh e faktit se dega apo zyra përfaqësuese përkatëse do të ishte në një vend i cili nuk ka apo nuk zbaton sisteme të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) të kërket mbikëqyrje e shtuar ose kërkesa të shtuara për auditim të jashtëm për degët dhe filialet e subjekteve që gjenden në vende me risk të lartë;

ç) të kërket shtimi i kërkesave për auditim të jashtëm për grupet financiare në raport me cilëndo prej degëve dhe filialeve të tyre që gjenden në vende me risk të lartë;

d) të kërket nga bankat ose institucionet financiare rishikimi dhe ndryshimi ose, nëse është e nevojshme, përfundimi i marrëdhënieve korrespondente me institucionet përkatëse në vendin/et me risk të lartë.”.

Neni 22

Fjalja e parë e pikës 2 të nenit 25 shfuqizohet.

Neni 23

Në nenin 27 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “d” të pikës 3 fjalët “në nenin 15” zëvendësohen me fjalët “në nenin 14 dhe 15”.



2. Në nënndarjen “i” të shkronjës “dh” të pikës 3 pas fjalëve “dhe/ose administrimi,” shtohen fjalët “apo agent,” dhe pas fjalës “personi” shtohen fjalët “apo agjenti”.

3. Pas shkronjës “dh” të pikës 3 shtohen shkronjat “e” dhe “ë” me këtë përmbajtje:

“e) për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij janë të rënda, të përsëritura, sistematike apo një kombinim i tyre, gjoba maksimale që mund të vendoset ndaj subjekteve është deri sa dyfishi i shumës së përfitimit të nxjerrë nga shkelja kur ai përfitim mund të përcaktohet ose deri në 125 000 000 (njëqind e njëzet e pesë milionë) lekë në rastet kur nuk mund të përcaktohet apo është më i vogël”.

ë) përveçse sa parashikohet në pikat më sipër, për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij kryhen nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, kur:

i. subjekti është person juridik, vendoset gjobë deri në 10 (dhjetë) përqindëshin e qarkullimit total vjetor sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit të fundit, të miratuara, ku përfshihen edhe pasqyrat financiare të bijave në rastet kur subjekti është një shoqëri mëmë. Në rast se 10 (dhjetë) përqindëshi i qarkullimit total vjetor është më pak se 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë, nga autoriteti përgjegjës vendoset gjoba deri në 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë;

ii. subjekti është person fizik vendoset gjoba deri në 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë.”.

Neni 24

Në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “a” e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“a) mënyrat dhe procedurat për zbatimin nga subjektet raportuese të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;”.

2. Shkronja “ç” e pikës 3 shfuqizohet.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13392, datë 17.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 13392, datë 17.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 120/2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ

Nr. 121/2021

**PËR RATIFIKIMIN E
MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS, LIDHUR
ME VENDOSJEN E KUFIZIMEVE TË
IMPORTIT TË KATEGORIVE TË
MATERIALEVE ARKEOLOGJIKE
DHE ETNOLOGJIKE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13389, datë 17.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS, LIDHUR ME VENDOSJEN E
KUFIZIMEVE TË IMPORTIT PËR
KATEGORITË E MATERIALEVE
ARKEOLOGJIKE DHE ETNOLOGJIKE
TË SHQIPËRISË**

Republika e Shqipërisë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këtu e më poshtë të përmendura si “Palët”,

duke vepruar në përputhje me Konventën e UNESCO-s të vitit 1970 për Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore, ku të dyja vendet janë Shtete palë; dhe

duke dëshiruar të zvogëlojnë shtysën për plaçkitjen e materialit të pazëvendësueshëm arkeologjik dhe etnologjik që përfaqëson trashëgiminë kulturore të Shqipërisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni I

1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në përputhje me legjislacionin e tyre, përfshirë edhe aktin për Zbatimin e Konventës për Pasurinë Kulturore, do të kufizojnë importimin në Shtetet e Bashkuara të kategorive të caktuara të materialit arkeologjik, që datojnë nga 300,000 vjet më parë deri në vitin 1750 p.K. dhe kategori të caktuara të materialit etnologjik, që datojnë përafërsisht nga viti 400 p.K. deri në vitin 1913, të cilat mund të përfshijnë kategori të elementeve arkitekturore nga strukturat historike ose fetare; objekte funerale; objekte rituale dhe ceremoniale; piktura; dokumente të shkruara; tekstile; si edhe armë e parzmorë të identifikuar në listën që do të shpallet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (këtu e më poshtë e referuar si “Lista e Përcaktuar”), përveç rasteve kur Republika e Shqipërisë lëshon një vërtetim, ku vërtetohet se ky eksportim nuk është bërë në kundërshtim me ligjet e vendit.

2. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t’i ofrojnë Republikës së Shqipërisë kthimin e çdo objekti ose materiali në Listën e Përcaktuar të konfiskuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3. Kufizime të tilla të importit do të hyjnë në fuqi në datën kur Lista e Përcaktuar botohet në Regjistrin Federal të SHBA-së, Fletorja Zyrtare e qeverisë së Shteteve të Bashkuara që ofron njoftim të paanshëm të publikut.

Neni II

1. Të dyja Palët do ta publikojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi (MM) dhe arsyet e lidhjes së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi të secilit vend.

2. Republika e Shqipërisë do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të ruajtur dhe për të ndarë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës informacione rreth gërmimeve të paautorizuara, vjedhjeve të pasurive kulturore, trafikimit të pasurive kulturore dhe kërcënimeve të tjera që rrezikojnë trashëgiminë e saj kulturore.

3. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të përdorë përpjekjet e saj më të mira për të ndërmarrë hapa në përputhje me Konventën e UNESCO-s të vitit 1970 për Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit, Eksportit dhe



Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore, me qëllim që të mbrojë trashëgiminë e saj kulturore. Në ndihmë të këtyre përpjekjeve, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përdorin përpjekjet e tyre më të mira për të lehtësuar ndihmën teknike ndaj Republikës së Shqipërisë, sipas nevojës, në bazë të programeve në dispozicion në sektorët publik dhe/ose privat.

4. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të përdorë përpjekjet e saj më të mira për të angazhuar vendet e tjera, të cilat kanë një tregti të konsiderueshme të importimit të materialeve arkeologjike dhe etnologjike nga Shqipëria, me qëllim që të parandalojë një situatë të rëndë të plaçkitjes së pasurisë kulturore.

5. Secila Palë do të përdorë përpjekjet e saj më të mira për të inkurajuar shkëmbimin e materialeve arkeologjike dhe etnologjike për qëllime kulturore, arsimore dhe shkencore, përfshirë edhe dhënien hua të këtyre materialeve për një afat kohe të gjatë, me qëllim që të nxitet vlerësimi i publikut të gjerë dhe mundësitë e qasjes ndaj trashëgimisë së pasur kulturore të Shqipërisë.

6. Secila palë do të vazhdojë të përpiqet që të mbajë palën tjetër të informuar mbi masat e marra për zbatim e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni III

Detyrimet e të dyja Palëve dhe veprimtaritë e kryera në zbatim të këtij Memorandumi u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të tyre përkatëse, përfshirë ato në lidhje me disponueshmërinë e fondeve.

Neni IV

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit më të fundit të shkëmbimeve të njoftimeve ku Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për këtë qëllim. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, përveçse nëse zgjatet.

2. Ky Memorandum mund të zgjatet dhe ndryshohet vetëm me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.

3. Palët do të rishikojnë efektshmërinë e këtij Memorandumi Mirëkuptimi para skadimit të periudhës pesëvjeçare (5-vjeçare), me qëllim që të përcaktojnë nëse Memorandumi i Mirëkuptimit duhet të zgjatet.

4. Secila Palë mund të njoftojë tjetrën, me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, për qëllimin e saj që të përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi para datës së mbarimit. Në një rast të tillë, përfundimi hyn në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas datës së njoftimit.

Në prani të tyre, secili prej të nënshkruarve, të autorizuar përkatësisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Lidhur në Uashington, më 23 gusht 2021, në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe angleze, të dyja tekstet janë njësoj autentike.

PËR REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË:

PËR SHTETET E
BASHKUARA TË
AMERIKËS:

DEKRET

Nr. 13389, datë 17.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 121/2021, “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



LIGJ
Nr. 122/2021

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 99/2021, “PËR RATIFIKIMIN E VENDIMIT TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT EFTA–SHQIPËRI NR. 1, I VITIT 2021, MIRATUAR MË 24.6.2021, PËR NDRYSHIMIN E PROTOKOLLIT B TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHTETEVE TË EFTA-s DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, LIDHUR ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT TË ‘PRODUKTEVE ORIGJINUESE’ DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV, DHE NDRYSHIMIN E MARRËVESHJEVE PËR BUJQËSINË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ISLANDËS, SI PJESË PËRBËRËSE E SAJ”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 99/2021, “Për ratifikimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri nr. 1, i vitit 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të ‘produkteve origjinuese’ dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimin e marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në titull dhe në nenin 1 të ligjit, pas fjalëve “Republikës së Islandës” shtohen fjalët “si dhe Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë”.

Neni 2

Bashkëlidhur ligjit shtohet si pjesë përbërëse e tij marrëveshja ndryshuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13390, date 17.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

NDRYSHIMI I MARRËVESHJES PËR BUJQËSINË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË NORVEGJISË

Republika e Shqipërisë (në vijim e referuar si “Shqipëria”) dhe Mbretëria e Norvegjisë (në vijim e referuar si “Norvegjia”),

duke pasur parasysh Marrëveshjen për Bujqësinë, të lidhur nga Shqipëria dhe Norvegjia në datën 17 dhjetor 2009, dhe e ndryshuar nga protokollin më 18 shtator 2015 (në vijim e referuar si “Marrëveshja”);

duke vërejtur se Marrëveshja u lidh në vijim të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të EFTA-s, të nënshkruar më 17 dhjetor 2009, dhe në veçanti sipas paragrafit 2, të nenit 6, të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë;

duke vërejtur se Konventa Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-euro-mesdhetare të Originës (në vijim e referuar si “Konventa”) parashikon të zëvendësojë rregullat e originës aktualisht në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese të sistemit pan-euro-mesdhetar;

duke vërejtur se Konventa hyri në fuqi për Shqipërinë në datën 1 maj 2012 dhe për Norvegjinë në datën 1 janar 2012;



duke synuar harmonizimin e rregullave të origjinës për Marrëveshjen me ato të Konventës, bien dakord për ndryshimet e mëposhtme të marrëveshjes:

1. Teksti i nenit 3, të Marrëveshjes për Bujqësinë, zëvendësohet me tekstin në shtojcën e këtij vendimi.

2. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, mbasi Palët kanë shkëmbyer instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Bërë në Gjenevë, në datën 8 korrik të vitit 2021, në dy origjinale në gjuhën angleze.

Për Republikën
e Shqipërisë

Për Mbretërinë e
Norvegjisë

Neni 3

Rregullat e origjinës dhe bashkëpunimi administrativ

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në lidhje me rregullat e origjinës dhe bashkëpunimin administrativ, rregullohen nga protokollin B i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë.

2. Çdo referencë ndaj “Shteteve të EFTA-s” në protokollin B konsiderohet se i referohet Norvegjisë.

DEKRET

Nr. 13390, datë 17.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 122/2021, “Për disa shtesa në ligjin nr. 99/2021, ‘Për ratifikimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri nr. 1, i vitit 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të ‘produkteve origjinuese’ dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimin e

marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 123/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR TË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR MBËSHTETJEN E PËRPPJEKJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZBUTJEN E PANDEMISË COVID-19

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja kuadër e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë COVID-19, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13391, datë 17.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.



LOGO

LD 2088 (2021)

MARRËVESHJE KUADËR HUAJE

ndërmjet

BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS

dhe

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mbështetje e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë COVID-19



TABELA E PËRMBAJTJES

- 1. INTERPRETIMI**
 - 1.1 PËRKUFIZIME
 - 1.2 INTERPRETIMI
 - 1.3 TITUT
 - 1.4 RRUMBULLAKOSJA
- 2. KUSHTET**
- 3. QËLLIMI**
- 4. KUSHTET FINANCIARE**
 - 4.1 SHUMA E HUASË
 - 4.2 SHUMA E DISBURSIMIT
 - 4.3 PROCEDURA E DISBURSIMIT
 - 4.4 PERIUDHA E DISBURSIMIT
 - 4.5 KUSHTET E DISBURSIMIT
 - 4.6 SHLYERJA
 - 4.7 PARAPAGIMI
 - 4.8 PËRCAKTIMI I INTERESIT
 - 4.9 NORMA E KAMATËVONESËS
 - 4.10 RASTI I DEFORMIMIT TË TREGUT
 - 4.11 PAGESAT
- 5. ZBATIMI I PROJEKTIT**
 - 5.1 DETYRIMI I KUJDESIT
 - 5.2 PERIUDHA E ALOKIMIT
 - 5.3 KOSTOT E PROJEKTIT
 - 5.4 SIPËRMARRJET SPECIFIKE TË PROJEKTIT
 - 5.5 PROKURIMI
 - 5.6 GARANCITË MJEDISORE DHE SOCIALE
 - 5.7 TË DREJTAT E NJERIUT
 - 5.8 INTEGRITETI
 - 5.9 VIZIBILITETI
- 6. MONITORIMI**
 - 6.1 RAPORTIMET
 - 6.2 VIZITAT
 - 6.3 AUDITIMI
 - 6.4 INFORMACION MBI PROJEKTIN
 - 6.5 INFORMACION MBI HUAMARRËSIN
 - 6.6 ZOTIMET FINANCIARE
- 7. PARI PASSU**
 - 7.1 KLASIFIKIMI
 - 7.2 GARANCIA
 - 7.3 KLAUZOLË ME ANË TË PËRFSHIRJES
 - 7.4 PARAPAGIMI PËR PALËT E TRETA
- 8. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË**
- 9. PALËT E TRETA**
- 10. MOS-HEQJA DORË**
- 11. TRANSFERIMI**
- 12. PALIGJSHMËRIA**
- 13. MOSZBATIMI I KLAUZOLËS PËR RRETHANAT E PAPARASHIKUARA**
- 14. LIGJI RREGULLUES**



15. MOSMARRËVESHJET
16. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE
17. NJOFTIMET
18. TAKSAT DHE SHPENZIMET
19. ÇLIRIMI NGA DETYRIMET
20. HYRJA NË FUQI
- SHTOJCA 1
- SHTOJCA 2
- SHTOJCA 3
- SHTOJCA 4
- SHTOJCA 5
- SHTOJCA 6

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EVROPËS, një organizatë ndërkombëtare me seli në adresën: 55, Avenue Kléber, 75116 Paris (Francë) (në vijim e referuar si **"CEB"** ose **"Banka"**), nga njëra anë,

dhe

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga Anila DENAJ, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si **"Huamarrësi"**) dhe së bashku me CEB, **"Palët"** dhe secila një **"Palë"**) nga ana tjetër,

MEQË

- (A) Duke pasur parasysh aplikimin për hua të paraqitur nga autoritetet shqiptare më 7 maj 2021, të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB më 11 qershor,
- (B) Duke pasur parasysh Protokollin e Tretë të datës 6 mars 1959 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës, të datës 6 shtator 1949,
- (C) Duke pasur parasysh Rregulloret e Huasë të CEB, siç janë miratuar nga Rezoluta 1587 (2016) e Këshillit Administrativ të CEB (në vijim referuar si **"Rregulloret e Huasë"**),
- (D) Duke pasur parasysh Politikën e CEB për Financimin e Huave dhe Projekteve, siç është miratuar nga Rezoluta 1617(2020) e Këshillit Administrativ të CEB (në vijim e referuar si **"Politika e Huasë"**,
- (E) Duke pasur parasysh Politikën e Garancive Mjedisore dhe Sociale të CEB, siç është miratuar nga Rezoluta 1588 (2016) e Këshillit Administrativ të CEB (në vijim e referuar si **"Politika e Garancive Mjedisore dhe Sociale"**),
- (F) Duke pasur parasysh Udhëzimet e Prokurimit të CEB, siç janë miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB në shtator 2011 (në vijim të referuara si **"Udhëzimet e Prokurimit"**),
- (G) Duke pasur parasysh Rregulloren e CEB për një sistem për mbrojtjen e të dhënave personale në CEB, siç është miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB në shtator 2011 (në vijim e referuar si **"Rregullorja e Mbrojtjes së të Dhënave Personale"**),
- (H) Duke pasur parasysh Kartën Anti-Korrupsion të CEB, siç është miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB në dhjetor 2020, dhe
- (I) Duke pasur parasysh Juridiksionet Jo-bashkëpunuese/të Papajtueshme, siç është miratuar nga Rezoluta 1608 (2019) e Këshillit Administrativ të CEB,

ME ANË TË KËSAJ BIEN DAKORD SI MË POSHTË:



1. INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Termat e mëposhtme kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

“Marrëveshje” nënkupton marrëveshje kuadër financimi, duke përfshirë shtojcat e saj.

“Alokim” nënkupton angazhimin e një Transhi nga Huamarrësi për pjesët përbërëse të pranueshme të Projektit/Nënprojekteve, edhe nëse ky Transh nuk do të ishte paguar ende sipas Projektit.

“Periudhë Alokimi” ka kuptimin e përcaktuar sipas Nënklauzolës 5.2.

“Ditë Pune” nënkupton:

Në lidhje me pagesat në EURO, çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (Sistemi Automatik Transevropian i Transfertave Ekspres në Kohë Reale të Shlyerjeve Bruto).

“Certifikatë” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.5 dhe formularin e përcaktuar sipas Shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje.

“Datë Mbylljeje” nënkupton datën e specifikuar sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje nga e cila nuk mund të zhvillohen disbursime të mëtejshme sipas Huasë.

“Raport Përfundimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 6.1(c).

“Komponentë” nënkupton sektorët e pranueshëm të veprimit të përcaktuar sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

“Rast i Mospërbushjes së Tërthortë të Detyrimeve” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 6.6.

“Monedhë” nënkupton, për qëllimet e Marrëveshjes, EURO.

“Marrëveshje e Përcaktimit të Ditëve” nënkupton marrëveshjen për përcaktimin e numrit të ditëve ndërmjet dy datave dhe numrin e ditëve në vit siç specifikohet në Njoftimin Përkatës të Disbursimit.

“Instrument borxhi” nënkupton (i) çdo hua ose formë tjetër të borxhit financiar; (ii) një instrument, duke përfshirë një dëftesë ose pasqyrë llogarie që provon ose përbën një detyrim për të shlyer një hua, depozitë, parapagim apo shtyrje të ngjashme kredie (duke përfshirë pa kufizim çdo shtyrje të kredisë në bazë të një marrëveshjeje rifinancimi dhe riskedulimi); (iii) një obligacion, notë, garanci borxhi, dëftesë borxhi apo provë të ngjashme me shkrim të borxhit financiar; ose (iv) një instrument që provon një garanci të një detyrimi që përbën borxh financiar të tjetrës.

“Normë e Kamatëvonesës” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.9.

“Datë Disbursimi” nënkupton datën kur është skeduluar disbursimi i një Transhi në përputhje me Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Njoftim Disbursimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.3(b).

“Kërkesë Disbursimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.3 (a).



“Datë e Hyrjes në Fuqi” nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes që rezulton nga Klauzola 20.

“BE” nënkupton Bashkimin Evropian.

“EURIBOR” nënkupton normën e përqindjes të kuotuar nga ndonjë dhënësi i lajmeve financiare, të zbatueshme për CEB në ose rreth orës 11 paradite me kohën e Brukselit në Datën e Përcaktimit të Interesit, si norma e financimit për biznese të tregtisë me shumicë në EURO e administruar nga Instituti Evropian i Tregut Monetar (ose ndonjë subjekt tjetër që merr në dorëzim administrimin e asaj përqindjeje) për të njëjtën periudhë si Periudha përkatëse e Interesit.

Nëse Periudha përkatëse e Interesit nuk është e njëjtë me periudhën e kuotuar nga dhënësi përkatës i lajmeve financiare, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes që rezulton nga interpolimi linear duke iu referuar dy (2) normave të EURIBOR-it, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë të ardhshme më të shkurtër muajsh të plotë dhe tjetra për një periudhë të ardhshme më të gjatë prej muajsh të plotë sesa kohëzgjatja e Periudhës përkatëse të Interesit.

“EURO” dhe simboli **“EURO”** nënkupton monedhën e ligjshme të Shteteve Anëtare të BE-së, të cilat herë pas here e miratojnë atë si monedhën e tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funksionimin e BE-së apo traktatet e tjera vijuese.

“Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut” nënkupton Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950, CETS Nr. 5, e ndryshuar herë pas here.

“Kartë Sociale Evropiane” nënkupton Kartën Sociale Evropiane të datës 3 maj 1996, CETS Nr. 163, të ndryshuar herë pas here.

“Përfitues Përfundimtarë” janë specifikuar sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje, si grupi përfitues i ndikimeve sociale të Projektit.

“Normë Fikse Interesi” nënkupton normën e interesit në vit të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Normë e Ndryshueshme Interesi” nënkupton normën e interesit në vit të përcaktuar duke shtuar ose zbritur Diferencën e specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit deri ose nga, sipas rastit, Norma Referuese.

Për shmangien e dyshimit, kur përcaktimi i Normës së Ndryshueshme të Interesit rezulton në një normë negative interesi (për shkak të një Norme negative Referuese të kuotuar, për kryerjen e një Diference që është zbritur nga Norma Referuese ose në rrethana të tjera), interesi për t’u paguar nga Huamarrësi për Periudhën e Interesit konsiderohet të jetë zero.

“Datë Përcaktimi e Normës së Interesit” nënkupton, për qëllimet e përcaktimit të një Normë të Ndryshueshme Interesi, ditën që bie dy (2) Ditë Pune para ditës së parë të Periudhës së Interesit, nëse nuk specifikohet ndryshe në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

“Data të Pagesës së Interesit” nënkupton datat për pagesën e interesit që korrespondojnë me Periudhën përkatëse të Interesit të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit

“Periudhë Interesi” nënkupton periudhën që fillon në një Datë Pagese Interesi dhe që përfundon menjëherë një ditë para Datës së ardhshme të Pagesës së Interesit, me kusht që Periudha e parë e zbatueshme e Interesit për secilin Transh të fillojë në Datën e Disbursimit dhe të përfundojë menjëherë një ditë para Datës së ardhshme të Pagesës së Interesit.

“Hua” nënkupton huanë e dhënë Huamarrësit nga CEB-I me anë të Marrëveshjes.



“Shumë Huaje” nënkupton shumën e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.1.

“Rast i Deformimit të Tregut” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.10.

“Ndryshim Material Negativ” nënkupton çdo ngjarje që në opinionin e CEB, (i) dëmton materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij financiare sipas Marrëveshjes; (ii) ndikon negativisht në ndonjë Garanci të dhënë nga Huamarrësi ose një palë e tretë për të siguruar përmbushjen e duhur të detyrimeve financiare të Huamarrësit sipas Marrëveshjes; ose (iii) ndikon negativisht në të drejtat ose mjetet ligjore të CEB sipas Marrëveshjes.

“Datë Maturimi” nënkupton Datën e fundit të Shlyerjes së Principalit për secilin Transh të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Marrëveshje e Ditës së Ndryshuar të ardhshme të Punës” nënkupton një marrëveshje me anë të së cilës, nëse një datë e specifikuar do të binte në një ditë që nuk është Ditë Pune, ajo datë do të ishte dita e parë e ardhshme që është një Ditë Pune, nëse ajo ditë nuk bie në muajin e ardhshëm kalendarik, rast në të cilin ajo datë do të ishte dita e parë pararendëse që është një Ditë Pune.

“Konfirmim Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Kosto Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Datë Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Njoftim Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Datë (a) për Shlyerjen e Principalit” nënkupton datën (at) për shlyerjen (et) e principalit sipas secilit Transh të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Periudhë e Shlyerjes së Principalit” nënkupton në lidhje me secilin Transh, periudhën që fillon nga Data e tij e Disbursimit deri në Datën e tij të Maturimit.

“Raport Progresi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 6.1(b).

“Praktika të Ndalura” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 0.

“Projekt” nënkupton masat e lidhura me COVID 19 të përcaktuara sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje, të cilat do të financohen pjesërisht me Huanë e miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB me referencë LD 2088 (2021).

“Normë Referuese” nënkupton EURIBOR-in për një Transh me Normë të Ndryshueshme Interesi të caktuar në EURO.

“Lista të Sanksioneve” nënkupton çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh të lëshuar nga BE-ja në përputhje me kapitullin 2 të titullit V të Traktatit për Bashkimin Evropian; si dhe Nenin 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, siç është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit¹ të BE-së ose ndonjë faqe vijuese, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here; ose (ii) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh, të lëshuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në përputhje me Nenin 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, siç është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të Kombeve të Bashkuara ose në çdo faqe vijuese, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here.

“Persona të Sanksionuar” nënkupton çdo individ ose subjekt të listuar në dhe/ose ndryshe që i nënshtrohet një ose më shumë Listave të Sanksioneve.

¹ http://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en.



"Garanci nënkupton çdo marrëveshje ose masë që krijon një shkallë preferenciale, një të drejtë preferenciale pagese, një kolateral ose garanci të çfarëdo natyre, e cila mund t'i japë të drejta të zgjeruara palëve të treta

"Diferencë" nënkupton, në lidhje me Transhet me Normë të Ndryshueshme Interesi, diferencën fikse ndaj Normës Referuese (që është ose plus, ose minus) të specifikuar në pikë bazë në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

"Transh" nënkupton një shumë të disbursuar ose që do të disbursohet sipas Huasë.

1.2 Interpretimi

Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, referencat për:

- (i) këtë Marrëveshje interpretohen si referenca për këtë Marrëveshje të cilat herë pas here plotësohen, ndryshohen ose ripërcaktohen;
- (ii) një Palë ose ndonjë person tjetër përfshin pasuesit e tij në titull ose të transferuarit e tij të lejuar ;
- (iii) "Klauzola", "Nënklaizola" dhe "Pika" interpretohen si referenca ndaj klauzolave, nënklaizolave dhe pikave përkatësisht në këtë Marrëveshjeje; dhe
- (iv) Fjalët e përdorura në njëjës do të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas

1.3 Titujt

Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

1.4 Rrumbullakosja

Për qëllimet e llogaritjeve të përmendura në këtë Marrëveshje:

- (i) të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritje të tilla përveç atyre të përcaktuara nëpërmjet përdorimit të interpolimit, rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, në më të afërtën e njëqind të mijtës të një pike përqindjeje (p.sh., 9.876541% (ose .09876541) duke u rrumbullakosur në 9.87654% (ose.0987654) dhe 9.876545% (ose .09876545) duke u rrumbullakosur deri në 9.87655% (ose .0987655));
- (ii) të gjitha përqindjet e përcaktuara nëpërmjet përdorimit të interpolimit linear duke iu referuar dy (2) Normave përkatëse Referuese, do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, në përputhje me metodën e përcaktuar në nënparagrafin (i) më sipër, por në të njëjtën shkallë saktësie si dy (2) normat e përdorura për të bërë përcaktimin (përveç kur përqindje të tilla nuk do të rrumbullakosen në një shkallë më të ulët saktësie sesa e një e mijta e një pike përqindjeje (0.001%)); dhe
- (iii) të gjitha shumat e monedhës të përdorura në ose që rezultojnë nga llogaritjet e mësipërme do të rrumbullakosen, përveç nëse specifikohet ndryshe në përkufizimin përkatës të Monedhës, në dy numrat dhjetorë më të afërt në monedhën përkatëse (me .005 të rrumbullakosura lart (p.sh., .674 rrumbullakuar poshtë në .67 dhe .675 që rrumbullakoset deri në .68).



2. KUSHTET

Huaja jepet sipas kushteve të përgjithshme të Rregulloreve të Huasë dhe kushteve të veçanta të Marrëveshjes.

3. QËLLIMI

CEB i jep Huanë Huamarrësit, i cili e pranon atë, vetëm për qëllim të financimit të Projektit siç përshkruhet sipas Shtojcës 1.

Çdo ndryshim në mënyrën si aplikohet huaja që nuk ka marrë miratimin paraprak me shkrim të CEB do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në rimbursimin, pezullimin ose anulimin para kohe të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

4. KUSHTET FINANCIARE

4.1 Shuma e Huasë

Shuma e Huasë është:

gjashtëdhjetë milionë EURO
60 000 000 EURO

4.2 Shuma e Disbursimit

Huaja disbursohet në minimalisht dy (2) Transhe.

Shuma e çdo transhi përcaktohet sipas kapacitetit përthithës të Projektit. Shuma e Transhit të parë nuk duhet të tejkalojë shtatëdhjetë për qind (70%) të Shumës së Huasë.

4.3 Procedura e Disbursimit

Disbursimi i çdo Transhi përcaktohet nëpërmjet procedurës së mëposhtme:

(a) Kërkesë Disbursimi

Çdo Transh do të disbursohet sipas procedurës së mëposhtme:

Para çdo disbursimi, Huamarrësi i paraqet CEB një kërkesë disbursimi kryesisht në formën e përcaktuar sipas Shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim e referuar si "**Kërkesë Disbursimi**").

Një Kërkesë Disbursimi specifikon:

- (i) Monedhën(at) dhe shumën(at) e propozuar/a për Transhin;
- (ii) Datën e Disbursimit;
- (iii) Datën/datat e Shlyerjes së Principalit, duke përfshirë Datën e Maturimit, duke marrë parasysh se Periudha e Shlyerjes së Principalit për secilin Transh nuk duhet të tejkalojë pesëmbëdhjetë (15) vjet.
- (iv) Normën Fikse Maksimale të Interesit ose Diferencën maksimale të Normës Referuese;
- (v) Periudha e Interesit dhe Datat e Pagesës së Interesit;



(vi) Marrëveshjen e Përcaktimit të Ditëve dhe Ditët e Punës; dhe

(vii) Llogarinë e Huamarrësit për pagesa.

Çdo Kërkesë Disbursimi Huaje që i dorëzohet CEB është e parevokueshme, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB.

(b) Njoftimi i Disbursimit

Nëse CEB merr një Kërkesë Disbursimi që përputhet me kërkesat e Kërkesës për Disbursim të përcaktuara në Nënklauzolën 4.3(a) më sipër dhe nëse të gjitha Kushtet e tjera përkatëse të Disbursimit të përcaktuara më poshtë në Nënklauzolën 4.5 (*Kushtet e Disbursimit*) janë plotësuar nga Huamarrësi, CEB do t'i dorëzojë Huamarrësit një njoftim disbursimi kryesisht në formën e përcaktuar sipas Shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim i referuar si "**Njoftim Disbursimi**"). Çdo Njoftim Disbursimi duhet të dorëzohet të paktën dy (2) Ditë Pune para Datës së propozuar të Disbursimit.

Një Njoftim Disbursimi duhet të specifikojë:

(i) Monedhën (at) dhe shumën (at) për Transhin;

(ii) Datën e Disbursimit;

(iii) Periudhën e Shlyerjes së Principalit dhe Datën/Datat e Shlyerjes, duke përfshirë Datën e Maturimit;

(iv) Normën Fikse të Interesit ose Diferencën ndaj Normës Referuese;

(v) Periudhën e Interesit dhe Datat e Pagesës së Interesit;

(vi) Marrëveshjen e Përcaktimit të Ditëve dhe Ditët e Punës; dhe

(vii) Llogaritë e Huamarrësit dhe CEB për pagesat

Një Njoftim Disbursimi që plotëson elementët e përfshirë në një Kërkesë Disbursimi Huaje përbën një angazhim të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për të marrë hua nga CEB dhe nga ana e CEB për t'i disbursuar Huamarrësit Transhin sipas termave dhe kushteve të specifikuar në Njoftimin e Disbursimit.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse CEB nuk ka dorëzuar një Njoftim Disbursimi brenda njëzet (20) Ditësh Pune pas marrjes së Kërkesës për Disbursim, kërkesa përkatëse për Disbursim do të konsiderohet e anuluar.

4.4 Periudha e Disbursimit

Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB, Huamarrësi nuk ka të drejtë:

(i) të lëshojë një Kërkesë Disbursimit për Transhin e parë pas dymbëdhjetë (12) muajve pas ekzekutimit të Marrëveshjes nga Palët ose pas njëzetë e katër (24) muajsh pas miratimit të aplikimit për hua nga Këshilli Administrativ i CEB, cilado që ndodh më herët;

(ii) të lëshojë ndonjë Kërkesë tjetër Disbursimi pas tetëmbëdhjetë (18) muajve pas disbursimit të fundit; ose

(iii) të lëshojë ndonjë Kërkesë tjetër Disbursimi pas datës që bie pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune para Datës së Mbylljes.

4.5 Kushtet e Disbursimit

a) Kushtet para Kërkesës për Disbursim për Transhin e parë:



- (i) Një opinion ligjor në anglisht të lëshuar nga drejtuesi i departamentit juridik të Huamarrësit që konfirmon sipas pëlqimit të CEB, kryesisht në formën e përcaktuar sipas Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, se Marrëveshja është ekzekutuar sipas rregullave nga përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit dhe se Marrëveshja është e vlefshme, e detyrueshme dhe e zbatueshme në përputhje me kushtet në juridiksionin e Huamarrësit.
 - (ii) Dëshmi në gjuhën angleze (p.sh., statut, rezolutë, prokurë etj.), sipas pëlqimit të CEB, të personit(ave) të autorizuar për ekzekutimin e Marrëveshjes dhe Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit, së bashku me modelin e vërtetuar të nënshkrimit (eve) të këtij personi/këtyre personave.
 - (iii) Një Certifikatë nga Huamarrësi në formën e Shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje, të nënshkruar nga personi (at) e autorizuar për ekzekutimin e Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit dhe me datë jo më herët sesa një datë që bie pesë (5) Ditë Pune para Kërkesës për Disbursim.
- b) Kushtet pararendëse për ndonjë Kërkesë tjetër Disbursimi:
- (i) Dëshmi në gjuhën angleze (p.sh., Statut, Rezolutë, Prokurë etj.), sipas kërkesave të CEB, të personit(ave) të autorizuar për ekzekutimin e Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit, së bashku me modelin e vërtetuar të nënshkrimit (eve) të këtij personi/këtyre personave.
 - (ii) Raport Progresi që konfirmon, sipas pëlqimit të CEB, Alokimin e plotë (100%) të Transhit të mëparshëm.
 - (iii) Një Certifikatë nga Huamarrësi në formën e Shtojcës 5, të nënshkruar nga personi (at) e autorizuar për ekzekutimin e Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit dhe me datë jo më herët sesa një datë që bie pesë (5) Ditë Pune para Kërkesës për Disbursim.

4.6 Shlyerja

Në çdo Datë Shlyerjeje Principali Huamarrësi shlyen principalin e çdo Transhi të kërkueshëm në atë Datë të Shlyerjes së Principalit në përputhje me kushte të përcaktuara në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

4.7 Parapagimi

(a) Mekanizmat

Nëse në ndonjë rast të specifikuar në këtë Marrëveshje që i referohet kësaj Nënklauzole, Huamarrësi duhet të parapaguajë të gjithë ose ndonjë pjesë të një Transhi ose në rast të një parapagimi vullnetar, Huamarrësi duhet t'i japë CEB të paktën një (1) muaj para njoftim me shkrim (në vijim i referuar si "Njoftimi i Parapagimit") që specifikon shumat që do të parapagohen, datën kur do të kryhet parapagimi (në vijim i referuar si "Data e Parapagimit") dhe, pas konsultimit paraprak me CEB, Kostot e Parapagimit. Data e Parapagimit bie në një Datë Pagese Interesi, nëse nuk bihet dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i.

Pas marrjes së Njoftimit të Parapagimit, CEB do t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim me shkrim (në vijim i referuar si "Konfirmimi i Parapagimi"), jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune para Datës së Parapagimit që specifikon interesin e shtuar të kërkueshëm mbi të dhe Kostot e Parapagimit në pajtim me Nënklauzolën 4.7 (b).

Një Konfirmim Parapagimi që i përshtatet të gjithë elementëve të përfshirë në Njoftimin e Parapagimit përbën një angazhim të përvokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për parapagimin e shumave përkatëse për CEB sipas termave dhe kushteve të specifikuara në Konfirmimin e Parapagimit.



Nëse Huamarrësi parapaguan pjesërisht një Transh, shuma e parapaguar do të aplikohet proporcionalisht për çdo shlyerje të principalit të papaguar. Në një rast të tillë, Konfirmimi i Parapagimit do të përfshijë, në përputhje me rrethanat, një skedul të përshtatur shlyerjeje i cili do të jetë i detyrueshëm për Huamarrësin.

(b) **Kostot e Parapagimit**

Kostot që rezultojnë nga parapagimi në përputhje me Nënklauzolën 4.7 (a) (në vijim të referuara si « **Kosto Parapagimi** ») përcaktohen nga CEB në bazë të kostove të rishpërndarjes së shumës që do të parapaguhet nga Data e Parapagimit deri në Datën e Maturimit, duke përfshirë edhe ndonjë kosto të ngjashme, të tilla si ndryshimin e ndonjë mase themelore mbrojtëse. Kostot e rishpërndarjes do të përcaktohen mbi bazën e diferencës ndërmjet normës fillestare dhe normës së rishpërndarjes e cila do të përcaktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut në datën e Njoftimit të Parapagimit.

4.8 Përcaktimi i Interesit

Huamarrësi paguan interes mbi principalin e çdo Transhi herë pas here të papaguar gjatë çdo Periudhë Interesi në Normën Fikse të Interesit/Normën e Ndryshueshme të Interesit të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

Interesi (i) shtohet duke filluar nga dhe përfshirë ditën e parë të Periudhës së Interesit, por duke përfshirë ditën e fundit të kësaj Periudhe Interesi; dhe (ii) është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në Datat e Pagesës së Interesit të përcaktuara në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit. Interesi llogaritet në bazë të Marrëveshjes së Përcaktimit të Ditëve të specifikuar në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

Në rastin e Transheve të Normës së Interesit të Ndryshueshëm, CEB përcakton për secilën Datë të Përcaktimit të Interesit normën e zbatueshme të interesit gjatë Periudhës përkatëse të Interesit, në përputhje me Marrëveshjen dhe menjëherë njofton për këtë Huamarrësin. Çdo përcaktim nga CEB është përfundimtar, vendimtar dhe detyrues për Huamarrësin, përveç nëse i provohet CEB nga Huamarrësi se një përcaktim i tillë është një gabim i qartë.

4.9 Norma e Kamatëvonesës

Në rast se Huamarrësi nuk mund të paguajë, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë shumë sipas Marrëveshjes, dhe pavarësisht çdo mjeti tjetër të disponueshëm nga CEB sipas Marrëveshjes, Huamarrësi do të paguajë interes mbi shumën e papaguar nga data e pagesës deri në datën e marrjes së një pagese të tillë nga CEB në normën e interesit vjetor të barabartë me EURIBOR njëmuor, të kuotuar në datën e caktuar të pagesës plus dyqind pikë-bazë (200 pikë bazë) (në vijim të referuar si "**Norma e Kamatëvonesës**").

Norma e zbatueshme e Kamatëvonesës do të përditësohet çdo tridhjetë (30) ditë kalendarike

4.10 Rasti i Deformimit të Tregut

CEB-i, pas marrjes së dëgjimit, do të njoftojë Huamarrësin për ndodhjen e një Rasti Deformimi Tregu. Për qëllimet e Marrëveshjes, një "**Rast i Deformimit të Tregut**" i referohet rrethanave të mëposhtme:

- (a) Ofruesi përkatës i lajmeve financiare i përmendur sipas përkufizimit të EURIBOR-it nuk kuoton ndonjë normë përqindjeje ose faqja e normës korresponduese standard të interesit të tregut nuk është e aksesueshme.

Sipas një Rasti të tillë të Deformimit të Tregut, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit të përcaktuar nga CEB si mesatarja aritmetike e normave në të cilat huatë në EURO, në një shumë të njëjtë apo sa më të afërt të krahasueshme me shumën e Huasë në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë ose sa më të përafërt të krahasueshme me Periudhën përkatëse të Interesit, janë ofruar nga tre banka (3) kryesore në tregun ndërbankar të BE-së



të zgjedhur nga CEB. Nëse janë ofruar të paktën dy (2) kuotime, EURIBOR-i i zbatueshëm për atë Datë Përcaktimi Interesi do të jetë mesatarja aritmetike e të gjitha kuotimeve të ofruara.

Nëse është ofruar vetëm një (1) kuotim ose asnjë kuotim, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga CEB si mesatarja aritmetike e normave në të cilat huatë në EURO, në një shumë të njëjtë apo sa më të afërt të krahasueshme me shumën e Huasë në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë apo sa më të afërt të krahasueshme me Periudhën përkatëse të Interesit, janë ofruar në Ditën e dytë të Punës pas fillimit të Periudhës përkatëse të Interesit nga bankat kryesore në tregun ndërbankar të BE-së të zgjedhur nga CEB.

- (b) CEB vendos se nuk është e mundur të përcaktohet Norma e zbatueshme e Referencës në përputhje me paragrafin e mësipërm (a).

Sipas një Rasti të tillë Deformimi të Tregut, Norma e zbatueshme e interesit të Ndryshueshëm do të zëvendësohet me normën që shpreh si një normë përqindje në vit koston e financimit të Huasë së CEB nga çfarëdolloj burimi të cilin CEB e çmon të arsyeshëm për t'u zgjedhur.

- (c) Në çdo kohë midis dorëzimit të një Njoftimi Disbursimi dhe Datës së Disbursimit, CEB konstaton në mënyrë të arsyeshme se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara të një natyre ekonomike, financiare, politike apo natyre tjetër të jashtme që ndikojnë negativisht në aksesin e CEB në burimet e tij të financimit.

Në një rast të tillë Deformimi Tregu, CEB ka të drejtë ta anulojë disbursimin e planifikuar pa asnjë kosto.

Në Rastet e Deformimit të Tregut të përcaktuara në pikat (a) dhe (b) më sipër (të ndryshme nga Rasti i Zëvendësimit i EURIBOR-it) :

- (i) Nëse Huamarrësi e kërkon, Palët, duke vepruar në mirëbesim, do të hyjnë në negociata për një periudhë jo më të gjatë se tridhjetë ditë (30) kalendarike, në mënyrë që të bien dakord mbi një alternativë për EURIBOR-in e zbatueshëm. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, Huamarrësi mund të vijojë me parapagimin në Datën pasuese të Pagesës së Interesit sipas kushteve të përcaktuara në Nënklauzolën 4.7
- (ii) CEB ka të drejtë, duke vepruar në mirëbesim dhe në konsultim me Huamarrësin në masën që është arsyeshmërisht e mundur, të ndryshojë kohëzgjatjen e çdo Periudhe pasuese Interesi deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike ose periudhë më të shkurtër, duke i dërguar Huamarrësit një njoftim për këtë qëllim. Çdo ndryshim i tillë në një Periudhë Interesi hyn në fuqi në datën e specifikuar në këtë njoftim nga CEB.

Nëse CEB përcakton se Rasti përkatës i Deformimit të Tregut nuk ekziston më, atëherë në bazë të ndonjë Rasti tjetër të Deformimit të Tregut aktual ose ekzistues, Norma e Ndryshueshme e Interesit dhe/ose Periudha e Interesit e zbatueshme për Transhin përkatës do të kthehen, që nga dita e parë e Periudhës pasuese të Interesit, tek llogaritja në përputhje me Normën e Ndryshueshme të Interesit dhe Periudhën e Interesit të specifikuar në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

4.11 Pagesat

Të gjitha shumat e detyrueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje janë të pagueshme në Monedhën e secilit Transh në llogarinë e CEB të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit. Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet në Ditën e Punës në bazë të Marrëveshjes së ndryshuar të Ditës së ardhshme të Punës. Çdo pagesë konsiderohet e kryer pasi CEB të ketë marrë shumën në llogari të tij.



Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, i dërgon CEB një njoftim pagese me shkrim të paktën pesë (5) Ditë Pune para pagesës së çdo shume të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Të gjitha pagesat që do të kryhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të llogariten dhe do të bëhen pa (dhe falas dhe pa asnjë zbritje për) shlyerjen ose kundërpretendimin.

Nëse CEB merr një pagesë që është e pamjaftueshme për të shlyer të gjitha shumat e kërkueshme dhe të pagueshme në atë kohë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, CEB do të aplikojë atë pagesë në ose ndaj pagesës:

- (I) së pari, të tarifave, kostove, tarifave ose shpenzimeve të kërkueshme por të papaguara sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (II) së dyti, çdo interesi të shtuar të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje,
- (III) së treti, çdo principal të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (IV) së katërti, çdo shume tjetër të kërkueshme por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.



